

**STUDIME
NË
KRIMINOLOGJI**

Vëllimi III

© Prof. Dr. Aurela Anastasi

© Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose botohet, me kusht që të njihet autorësia e tij. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin tregtar apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të autorëve.

Autorët:

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

Drejtuese e Projektit: Alba Jorganxhi

ISBN: 9789928482617

Ky botim u mundësua nga:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Ky projekt mbështetet financiarisht nga:



Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, apo të Byrosë së Qeverisë së SHBA-së për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Parathënie

Ky botim është mbështetur nga projekti “Për krijimin e programit ‘Master në Kriminologji’” (2018-2024), i cili zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, me mbështetjen financiare të Byrosë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri falënderon autorin për punën e tij dhe shpreh përkushtimin e saj të vijueshëm për promovimin e hulumtimit shkencor dhe debatit akademik në fushën e kriminologjisë.

PËRMBAJTJA

Prof. Dr. Aurela Anastasi

**INSTITUCIONET PËR MBËSHTETJEN
DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT**

Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

**ASPEKTE ADMINISTRATIVE TË ROLIT TË ROLIT TË
INSTITUCIONEVE LIGJZBATUESE NË GARANTIMIN E
TË DREJTAVE TË NJERIUT**
Studim rasti: Policia e Shtetit

Prof. Dr. Aurela Anastasi

**INSTITUCIONET PËR
MBËSHTETJEN
DHE MBROJTJEN E
VIKTIMAVE TË KRIMIT**

Përmbajtja

Abstract.	11
Fjalë kyçe:	12
SHËNIME HYRËSE	13
I. MBËSHTETJA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE TË VEPRËS PENALE.	17
1. Prokuroria si institucion kushtetues për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave.	17
2. Standardet kushtetuese për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave	18
2.1. Garancitë kushtetuese në procesin penal.	18
2.2. Parimi i procesit të rregullt ligjor	19
3. Të drejtat e viktimave të krimit në standardet Europiane.	20
3.1. Mësime nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.	20
3.2. Një analizë e të drejtave të viktimave sipas Direktivës “2012/29/EU”	24
3.2.1. <i>Të drejtat për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave</i>	24
II. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN	33
1. Legjislacioni shqiptar për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.	33
2. Zbatimi i legjislacionit shqiptar në përfrim me standardet ndërkombëtare.	35
3. Parimet e ofrimit të shërbimeve mbështetëse.	37
4. Shërbimet e mbështetjes dhe roli i institucionit të prokurorisë.	40
4.1. Roli drejtues i Prokurorit për mbështetjen ndaj viktimës	41
4.2. Punonjësi i Policisë gjyqësore.	43

4.3. Koordinator i viktimave.	44
5. Koordinimi institucional	45
5.1. Koordinimi institucional i brendshëm.	45
5.2. Koordinimi institucional i jashtëm.	46
III. NDARJA E PËRGJEGJËSIVE INSTITUCIONALE NË KOHË	51
1. Periudha e përgjegjësive institucionale për të drejtat e viktimave	51
2. E drejta e viktimës që “të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimimin e tij”	52
2.1. Analiza e rastit D.Ë.	55
IV. VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE I RISKUT PËR VIKTIMËN	57
1. Identifikimi i viktimës	57
1.1. Organet përgjegjëse për identifikimin e viktimës	57
1.2. Burimet për identifikimin e viktimës/ave.	57
1.3. Statusi i viktimës.	58
2. Vlerësimi individual dhe përcaktimi i nevojave për viktimën	59
3. Vlerësimi i Riskut dhe mbrojtja/mbështetja e viktimës	62
3.1. Vlerësimi i riskut të dhunës në familje.	62
3.2. Detyrimi institucional për vlerësimin e riskut të dhunës në familje	64
3.3. Vlerësimi i riskut në procesin penal.	65
3.4. Të dhëna nga intervistimi i oficerëve të policisë gjyqësore.	67
3.5. Çështje të menaxhimit të riskut	69
4. Ndihma juridike falas	70
4.1. Format e ndihmës juridike falas.	70
4.2. Viktimat e krimit si subjekt përfitues të ndihmës	72
V. Konkluzion	75
Bibliografia	77

Abstract

Ky studim analizon institucionet për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit në përqasje me standardet ndërkombëtare, me qëllim nxjerrjen e mësimave për institucionet shqiptare. Institucionet studiohen jo vetëm në paraqitjen e tyre teknike, por edhe në thelbin e tyre social, lidhur ngushtë me veprimtarinë e prokurorisë, policisë së shtetit, si dhe subjekteve të tjera që veprojnë në këtë fushë. Metodot analitike krahasimore dhe ato përafruese me legjislacionin e Bashkimit Evropian, mbi të cilat është kryer studimi, na lejojnë të evidentojmë vlerat e ndryshimeve të reja të legjislacionit shqiptar, si dhe nevojat për respektimin dhe zbatimin e tyre nga organet ligjzbatuese në këtë fushë. Studimi shtron kërkesat për rregullimin ligjor e praktik gjatë dhe pas procesit penal, që mbrojnë viktimën nga riviktimizimi dhe parandalojnë vepra të tjera penale. Një vend të posaçëm zë roli drejtues i prokurorit për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave.

Fjalë kyçe: të drejtat e viktimave, të drejtat e viktimave për mbështetje, të drejtat e viktimave për mbrojtje, prokuroria, prokurori, oficeri i policisë gjyqësore, koordinatori, informacioni, këshillimi, mbështetja, referimi, vlerësimi i nevojave, vlerësimi i riskut, koordinimi institucional, përafrimi i legjislacionit me të drejtën e BE-së.

Lista e Shkurtimeve

BE-	Bashkimi European
Direktiva 2012/29-	Direktiva e Bashkimit Evropian “2012/29/EU” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit
ETN-	Ekipi teknik Ndërdisciplinor
GJEDNJ-	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ-	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KPP-	Kodi i Procedurës Penale
Udhëzim i PP-	Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjishëm
UMM-	Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes
UM-	Urdhër i Mbrojtjes
VKM-	Vendim i Këshillit të Ministrave

Shënime hyrëse

Që nga viti 1985, kur për herë të parë u njoh ndërkombëtarisht e drejta e viktimave për të marrë pjesë në procesin e drejtësisë penale,¹ kanë evoluar disa institute procedurale në lidhje me statusin e tyre. Statusi i viktimës në procesin penal ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, veçanërisht falë përvojave të gjykatave ndërkombëtare të jashtëzakonshme. Jo rastësisht, Gjykata Penale Ndërkombëtare e krijuar nga Statuti i Romës², është konsideruar si “gjykata e viktimave”. Këto gjykata e rritën aksesin e viktimës së krimit në proces dhe madje ndikuan në sistemet e brendshme ligjore. *“Sfida më e madhe që këto institucione kanë hasur, qëndron në ambiguitetin e asaj se çfarë do të thotë drejtësi për viktimat...”*³. Kjo përgjigje mbetet një sfidë edhe për legjislacionet e shteteve. Aktualisht, një sërë aktesh të organizatave ndërkombëtare si dhe jurisprudenca e gjykatave ndërkombëtare, kanë sanksionuar standarde të reja për pjesëmarrjen e viktimave në procesin penal, si dhe për mbrojtjen e mbështetjen e tyre gjatë dhe pas procesit penal. Edhe Direktiva e Bashkimit Evropian “2012/29/EU” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁴ ka çuar në

1 Shih: The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985); i gjindshëm në: URL: <http://www.unhchr.ch>

2 Për rolin e viktimave përpara Gjykatës Ndërkombëtare Penale shih: Olasolo W. Kiss A., “The role of victims in criminal proceedings before the International Criminal Court”, në [Revue internationale de droit pénal 2010/1-2 \(Vol. 81\)](#), pages 125 à 163.

3 Rudina Jasini, Pjesëmarrja e viktimave si palë civile në proceset penale ndërkombëtare, në “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë”, Anastasi A., Sinani Sh., (ed.) ASHSH, Tiranë, 2023, fq. 290-345

4 Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 25 tetor 2012

ndryshime të rëndësishme për përmirësimin e statusit të viktimave të veprës penale.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar solli ndryshime thelbësore të statusit të viktimës në procesin penal. Deri në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale (2017), viktimat thirrëj në procesin gjyqësor me statusin e dëshmitares. Në rastet kur me kërkesën e saj kërkonte shpërblimin e dëmit, mund të paraqitej vetëm me statusin e paditëses civile në procesin penal. Në rastin e fundit, viktimat kishte mundësinë të përfaqësohej në proces me një avokat privat të zgjedhur prej saj. Megjithatë, padia civile në procesin penal ushtrohej shumë rrallë nga viktimat dhe nuk rezultoi ndonjë praktikë e konsoliduar gjyqësore për të.⁵ Nga ana tjetër, pretendimet e saj në proces lidheshin veç me shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga autori i veprës penale.

Në fund të viteve 2000, në Shqipëri pati një lëvizje të avokatëve pranë organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të viktimave të krimit, veçanërisht të viktimave të trafikimit dhe të dhunës me bazë gjinore. U paraqitën padi civile në procesin penal, pasi kjo u gjet si e vetmja mundësi për aksesin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në proces.⁶ Përmes saj, viktimat e krimit parashtronin pretendimet e tyre në proces. Kjo praktikë solli disa ndryshime të praktikave të punës së Prokurorit, i cili në bazë të KPP (neni 61 e në vijim), depozitonte në dosje

“Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”, e gjindshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32012L0029#:~:text=Right%20to%20access,a%20competent%20authority>

5 Aurela Anastasi, Mekanizmat për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rëndësia e forcimit të tyre, në “Barazia dhe drejtësia gjinore”, ASHSH, Tiranë, 2021, fq. 340-341.

6 Shih po aty, fq. 340-369.

edhe padinë civile të viktimës së veprës penale, krahas provave që mund të shërbenin për procesin e të provuarit përpara gjykatës. Sidoqoftë, edhe kjo lëvizje mbeti shumë e kufizuar, pasi në përgjithësi, veçohej padia civile nga procesi penal. Për më tepër, vendimet e gjykatave civile për shpërblimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, mbeten të pa ekzekutuara, për disa shkaqe. Ka disa pengesa ligjore për shkak të moszbatimit të mirë të ligjit, si dhe për shkak të mungesave ligjore në sigurimin e aseteve. Kështu, vitet e fundit, kemi disa vendime gjyqësore civile për shpërblimin e dëmit viktimave të këtij krimi, por nuk kemi identifikuar ndonjë rast të ekzekutuar. Gjithashtu, ka pasur *“...mjaft raste të pamundësisë për të kërkuar dëmin material e moral në organet kompetente për shkak të shpenzimeve që kërkohen; ...ne mendojmë se faktorët kryesorë për këtë situatë mbeten jo vetëm mungesat në legjislacion, por edhe paragjykimet dhe stigmatizimi ndaj viktimave, i cili vijon ende, si dhe mungesa e efektivitetit në organet e drejtësisë dhe e pafuqisë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.”*⁷

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale më 2017, krijuan një status të ri të viktimës në procesin penal. Për herë të parë KPP parashikoi pjesëmarrjen e viktimave si palë në procesin penal si dhe të drejtat e saj procedurale gjatë këtij procesi⁸. Ato u përjasën me standardet e Direktivës së BE-së dhe të Konventave së Këshillit të Evropës⁹. Janë parashikuar në mënyrë të posaçme të drejta procedurale për gratë

7 Shih: UPR Shadow Report, Center for Legal Civic Initiatives & Network of Monitoring against Gender based Violence, (2014-2018), i gjindshëm në: [raporti
upr.pdf \(qag-al.org\)](http://raporti.upr.pdf(qag-al.org))

8 Shih: Ligj nr. 35/2017, KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

9 Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support, and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA & Council of Europe Convention on Action Against Trafficking in Human Beings, ratified by Law 9642, dated 20.11.2006. e gjindshme në: [EUR-Lex - 32012L0029
- EN - EUR-Lex \(europa.eu\).](http://eur-lex.europa.eu/LexUri.do?uri=CELEX:32012L0029-EN-EN-LEX)

viktima të trafikimit dhe të dhunës seksuale, sikurse padyshim, për viktimat fëmijë.

Sot shtrohet çështja e zbatimit të tyre. Ka autorë që kanë shprehur shqetësim për zbatimin e këtyre standardeve: “...*Natyrisht, pritshmëritë e ndikimit potencial të së drejtës së BE-së për viktimat ndaj reformës shqiptare, janë larg nga qasja realiste për shkak të mangësive të institucioneve që sigurojnë këto të drejta.*”¹⁰ Në këtë aspekt, shtrohen detyra jo vetëm për ligjvënësin, por edhe për institucionet e mbështetjes së viktimave të krimit, me qëllim një zbatim të mirë të standardeve të të drejtës së BE-së. Për këtë, një rol përcaktues ka institucioni i prokurorisë.

10 Shih: Beqiri R., A victim-oriented justice dispute in the context of the judicial system reform in Albania, 11 June 2018, 2nd Laë & Political Science Conference, Prague, fq.3

I. MBËSHTETJA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE TË VEPRËS PENALE.

1. Prokuroria si institucion kushtetues për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave.

Prokuroria është një institucion kushtetues, i rregulluar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 148-150) dhe aktet ligjore në bazë e për zbatim të saj. Organizimi dhe funksionimi i saj kanë pësuar ndryshime rrënjësore sidomos me ndryshimet kushtetuese në kuadër të Reformës në drejtësi të vitit 2016.¹¹ Pavarësisht, se është strukturuar në dy prokurori, në prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Posaçme, qasja ndaj respektimit të të drejtave të viktimave mbetet e njëjtë dhe në çdo rast, respektohen aktet ndërkombëtare e kombëtare që i sanksionojnë këto të drejta.

Prokuroria e Përgjithshme përbëhet nga disa organe të brendshme, të cilat ushtrojnë detyra të rëndësishme për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Prokurori i Përgjithshëm është organi drejtues, porse pika qendrore në procesin penal mbetet Prokurori. Deri tani e kemi njohur këtë rol në drejtimin e hetimeve penale, por duhet të mësojmë se edhe në mbështetjen, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e viktimave prokurori ushtron rolin drejtues. Detyra të rëndësishme ushtrohen edhe nga oficerët e policisë gjyqësore si dhe nga koordinatorët në mbështetje të viktimave. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë paraqet veprimtaria për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të veprës penale. Këto

11 Për prokurorinë si institucion kushtetues shih më gjerë: Sokol Berberi, në Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë, ISPL, Tiranë, 2019, fq. 310-322

të drejta janë të lidhura me të drejtat e pjesëmarrjes së viktimës në procesin penal, por kanë fokusin dhe karakteristikat e tyre. Konkretisht, të drejtat për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës janë përfshirë në legjislacionin procedural penal, gjë që përbën një risi. Prandaj, ka nevojë për të analizuar përgjegjësitë institucionale në lidhje me to. Gjithashtu, zbatimi i këtij legjislacioni në ndërveprim me legjislacionin në fushën sociale do të shërbejë për një mbështetje efektive të viktimave të veprës penale. Në vijim, ky studim do të fokusohet në rolin e prokurorisë dhe institucioneve të tjera ndihmëse të drejtësisë për shërbimet e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimës së veprës penale.¹²

2. Standardet kushtetuese për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave

2.1. Garancitë kushtetuese në procesin penal.

Në vitin 1998, kur u hartua Kushtetuta e sotme e Shqipërisë, sanksionoi të drejtat dhe garancitë procedurale gjatë procesit penal (neni 31, e në vijim). Deri më sot, ato janë trajtuar si garanci procedurale për të pandehurin në procesin penal¹³. Statusi dhe të drejtat e viktimës në procesin penal janë konsideruar si të drejta të izoluara në ligje dhe jo si të drejta kushtetuese. Madje, në mjaft raste, këto të drejta nuk merreshin në konsideratë.

Aktualisht, një lexim jetësor i Kushtetutës na bën të mendojmë se, garancitë kushtetuese në procesin penal zbatohen edhe ndaj viktimave. Kur sanksionon garancitë procedurale, Kushtetuta u referohet të gjitha subjekteve. Ajo nuk bën dallime midis tyre kur vendos shprehimisht se, *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë...”*¹⁴. Përsa është e mundur,

12 Në këtë studim termi “institucion” përfshin institucionet në kuptimin formal përmes akteve të ndryshme me karakter normativ, si dhe institucionet në kuptimin e organeve që i zbatojnë këto akte.

13 Shih: Omari L, Anastasi A, “E drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2017, fq. 132-136;

14 “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

këto të drejta u referohen edhe viktimave në procesin penal. Prandaj, nisur nga koncepti i Kushtetutës “së gjallë”, mund të themi se këto garanci sanksionojnë edhe për viktimat të drejtat në nivelin kushtetues.¹⁵ Këtu përfshihen ato të drejta të cilat janë të mundshme të zbatohen edhe për viktimat, sikurse: e drejta për t’u mbrojtur, sigurimi i mbrojtjes falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme; e drejta për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; e drejta të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve në proces. Të gjitha këto, janë garanci procedurale kushtetuese edhe për viktimat.

2.2. Parimi i procesit të rregullt ligjor

Ky parim/e drejtë i/e sanksionuar në Kushtetutë (neni 42) shërben si bazë kushtetuese për të drejtat dhe garancitë procedurale të viktimave në procesin penal. Sipas tij, *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”*¹⁶

Të drejtat e viktimave për të marrë pjesë në procesin penal janë të drejta bazë për një proces të rregullt ligjor. Deri tani çështjet e procesit të rregullt ligjor janë lidhur me çështjet e hetimit dhe të procedimit penal. Prandaj, jurisprudenca kushtetuese në lidhje me të

-
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
 - c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
 - ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
 - d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet”.

15 Anastasi A., Për një klasifikim të të drejtave të viktimave gjatë procesit penal në qasje me procesin e rregullt ligjor në “Çështje të teorisë dhe praktikës mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal”, Onufri, Tiranë, 2019, fq. 399-415.

16 Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës së RSH (1998).

drejtat e viktimave mungon. Por, një konceptim krejt i ri për mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të viktimave ka ardhur veçanërisht përmes standardeve ndërkombëtare, të cilat pasqyrohen në ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale. Këto ndryshime do të rrisin në të ardhmen aksesin e viktimave të veprave penale edhe në Gjykimin Kushtetues. Deri tani viktimat e veprës penale nuk e kanë ushtruar këtë të drejtë. Aktualisht, konstatojmë vetëm një vendim të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankimin individual kushtetues të kallëzuesit në procesin penal. Në këtë rast, kallëzuesi ka kërkuar shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 43, datë 16.02.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.¹⁷ Por, Kolegji seleksionues i Gjykatës Kushtetuese ka gjykuar se *“...kërkuesi nuk ka arritur të provojë se është viktimë e veprës penale dhe as bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, për rrjedhojë ai nuk ka arritur të provojë interesin vetjak dhe të drejtpërdrejtë, pra pasojat negative dhe të drejtpërdrejta që i kanë ardhur nga vendimi objekt kundërshtimi.”* Për sa më sipër, GJK-ja e rrëzoi kërkesën, pasi nuk e legjitimoi viktimën si të tillë. Sidoqoftë, pritet të ketë kërkesa e vendime të Gjykatës Kushtetuese në të ardhmen, të cilat do të krijojnë një jurisprudencë të dobishme për praktikën e mëtejshme të legjitimitimit të viktimave të veprës penale në procesin kushtetues.

3. Të drejtat e viktimave të krimit në standardet Europiane.

3.1 Mësimet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka treguar se shkeljet ndaj të drejtave të viktimave gjatë procesit penal, mund të përbëjnë shkelje të disa neneve të KEDNJ-së. Në gjykimet me këtë objekt ajo ka evidentuar veçanërisht, shkelje të nenit 2 të Konventës (e drejta për jetën), të nenit

¹⁷ Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64 datë 03.06.2022.

3 (e drejta për të mos iu nënshtruar torturës), të nenit 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit) dhe sidomos të nenit 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Në të gjitha rastet shkaqet dhe arsyet e shkeljes së Konventës janë lidhur me shkeljet e të drejtave të mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes së viktimave. Nga studimi nuk na del qartë nëse kemi shkelje të Konventës për shkak të shkeljeve të të drejtave për mbështetjen e viktimave. Sidoqoftë, nga analiza e disa rasteve në vijim, mund të arrijmë në disa konkluzione.

Në rastin *Y dhe të Tjerët v. Bullgarisë (2022)*¹⁸, GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 2 (e drejta e jetës) të Konventës, pasi autoritetet kishin dështuar t'i përgjigjeshin menjëherë ankesave të kërkueses për të kryer një vlerësim të rrezikut në funksion të kontekstit specifik dhe dinamikës së dhunës në familje. Megjithatë, në një rast tjetër, për shkaqe të ngjashme GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, pasi vlerësoi se, në veçanti, autoritetet gjyqësore vendase nuk kishin kryer një analizë gjithëpërfshirëse të situatës dhe rrezikut të dhunës psikologjike dhe fizike në të ardhmen, me të cilën do të përballeshin kërkuesja dhe fëmijët e saj (*Levchuk kundër Ukrainës 2020*)¹⁹.

Shkelje e nenit 8, është konstatuar edhe në çështjen (*Buturugă kundër Rumanisë, 2020*)²⁰, për shkak se, hetimi për aktet e dhunës kishte qenë i mangët dhe nuk kishte marrë në konsideratë ankesën për shkeljen e konfidencialitetit të korrespondencës, e cila ishte e lidhur ngushtë me denoncimin për dhunë. Gjykata theksoi se ngacmimi kibernetik njihet aktualisht si një aspekt i dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë shkeljen kibernetike të privatësisë, ndërhyrjen në kompjuterin e viktimës si dhe marrjen, shpërndarjen dhe manipulimin e të dhënave dhe imazheve. Në çështjen *J.L. kundër Italisë 2021*,²¹ GJEDNJ-ja gjeti shkelje të Nenit 8 (e drejta për jetë

18 *Y dhe të Tjerët v. Bullgarisë (2022)*: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-216360%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-216360%22]})

19 *Levchuk kundër Ukrainës 2020*: <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-203931>

20 *Buturugă kundër Rumanisë, 2020*: [CASE OF BUTURUGĂ v. ROMANIA.pdf](#)

21 *J.L. kundër Italisë 2021*: <https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22item>

private) të Konventës, për shkak se autoritetet kombëtare nuk e kishin mbrojtur ankuesen nga riviktimizimi gjatë gjithë procesit, ku formulimi i vendimit luajti një rol shumë të rëndësishëm, veçanërisht duke pasur parasysh karakterin e tij publik. Në veçanti, autoritetet kombëtare nuk e kishin mbrojtur ankuesen nga riviktimizimi gjatë gjithë procesit, ku formulimi i vendimit luajti një rol shumë të rëndësishëm, veçanërisht duke pasur parasysh karakterin e tij publik. Ndër të tjera, GjEDNJ-ja i konsideroi të pajustificuara komentet në vendimin e gjykatës italiane në lidhje me biseksualitetin e ankuses, lidhjet e saj si dhe marrëdhëniet seksuale rastësore përpara ngjarjes në fjalë. Ai konstatoi se gjuha dhe argumentet e përdorura nga gjykata e apelit përcillnin paragjykime ekzistuese në shoqërinë italiane në lidhje me rolin e grave dhe mund të ishin pengesë për sigurimin e mbrojtjes efektive për të drejtat e viktimave të dhunës me bazë gjinore, pavarësisht kuadrit ligjor të kënaqshëm. Sipas Gjykatës, autoritetet gjyqësore vendase duhet të shmangnin riprodhimin e stereotipeve seksiste në vendimet e gjykatave që nënvlerësojnë dhunën me bazë gjinore dhe ekspozimin e grave ndaj riviktimizimit, komente fajësuese dhe gjykuese që ulin besimin e viktimave në sistemin e drejtësisë.

Shkelje të nenit 8 të Konventës janë gjetur edhe në lidhje me nene të tjera të saj. Në çështjen *E.G. kundër Republikës së Moldavisë (2021)* GJEDNJ ka gjetur shkeljen e nenit 8 dhe të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues).²² Gjykata thekson se masat e marra nga shteti për zbatimin e dënimit të autorit të tretë nuk kishin qenë të mjaftueshme në kuadër të detyrimit të tij për të zbatuar dënimet penale të dhëna ndaj autorëve të sulmeve seksuale. Dhënia e një amnistie për shkelësin dhe dështimi i autoriteteve për të zbatuar dënimin ndaj tij kishte qenë i papajtueshëm me detyrimet pozitive të shtetit të Moldavisë, sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës.

[id%22:\[%22003-7031048-9489384%22\]}](#)

22 E.G. kundër Republikës së Moldavisë (2021): [https://hudoc.echr.coe.int/eng-pres-s#%22itemid%22:\[%22003-6993360-9422878%22\]](https://hudoc.echr.coe.int/eng-pres-s#%22itemid%22:[%22003-6993360-9422878%22])

Edhe në çështjen *E.B. kundër Rumanisë, 2019*,²³ Gjykata Evropiane u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) dhe nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private) të Konventës. Në veçanti, ajo konstatoi se autoritetet rumune kishin dështuar në kryerjen e një hetimi të duhur dhe i kishin mëshuar së tepërmi faktit se kërkuesi nuk i kishte rezistuar sulmuesit të saj të supozuar. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja ka afirmuar nevojën për një mbrojtje të posaçme për viktimat vulnerabil. Gjykata theksoi se rasti i saj kërkonte një hetim më të ndjeshëm që duhet të sigurohet për personat me aftësi të kufizuara, gjë që nuk ishte siguruar.

Në çështjen *Tunikova dhe të tjerët kundër Rusisë (2021)*,²⁴ GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) dhe të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit), në lidhje me nenin 3. Gjykata konstatoi se autoritetet kishin qenë në dijeni të dhunës në familje nga e cila kishin vuajtur ankueset dhe megjithatë, në të gjitha rastet e keqtrajtimit, shteti kishte hequr dorë nga detyrimi i tij për të hetuar.

Sikurse theksuam, në të gjitha rastet konstatojmë se çështjet e trajtuara në jurisprudencën e kësaj gjykate kanë adresuar të drejtat e viktimës për mbrojtje dhe për pjesëmarrje në procesin penal. Por, mjaft të rëndësishme janë edhe të drejtat për mbështetjen e viktimës, të cilat i shohim rrallë në gjykim. P.sh., në çështjen *Tërshana kundër Shqipërisë (2020)*,²⁵ ankuesja ka parashtruar se autoritetet shtetërore nuk i siguruan asnjë trajtim psikoterapie ose rehabilitimi, si dhe mungoi kompensimi financiar. Të gjitha këto pretendime lidhen me të drejtat për mbështetjen e viktimës, të cilat në fakt janë sanksionuar qartë në legjislacionin e Bashkimit Evropian.²⁶ Por, në lidhje me këtë GEDNJ-ja vlerësoi se, në bazë të materialit të parashtruar, nuk paraqitet asnjë shkelje në këtë

23 Po aty.

24 Tunikova dhe të tjerët kundër Rusisë (2021): <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-213869>

25 Tërshana kundër Shqipërisë (2020): [TËRSHANA v. ALBANIA \(coe.int\)](https://hudoc.echr.coe.int/TERSHANA_v_ALBANIA)

26 Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012, cituar.

drejtim, dhe për këtë arsye e rrëzon këtë ankim si haptazi të pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.²⁷ Në këto kushte, konstatojmë se GJEDNJ-ja nuk është shprehur fare për mundësinë e ankimit për këtë kategori të drejtash.

3.2. Një analizë e të drejtave të viktimave sipas Direktivës “2012/29/EU”

3.2.1. Të drejtat për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave

Direktiva “2012/29/EU” ka parashikuar detyrimin e shteteve anëtare që të sigurojnë ushtrimin e të drejtave të viktimave të krimit. Në kontekstin e Direktivës, këto të drejta, mund të vendosen në disa kategori, të cilat i rendisim si më poshtë:

- E drejta për informim
- Të drejtat për mbështetje
- Të drejtat për mbrojtje
- Të drejtat për pjesëmarrje në procesin penal.

Sidoqoftë, nuk mund të ketë kufij të prerë midis këtyre grupimeve, pasi ato përfshijnë të drejta të përbashkëta dhe që ndërveprojnë midis tyre. Prandaj, të gjitha kategoritë e mësipërme paraqiten si grupe të integruara të drejtash.²⁸ Sidomos e drejta për informim ndërfitet në të tria kategoritë e tjera. Kjo na shpie në konkluzionin se përpos kuptimit të tyre në bashkëveprim me njëra tjetrën, duhet të kuptojmë edhe bashkëveprimin institucional për realizimin e tyre në praktikë. Pra, për zbatimin e tyre ka nevojë për një ndarje të kompetencave dhe përgjegjësi midis institucioneve, si dhe për një koordinim institucional.

Direktiva përkufizon kuptimin e disa prej të drejtave për mbrojtjen

27 [TËRSHANA v. ALBANIA \(coe.int\) paragrafi 165](#)

28 Anastasi A., Për një klasifikim të të drejtave të viktimave..., cituar.

e viktimave, që duhet të zbatohen nga autoritetet. Këto të drejta përbëjnë një detyrim minimum për shtetet, të cilat mund t'i zgjerojnë përmes legjislacionit të brendshëm. Një listë e të drejtave për mbrojtjen sipas Direktivës “2012/29/EU”, mund të renditet si vijon:

- E drejta për të shmangur kontaktin me autorin e veprës penale;
- E drejta për mbrojtjen gjatë hetimit penal;
- E drejta për mbrojtjen e privatësisë.

Në këtë kuadër, shtetet marrin masa edhe për viktimat fëmijë si dhe për viktimat që kanë nevojë për mbrojtje specifike.

A. Parimet dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve:

Direktiva “2012/29/EU”, ka sanksionuar të drejtën e viktimave për akses në shërbimet e mbështetjes. Neni 8 i saj vendos parimet dhe kushtet themelore për ofrimin e këtyre shërbimeve, të cilat janë grupuar dhe analizuar në vijim.

- janë falas
- janë të dedikuara për nevojat e viktimave dhe në interes të viktimave
- janë të fshehta
- janë të integruara dhe jo të pjesshme
- ofrohen drejtpërdrejt dhe nuk varen nga ndonjë kërkesë për ofrimin e tyre
- shtrirja në kohë: përpara, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedimit penal.
- detyrimi shtetëror për krijimin dhe zhvillimin e tyre.
- detyrimi i organeve shtetërore që kanë marrë dijeni dhe subjekteve të tjera të lehtësojnë referimin e viktimave në këto shërbime. Detyrimi i subjekteve të tjera që kanë marrë dijeni

dhe të lehtësojnë referimin e viktimave në këto shërbime.

B. Metodatat dhe mjetet për ofrimin e shërbimeve.

Direktiva sanksionon se viktimat e krimit duhet të kenë akses në shërbimet e ofruara falas. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 9 të saj, mund të evidentojmë mjetet dhe metodat me të cilat ofrohen këto shërbime, të cilat po i rendisim si më poshtë:

- vlerësimi i nevojave,
- informacioni,
- këshillimi,
- referimi,
- mbështetja me shërbime,
- mbështetja financiare.

Sa më sipër, mund të konsiderohen edhe si shërbime, edhe si mjete për përmbushjen e të drejtave. Sidoqoftë, duhet t'i dallojmë nga konteksti, me qëllim që të evidentohen llojet e shërbimeve të mbështetjes që shteti duhet të sigurojë minimalisht.

Informacioni: E drejta e viktimave për t'u informuar është një e drejtë gjithëpërfshirëse dhe paraqitet si kusht për përmbushjen e të gjitha të drejtave të tjera. Këtu është fjala për informacionin që institucionet shtetërore duhet t'i ofrojnë viktimës së krimit, me qëllim që ajo të aksesojë shërbimet mbështetëse për to. Institucionet kanë detyrë të japin informacion në lidhje me çdo shërbim mbështetës e specialist përkatës. Është detyrë e tyre të informojnë viktimën në lidhje me të drejtat dhe shërbimet të cilat mund të gëzojë.

Këshillimi: është një veprimtari për përmbushjen e të drejtave të mbështetjes për viktimat. Direktiva adreson minimalisht detyrën e institucioneve shtetërore që të ofrojnë këshilla për përgatitjen për pjesëmarrje në gjyq; këshilla në lidhje me çështjet financiare dhe

praktike që rrjedhin nga krimi; këshilla në lidhje me rrezikun dhe parandalimin e viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, të frikësimit dhe të hakmarrjes, “...përveç nëse parashikohet ndryshe nga shërbime të tjera publike ose private”. (Neni 8, 9 i Direktivës).

Informacioni dhe këshillimi janë dy veprimtari që ndërthuren me njëra-tjetrën. Megjithatë, midis përmbajtjes së tyre ka ndryshime thelbësore. Ndërsa informacioni lidhet me njoftimin e viktimave për të drejtat që ato mund të ushtrojnë, këshillimi kërkon që viktimës t’i thuhet si të veprojë ose të paralajmërohet për t’u mbrojtur nga ndonjë rrezik.²⁹ Prandaj, një ndarje midis detyrave shtetërore për të dhënë informacion dhe detyrave për të dhënë këshillime, do të ishte e rëndësishme për përmbushjen me korrektësi të të drejtave për viktimat. Aktualisht, një interpretim i tillë për informimin dhe këshillimin ligjor, është diskutuar edhe sipas ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. “Në fakt, në praktikë, zëri a, informimi, ngjan shumë me zërin b këshillim dhe mund që ato të përzihen me njëra tjetrën si në shërbim ashtu edhe në raportim. Ne gjejmë rastin të nënvizojmë se ka ndryshime midis tyre. Nëse informimi u jepet qytetarëve në përgjithësi në lidhje me kërkesat që ata kanë për të njohur legjislacionin, këshillimi nënkupton këshilla të nevojshme për çështjen konkrete për të cilën palët ankohen apo denoncojnë në këto qendra.”³⁰ Në këtë aspekt, institucionet e kompetencës duhet të kenë të qartë kufirin midis këtyre veprimtarive, me qëllim që viktima të marrë të plotë edhe informacionin edhe këshillimin. Ndoshta një kufi midis tyre duhet mbajtur parasysht jo vetëm mbi bazën e parimit të kompetencës, por edhe mbi bazën e vullnetit që demonstroi viktima për t’i shfrytëzuar të gjitha shërbimet që ofrohen.

Vlerësimi i nevojave: është një proces paraprak sapo institucioni merr dijeni dhe identifikon viktimën me qëllim që të ofrohen shërbimet më të përshtatshme sipas dëmtimeve që ajo ka pësuar. Në Direktivën

29 Shih: Zërat Këshilloj dhe Informoj në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 2006.

30 Shih: “Ndihma juridike e garantuar nga shteti” Raport monitorimi, QNL, Tiranë 2022, e gjindshme në: [raport_ndihma_juridike.pdf \(qag-al.org\)](https://qag.al.org/raport_ndihma_juridike.pdf), fq.15.

“2012/29/EU”, sikurse edhe në akte të tjera ndërkombëtare, është shprehur qartë detyrimi i shtetit që të përcaktojë procedurat dhe të kryejë një vlerësim individual në kohë reale për viktimat. Vlerësimi individual kryhet me përfshirjen e ngushtë të viktimës dhe mban parasysh kryesisht, karakteristikat e saj personale, llojin ose natyrën e krimit, si dhe rrethanat e krimit. Ky vlerësim duhet të përditësohet gjatë procesit penal. Vlerësimi ka qëllim të identifikojë nevojat specifike dhe të përcaktojë masat e përshtatshme për të mbrojtur viktimën ose anëtarin e familjes nga viktimizimi dytësor dhe i përsëritur, si dhe nga frikësimi e hakmarrja.

Sa më sipër, Direktiva ka sanksionuar detyrimin e shtetit që të marrë masa të reja, si dhe të zbatojë masat ekzistuese për të mbrojtur viktimën dhe anëtarët e familjeve të tyre nga viktimizimi dytësor e i përsëritur, nga frikësimi e hakmarrja, duke përfshirë rrezikun e dëmtimit emocional ose psikologjik, si dhe për të mbrojtur dinjitetin e viktimave gjatë marrjes në pyetje/dhënies së dëshmisë. Këto masa përfshijnë edhe procedurat për mbrojtjen fizike të viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre, që përcaktohen sipas ligjit kombëtar. Direktiva në këtë formulim ka përfshirë rrezikun e dëmtimit emocional ose psikologjik, duke nënkuptuar se patologjitë e tjera më të rënda të shëndetit mendor janë të vetëkuptueshme.

Vëmendje e veçantë u kushtohet viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të një krimi të rëndë. Sipas Direktivës në këto mund të përfshihen:

- viktimat e diskriminimit,
- viktimat e rrezikuara për shkak të marrëdhënies së afërt me autorin,
- viktimat e terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore,
- dhunës me bazë gjinore,
- dhunës në një marrëdhënie të ngushtë,

- dhunës seksuale,
- shfrytëzimit ose krimit të urrejtjes,
- viktimat me aftësi të kufizuara.

Viktimat fëmijë gjithashtu kanë nevoja specifika për mbrojtje. Kur thekson “mund të përfshihen”, direktiva ka parasysh standardet minimale që zbatohen nga shtetet. Këto të fundit, kanë marzh të lirë që të zhvillojnë shërbime të posaçme edhe për kategori të tjera viktimash.

Është e rëndësishme që legjislacioni kombëtar të ketë parashikime për të përcaktuar konkretisht procedurën dhe organet për kryerjen e vlerësimit të nevojave. Ky përcaktim ligjor është i domosdoshëm, pasi deri tani është e paqartë nëse është organi përgjegjës apo organi që merr njoftimin i pari, ai që kryen këtë vlerësim. Gjithashtu, aktet e brendshme duhet të bëjnë të qartë se si vijon të plotësohet më tej ky vlerësim, edhe nga institucione të tjera që kontaktojnë viktimën, sipas nevojave që paraqiten.

Referimi: Institucionet kanë detyrë të referojnë drejtpërdrejt viktimat tek çdo shërbim mbështetës e specialist përkatës. Organet që marrin dijeni ose subjekte të tjera lehtësojnë referimin e viktimave në këto shërbime. Në këtë aspekt, institucionet mund të ndahen në dy kategori: së pari, institucionet përgjegjëse që kanë detyrë të referojnë drejtpërdrejt viktimat tek shërbimet, së dyti institucionet e tjera që vijnë në dijeni të nevojave të viktimave për shërbime dhe kanë detyrë të lehtësojnë referimin e tyre. Sikurse theksuam kur folëm për vlerësimin e nevojave të viktimës, kjo ndarje ka rëndësi, pasi legjislacioni i brendshëm duhet të përcaktojë konkretisht institucionet përgjegjëse dhe detyrat e tyre. Nga ana tjetër duhet të përcaktojë edhe detyra për institucione dhe subjekte të tjera që marrin dijeni për shkak të kryqëzimit të punëve.

C. Llojet e shërbimeve që duhet të sigurohen nga Shteti.

Duke analizuar dispozitat e Direktivës për shërbimet mbështetëse,

mund të evidentojmë kategoritë e shërbimeve që Shteti duhet të ofrojë minimalisht. Ato nuk përbëjnë një listë të mbyllur, pasi Direktiva u referohet nevojave të viktimave dhe parashikimeve të vetë shteteve në legjislacionet kombëtare. Karakteristikë e shërbimeve për përmbushjen e të drejtave të mbështetjes është se ato lidhen me respektimin e të gjitha kategorive të të drejtave, sikurse janë të drejtat e pjesëmarrjes dhe të mbrojtjes së viktimës. Më tepër, ky përbashkim është i dukshëm në informimin dhe këshillimin e viktimave, por edhe në shërbimet e tjera. Vlerësimi i nevojave të viktimave kryhet për të gjitha të drejtat dhe nuk ka karakter përjashtimor për ndonjë prej tyre. Konkretisht, standardet minimale që kërkon Direktiva “2012/29/EU” për mbështetjen e viktimave janë:

- këshilla dhe mbështetje në lidhje me të drejtat, duke përfshirë aksesin në skemat kombëtare të kompensimit për lëndimet kriminale, si dhe duke përfshirë përgatitjen për pjesëmarrje në gjyq;
- informacion në lidhje me shërbimet;
- referim të drejtpërdrejtë tek çdo shërbim mbështetës të specialitetit përkatës;
- mbështetje emocionale;
- mbështetje psikologjike, kur është e mundur;
- këshilla në lidhje me çështjet financiare dhe praktike që rrjedhin nga krimi;
- këshilla në lidhje me rrezikun dhe parandalimin e viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, të frikësimit dhe të hakmarrjes.
- zhvillimin dhe ofrimin e strehimit për viktimat.

Këto shërbime ofrohen të integruara, sipas nevojave të viktimave. Shërbimet mbështetëse duhet të ofrojnë strehimore përkatëse ose çdo strehim tjetër të përshtatshëm të përkohshëm për të gjitha viktimat që kanë nevojë për një vend të sigurt, për shkak të një rreziku të

menjëhershëm të viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, të frikësimit dhe të hakmarrjes. Këto shërbime lidhen ngushtë edhe me të drejtat për mbrojtjen e viktimave, të cilat Direktiva i ka afirmuar në një kre të veçantë. Prandaj, vlerësimi i nevojave të viktimës si dhe shërbimet me qëllim mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës, ofrohen njëkohësisht.

Është thelbësore që viktimat të jenë në dijeni të të drejtave të tyre, të dinë se ku të drejtohen për këshilla dhe mbështetje dhe të jenë mjaftueshëm të inkurajuar dhe të mbështetura në pretendimet e tyre për të drejtat. Disponueshmëria dhe aksesimi në shërbime të besueshme, efektive dhe falas janë themelore. Në këtë drejtim, shërbimet për mbështetjen e viktimave janë kyçe.³¹

D. Subjektet. Viktimat e krimit me nevoja specifike.

Direktiva “2012/29/EU” ka përcaktuar se subjektet që përfitojnë këtë mbështetje janë viktimat e krimit. Mbështetje jepet edhe për anëtarët e familjes, në përputhje me nevojat e tyre dhe shkallën e dëmtimit të pësuar si rezultat i veprës penale të kryer ndaj viktimës. Gjithashtu, Direktiva ka përcaktuar edhe kategoritë e viktimave me nevoja specifike. Në këto kategori përfshihen në mënyrë të shprehur viktimat e dhunës seksuale, viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës të ushtruar nga persona që ndodhen në marrëdhënie të afërta. Këto shërbime zhvillojnë mbështetje të integruar posaçëm për viktimat me nevoja specifike. Sidoqoftë, shërbimet e ofruara nga institucionet shtetërore nuk mund të përfshijnë vetëm viktimat e krimit që kanë nevoja specifike, por të gjitha viktimat e krimit. Në raportet e monitorimit të përvojave të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, është kritikuar qasja e shteteve që zhvillojnë dhe ofrojnë shërbime vetëm për viktimat që kanë nevoja

31 “Victim support services in the EU: an overview and assessment of victims’ rights in practice” FRA, i gjindshëm në: [Factsheet - Victim support services in the EU: an overview and assessment of victims’ rights in practice \(europa.eu\)](https://fra.europa.eu/fra/sites/default/files/2018-05/factsheet-victim-support-services-in-the-eu-an-overview-and-assessment-of-victims-rights-in-practice.pdf)

specifike, duke përjashtuar viktimat e tjera.³² Megjithatë, viktimat me nevoja specifike kërkojnë mbështetje më të specializuar, të cilën institucionet duhet ta mbajnë në vëmendje.

E. Ofruesit e shërbimeve.

Direktiva “2012/29/EU” thekson se, “...shërbimet mbështetëse të viktimave dhe çdo shërbim i specializuar mbështetës mund të krijohen si organizata publike ose joqeveritare dhe mund të organizohen në baza profesionale ose vullnetare.” (neni 8/4). Kjo do të thotë se, shërbimet mund të ofrohen nga:

- vetë autoritetet shtetërore,
- agjencitë e ngarkuara me detyra në këtë fushë,
- Organizatat joqeveritare.

Me këtë Direktivë janë përafruar parashikimet ligjore për shërbimet e krijuara në Shqipëri, të cilat kanë nevojë të shtohen dhe të përmirësohen. Gjithashtu, ka nevojë edhe për një koordinim më të mirë midis institucioneve për referimin e viktimave në këto shërbime.

32 Shih: “REPORT FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL on the implementation of Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA,” i gjindshëm në: [EUR-Lex - 52020DC0188 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020DC0188)

II. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN.

Të drejtat e viktimave të sanksionuara rishtazi në Kodin e Procedurës Penale, e kanë përafruar këtë të fundit me standardet ndërkombëtare e në mënyrë të veçantë, me Direktivën “2012/29/EU” të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (25 tetor 2012). Një klasifikim i të drejtave të viktimave sipas KPP-së është kryer nga teoria e së drejtës me synim procesin e rregullt ligjor.³³ Për nga natyra e të drejtave, ato mund të grupohen në katër kategori kryesore:

- *Të drejtat e viktimës për informim*
- *Të drejtat e viktimës për mbështetje;*
- *Të drejtat e viktimës për të marrë pjesë në procesin penal;*
- *Të drejtat që lidhen me mbrojtjen e viktimave.*

Kjo ndarje shërben për të testuar edhe shkallën e përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivën e sipërpërmendur. Përqasja me standardet ndërkombëtare ndihmon mjaft për zbatimin efektiv të tyre. Në këtë aspekt evidentojmë edhe kërkesat që burojnë për organet e sistemit të drejtësisë për zbatimin e tyre.

1. Legjislacioni shqiptar për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, 2017, e përafruan këtë të fundit me Direktivën e Bashkimit Evropian. Megjithatë, për të

³³ Anastasi A., “Për një klasifikim ...”, cituar.

njohur shkallën e përafrimit ka nevojë për një analizë gjithëpërfshirëse të legjislacionit në këtë fushë. Kjo, pasi mjaft prej parimeve dhe standardeve të saj janë transpozuar jo vetëm në Kod, por edhe në akte të tjera ligjore e nënligjore. Edhe vetë Direktiva thekson se shtetet anëtare duhet të miratojnë “...ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme...” që të jenë në përputhje me këtë Direktivë. Prandaj, një studim i integruar përqaesës i tyre, na jep një pamje më të plotë të përafrimit me legjislacionin e BE-së (neni 27).

Përpos ndryshimeve të KPP-së, të cilat përmirësuan rrënjësisht statusin e viktimës në procesin penal, ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,³⁴ ka përcaktuar detyrat e prokurorisë dhe organeve të saj në lidhje me zbatimin e të drejtave të viktimave. Midis të tjerave, ky ligj thekson shprehimisht se, “Prokuroritë duhet të garantojnë shërbimet e nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas Kodit të Procedurës Penale” (neni 68/1). Për këtë, “Secila prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator, të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.” (neni 68/2). Në zbatim të tij, pranë Prokurorisë është krijuar edhe një strukturë e posaçme për asistencën e subjekteve me status të posaçëm (ku përfshihen edhe viktimat e krimit),³⁵ drejtoria e së cilës, koordinon punën e koordinatorëve të viktimave, psikologëve dhe punonjësve të tjerë.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm. Veçanërisht, Udhëzimi “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, (2018)³⁶ si dhe ai “Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje”

34 Ligj Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

35 Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 05, datë 26.10.2018, Për “GARANTIMIN E ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE TË VEPRAVE PENALE”, e gjindshëm në: [udhezim_dhe_deklarata_1418.pdf \(pp.gov.al\)](#).

36 Po aty.

(2020)³⁷, lidhen ngushtë me të drejtat e mbështetjes dhe të mbrojtjes së viktimave. Këto udhëzime e kanë detajuar funksionin e Prokurorit dhe të punonjësve të tjerë në lidhje me shërbimet e mbështetjes.

Ka raste që përfshirja e prokurorit në shërbime mbështetëse është parë me skepticizëm. P.sh., ka pasur mendime se përgjegjësia drejtuese e Prokurorit lidhet vetëm me të drejtat e pjesëmarrjes së viktimës dhe jo me ato mbështetëse që i përkasin kryesisht rehabilitimit të saj. Prandaj, mendohet se për këto të fundit duhet të jenë përgjegjës institucione të tjera. Por, roli aktiv dhe drejtues i prokurorit për respektimin e të drejtave të viktimave buron qartë nga standardet ndërkombëtare. Megjithatë, është e domosdoshme të krijohet një sistem institucionesh të koordinuara, me të gjitha shërbimet e nevojshme për mbështetjen e viktimave, në të cilat prokuroria mund të referojë.

2. Zbatimi i legjislacionit shqiptar në përafrim me standardet ndërkombëtare.

Zbatimi i legjislacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare varet nga shumë faktorë, siç janë: kuptimi i standardeve, ndarja e kompetencave, burimet njerëzore, kualifikimi i këtyre të fundit, etj. Por në këtë pjesë të studimit, do të analizohet se si mekanizmat e parashikuara shprehimisht nga aktet ligjore e nënligjore kombëtare, të përafruara me standardet ndërkombëtare ndihmojnë për një zbatim të mirë të tyre. Në këtë këndvështrim, synohet të evidentohen edhe mangësitë e legjislacionit tonë në lidhje me transpozimin dhe zbatimin e këtyre standardeve.

Udhëzimi i Përgjithshëm i PP-së (2018) në nenin 3 të tij sanksionon se, të drejtat e parashikuara nga legjislacioni ynë i brendshëm duhet të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me standardet dhe normat e akteve ndërkombëtare. Ky parashikim mund të zbatohet në situata

37 Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 17, datë 23.12.2020, “Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje.”, e gjindshme në [Udhëzime të Prokurorit të Përgjithshëm \(pp.gov.al\)](http://pp.gov.al)

të ndryshme. P.sh., në rastin kur këto norma ose standarde nuk janë transpozuar nga e drejta e brendshme, atëherë zbatohet drejtpërdrejt akti ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Gjithashtu, aktet e brendshme që vijnë në kundërshtim me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nuk mund të zbatohen.³⁸

Për zbatimin e Udhëzimit të sipërpërmendur (neni 3) në lidhje me Direktivën 2012/29 e BE-së, duhet përmendur se ka një status specifik, për shkak se nuk jemi ende një vend anëtar i Bashkimit Evropian. Në radhë të parë kjo dispozitë nënkupton përafrimin e legjislacionit me këtë direktivë. Por edhe në procesin e zbatimit, ka detyrim për zbatimin e saj, që vjen nga marrëveshja e stabilizim asociimit dhe nga proceset vijuese për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.³⁹

Në këtë kuadër, një rol veçanërisht të rëndësishëm për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave ka edhe zbatimi i Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).⁴⁰ Përpos të tjerave, kjo Konventë ka parashikuar që: *“Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune.”* (neni 20/1).

Cilat janë kërkesat e tyre për legjislacionin dhe praktikën në Shqipëri? Këto standarde kërkojnë një transpozim të tyre në legjislacionin shqiptar, ndarje të detyrave midis organeve kompetente, si dhe koordinim institucional, me qëllim që prokuroria të ketë bashkëpunimet e nevojshme për të informuar dhe referuar viktimat pranë shërbimeve mbështetëse. Prandaj, të tjera detajime janë parashikuar nga Udhëzimi i Përgjithshëm i PP-së (2020) në lidhje me

38 Për zbatimin e drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare shih: “Anastasi, A., Omari L., “E drejta Kushtetuese”, cituar, fq. 56-57

39 Po aty, fq. 57-58

40 Shih: “Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, 2011. E gjindshme në: <https://rm.coe.int/168046246b>

shërbimet ndaj viktimave të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje. Ky udhëzim adreson zbatimin e të drejtave në mënyrë të posaçme për viktimat e veprave penale të kësaj kategorie. Ai ka shprehur qartë detyrimin e prokurorëve që të njohin dhe zbatojnë standardet dhe normat e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (neni 3). Referimi i drejtpërdrejtë në këto akte ndërkombëtare parashikohet nga vetë Kushtetuta e Shqipërisë (neni 122). Disa standarde ndërkombëtare për mbështetjen e viktimave janë parashikuar shprehimisht nga udhëzimet e PP-së si dhe në akte të tjera të brendshme. P.sh., në Udhëzimin e PP-së 2020 vendoset se, *“Gjatë gjithë procesit, Prokurori dhe oficeri i Policisë gjyqësore kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës”* (neni 6/4).

3. Parimet e ofrimit të shërbimeve mbështetëse.

Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale (2018), thekson se Prokuroria garanton drejtpërsëdrejti që viktimat të kenë mundësinë të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat dhe të përfitojnë asistencën që u njihet nga ligji (neni 7/a). Ky udhëzim ka renditur parimet themelore të asistencës ndaj viktimave, të cilat në fakt u përkasin të gjitha të drejtave dhe jo vetëm atyre të mbështetjes me shërbime. Ai bën një analizë të detyrave përkatëse për organet e prokurorisë dhe të koordinimit institucional, me qëllim zbatimin e tyre. Konkretisht, janë përcaktuar parimet themelore të veprimtarinë e prokurorisë në mbështetje të viktimave: garantimi i drejtpërdrejtë i ushtrimit të të drejtave, garantimi i ushtrimit të të drejtave në mënyrë efektive, të barabartë, në proporcion për sa e lejojnë burimet njerëzore dhe burimet financiare të secilit institucion. (neni 7)

Gjithashtu, në aktet e brendshme janë parashikuar edhe parime të rëndësishme që e përafrojnë legjislacionin tonë kombëtar me atë të BE-së dhe me aktet e tjera ndërkombëtare. Të tilla janë parimet e organizimit dhe funksionimit të institucioneve në lidhje me mbështetjen e viktimës, të cilat i përmbledhim si më poshtë:

- *Detyrimi i organit të prokurorisë për të ofruar asistencën ndaj viktimave.* Legjislacioni parashikon të ofrohet në mënyrë të detyrueshme nga institucionet asistencë ndaj viktimave, për ushtrimin e gëzimit të drejtave.

- *Inkurajimi i institucioneve të ofrojnë asistencë të natyrave të tjera ndaj viktimave të krimit,* kur është e përshtatshme dhe e mundur, në varësi të rrethanave. Këtu është fjala edhe për asistencë që shkon tej standardeve minimale apo përtej sanksionimeve të shprehura në legjislacion.

- *Viktima nuk është e detyruar t'i ushtrojë të drejtat e saj apo ta pranojë asistencën që ofrohet nga ligji.* Ajo mund të zgjedhë, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzojë marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave. Prandaj, Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë nuk janë të detyruar t'i ofrojnë asistencë ose të mbështesin në ushtrimin e të drejtave viktimën që ka marrë një vendim për të refuzuar asistencën. Por kjo zbatohet duke pasur prioritet shërbimin ndaj viktimës, në raport me refuzimin e saj. Prandaj, institucionet sigurohen se viktima është e ndërgjegjshme për pasojat. Prokurori si organ drejtues, angazhohet e sigurohet vetë që viktima të kuptojë rëndësinë e të drejtës dhe pasojat e refuzimit të saj. Ai saktëson nëse refuzimi është për një lloj asistencë apo për një të drejtë, apo për të gjitha ato.

- *Parimi i prezumimit të pranimit të asistencës në raport me atë të refuzimit të saj nga viktima.* Ky parim nuk e lejon organin përgjegjës që të prezumojë refuzimin e viktimës dhe ta përdorë këtë si shkak për mos ofrimin e asistencës ose të shërbimeve.

- *Parimi i koordinimit institucional.* Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë mbështesin njëri-tjetrin, për aq sa është e mundur, me qëllim ofrimin e asistencës së qëndrueshme që plotëson nevojat e viktimave. Megjithatë, parimi të koordinimit institucional shtrihet jo vetëm midis organeve të brendshme, por edhe jashtë institucionit. Kur viktima ka nevojë për asistencë që ofrohet

nga një agjenci tjetër shtetërore, personeli i prokurorisë koordinon me to dhe prezanton nevojat e saj tek zyrat ose agjencitë e tjera. Në çdo rast, prokurori ushtron rolin e tij drejtues dhe nuk ka vend për ndonjë procedurë hierarkie për këto koordinime.

- *Parimi i mbrojtjes së privatësisë së viktimave.* Shtrihet në të gjitha fazat, gjatë dhe pas procesit penal, duke përfshirë jo vetëm organet e brendshme të Prokurorisë, por edhe autoritetet, agjencitë apo organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat.

- *Parimi i afatit të arsyeshëm,* i cili përfshin të gjithë procesin hetimor.

- *Respektimi i dinjitetit të viktimës,* është një parim që përshkon të gjithë procesin penal.

Parime të sanksionuara nga Direktiva e sipërpërmendur gjejnë sanksionim të shprehur edhe në akte të tjera ligjore. Shërbimet e mbështetjes, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë një rregullim për organizimin e funksionimit të shërbimeve, në aktet ligjore të fushës sociale. Prandaj, koordinimi me institucionet jashtë prokurorisë ka nevojë për vëmendje. Aktualisht, kemi një legjislacion për organizimin e shërbimeve për grupe të caktuara të viktimave, sidomos për viktimat e dhunës në familje, të dhunës seksuale e të trafikimit të qenieve njerëzore, por ato janë të pamjaftueshme.⁴¹ Gjithashtu, ka nevojë për një shtrirje të shërbimeve ndaj të gjitha kategorive të viktimave, sikurse kërkohet nga Direktiva.

41 Shih më gjerë: SHADOW RAPORT ON THE IMPLEMENTATION OF THE COUNCIL OF EUROPE CONVENTION ON PREVENTING AND COMBATING VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE (ISTANBUL CONVENTION), Monitoring Network Against Gender Based Violence, 2023, i gjindshëm në <https://rm.coe.int/shadow-report-of-the-monitoring-network-against-gender-based-violence-/1680ac6fca> fq. 11-22

4. Shërbimet e mbështetjes dhe roli i institucionit të Prokurorisë.

Shërbimet mbështetëse nuk kanë qenë të parashikuara në mënyrë klasike nga kodet e procedurës penale. Prandaj, më parë prokuroria nuk ka qenë e angazhuar në mbështetjen e viktimave. Ndryshimet e reja të KPP-së bënë një kthesë rrënjësore për punën e prokurorit dhe të gjitha organeve prokurorisë, duke i shndërruar në institucione me rol aktiv për zbatimin e të drejtave të viktimave të krimit, të informimit, mbrojtjes, pjesëmarrjes dhe mbështetjes.

Në Kodin e Procedurës Penale është sanksionuar shprehimisht e drejta e viktimës *“të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;”* (Neni 58/1/b i KPP). Një plotësim i listës së shërbimeve parashikohet nga udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të sipërpërmendura. Roli i organit procedues në lidhje me to, është vendimtar për një proces të rregullt ligjor. Megjithatë, efektiviteti i shërbimeve për mbështetjen e viktimës mbetet një çështje e kooperimit institucional, i cili ka nevojë të rregullohet më konkretisht në legjislacion. Deri tani nuk kemi ndonjë praktikë apo jurisprudencë se si mund të lidhet çështja e mbështetjes dhe shërbimeve me procesin e rregullt ligjor, porse në të ardhmen ka mundësi të drejtohen kërkesa me këtë objekt. Prokuroria është institucioni themelor që mbështet viktimën përgjatë procesit penal.

Kur flasim për Prokurorinë si institucion, kemi parasysh rolin e organeve të saj të brendshme ku spikasin:

1. Roli drejtues i prokurorit,
2. Roli i punonjësit të policisë gjyqësore,
3. Roli i koordinatorit të viktimave dhe i personelit të prokurorisë.

Policia gjyqësore dhe Prokurori e njoftojnë viktimën (përfaqësuesin ose trashëgimtarët e saj), në lidhje me të drejtat e tyre. Pra, përpos

njoftimit formal të të drejtave të parashikuara nga paragrafi i nenit 58/1/b i KPP-së, është e nevojshme që viktimat të informohet edhe se ku mund t'i gjejë këto shërbime, si dhe të referohet e prezantohet pranë tyre.

Sipas standardeve ndërkombëtare për mbështetjen e viktimave, këto detyra i kryen institucioni që kontakton për herë të parë viktimën. Mund të ndodhë që punonjësit e organit procedues ta kontaktojnë viktimën për herë të parë. Por shpesh ndodh që të parat të takohen organe të tjera, sidomos Policia e Shtetit ose organet vendore. Prandaj, ka nevojë për një ndarje më të mirë të detyrave institucionale, në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të viktimës. Sidoqoftë, në çdo moment, roli i organit procedues mbetet shumë i rëndësishëm për kontrollin e vlerësimit të nevojave dhe realizimin e shërbimeve mbështetëse ndaj viktimës, në lidhje me përmbushjen e të drejtave mbështetëse.

4.1. Roli drejtues i Prokurorit për mbështetjen ndaj viktimës.

Deri tani, është shkruar gjerësisht vetëm mbi autoritetin e prokurorit për të drejtuar hetimet dhe shumë pak për rolin e tij drejtues në mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave. *“Prokurorët kanë autoritetin të drejtojnë hetimet, të kryejnë vetë çfarëdolloj veprimi hetimor që gjykojnë të arsyeshëm dhe t'i delegojnë veprime hetimore policisë gjyqësore.”*⁴² Duhet theksuar se, krahas të drejtave të pjesëmarrjes në procesin penal, Prokurori drejton punën edhe për përmbushjen e të drejtave të mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave.

Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm për garantimin e të drejtave të viktimave (2018) ka përcaktuar se *“Autoriteti përgjegjës për garantimin e të drejtave të viktimave gjatë fazës së hetimeve paraprake është prokuroria.”* (neni 7). Gjithashtu, në udhëzim janë përcaktuar detyrat e prokurorit dhe të punonjësve të tjerë të Prokurorisë

⁴² Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri, OSBE, Tiranë, 2019, fq. 14.

për asistencën ndaj personave me status të posaçëm në procesin penal, ku përfshihen edhe viktimat e veprës penale.

Të tjera detaje janë parashikuar në lidhje me shërbimet ndaj viktimave të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm (2020). Ky udhëzim adreson zbatimin e të drejtave që KPP-ja ka parashikuar në mënyrë të posaçme për viktimat e veprave penale të kësaj kategorie.

Kryerja dhe efektiviteti i shërbimeve të ofruara përmes informimit, njoftimit dhe këshillimit, kontrollohen nga Prokurori, i cili ngarkon oficerin e policisë gjyqësore ose personelin me detyrat përkatëse. Prokurori i kryen këto në bazë të Udhëzimeve, ose përmes detyrave të tjera shtesë. Prokurori sigurohet që punonjësit e policisë gjyqësore dhe sektori i asistencës t'i kenë përmbushur detyrat në lidhje me mbështetjen e viktimave. Në rast se prokurori konstaton se detyrat e parashikuara për punonjësit e policisë gjyqësore dhe për sektorin e asistencës nuk janë përmbushur plotësisht, ai merr masa që mangësitë të korrigjohen, duke u deleguar detyra konkrete policisë gjyqësore dhe/ose sektorit të asistencës ose duke vepruar vetë drejtpërsëdrejti.

Referimi i viktimave në shërbime. Prokurori udhëzohet shprehimisht që të referojë rastin kur viktimat e identifikuar u përket kategorive veçanërisht vulnerabil.⁴³ Në këto raste, prokurori bën përpjekje që viktimës t'i plotësohen nevojat e para jetike për siguri, ndihmë mjekësore, ushqim e veshmbathje dhe strehim. Prokurori njofton shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare që ofrojnë shërbimet e nevojshme, si dhe koordinatorin vendor në rastet e dhunës në familje (neni 8/ç).

Përsa më sipër, sipas udhëzimeve të PP-së, në vijim janë përmbledhur detyrat kryesore të prokurorit si organ drejtues në lidhje me ofrimin e shërbimeve mbështetëse:

43 Udhëzim i Përgjithshëm 2018, cituar, neni 8/ç

- Detyrimi i prokurorit ose organit procedues për njoftimin e viktimës për të drejtat e saj për t'u asistuar dhe mbështetur;
- Detyrimi i prokurorit ose organit procedues për ta këshilluar viktimën.
- Detyrimi i prokurorit, përfshirë të gjithë punonjësit e organit procedues sipas detyrave përkatëse ligjore, për të referuar viktimën drejt shërbimeve mbështetëse.
- Kontrolli i prokurorit për respektimin e të drejtave të viktimës.

Udhëzimi i PP-së (2018) thekson se gjatë fazës së hetimeve paraprake, punonjësi i Policisë gjyqësore ka detyrë të respektojë të drejtat e viktimës dhe t'i zbatojë ato (neni 11). Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie, punonjësi vepron vetë ose nën udhëzimet e prokurorit. Është e udhës që të përcaktohen në udhëzime se në cilat raste prokurori urdhëron punonjësit për të kryer këto detyra, rastet kur i kryen ai vetë, si dhe objekti i veprimtarisë së tij kontrolluese.

Prokurori dhe punonjësi i policisë ‘...b) të lejojnë që asistenca ... të jepet para marrjes së deklarimeve të viktimës, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e rastit.’ (neni 21/1/b i Udhëzimit të Përgjithshëm 2018). Ky parashikim lidhet me standardin e parashikuar nga Direktiva 2012/29 dhe aktet e tjera ndërkombëtare që viktimat të jetë përfituese e këtyre shërbimeve edhe pse ajo nuk ka bashkëpunuar me organin procedues.⁴⁴

4.2. Punonjësi i Policisë gjyqësore.

Edhe oficeri i policisë gjyqësore ka detyra të parashikuara shprehimisht në udhëzimin e PP-së (2018), (neni 11/a). Oficeri i policisë gjyqësore që “...merr kontaktin e parë me viktimën e mundshme...”,

44 Shih: Konventa e Stambollit, cituar, në nenin 44/4 (Juridiksioni) thekson shprehimisht: “Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre në lidhje me pikat d dhe e të paragrafit 1 të mos varet nga fakti që ndjekja penale mund të fillojë vetëm pas kallëzimit nga viktimat të veprës penale ose parashtrimit të informacionit nga Shteti i vendit ku është kryer vepra penale.”

udhëzohet që të “... sigurohet që asaj, veçanërisht nëse u përket kategorive vulnerabël, t’i plotësohen nevojat urgjente dhe t’i garantohet siguria fizike. Për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare, sipas rastit.” Shprehjen “veçanërisht nëse u përket kategorive vulnerabil”, në këtë rast do ta lexojmë me kujdes, pasi të gjitha viktimat e krimit kanë të drejtë të mbështeten dhe se vetë pozita e viktimës është vulnerabil. Ndoshta mund t’i japim një kuptim të arsyeshëm, duke konsideruar vulnerabil të gjitha kategoritë e viktimave të krimit, me përjashtim kur ato kanë mundësi të sigurojnë vetë ose përmes avokatëve privatë këto shërbime.

Punonjësi i policisë gjyqësore kryesisht, është personi që merr kontaktin e parë me viktimën. Prandaj, krahas garantimit të sigurisë fizike ai ka detyra si pikë e kontaktit të parë, për përcaktimin e shërbimeve mbështetëse dhe plotësimin e nevojave të saj urgjente. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka detyra të rëndësishme për identifikimin e viktimës, vlerësimin e dëmit dhe nevojave të saj, si dhe për vlerësimin e riskut në lidhje me viktimën. Ai e vendos viktimën në kontakt me shërbimin social në nivel vendor, si edhe me ofrues joqeveritarë të shërbimeve, nëse është rasti (KPP 58/b). Për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare.

Për të përmbushur të drejtat e mbështetjes është shumë e rëndësishme që organet e brendshme të prokurorisë të vendosin bashkëpunime me agjenci a organizata që i ofrojnë këto shërbime. Normalisht, një hartë e këtyre shërbimeve duhet të vendoset në zyrën e prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore ose koordinatorit, sikurse qëndron mbi tavolinë kodi Penal, ai i Procedurës Penale apo akte të tjera.

4.3. Koordinatori i viktimave.

Koordinatorët e viktimave kanë një rol të natyrshëm profesional në lidhje me të drejtat e mbështetjes. Përpos vlerësimit të nevojave të viktimës, ata angazhohen edhe për asistencën e viktimave dhe shërbimet mbështetëse. *Oficerët e policisë gjyqësore ose prokurorët, personalisht ose nëpërmjet koordinatorit të viktimave, i japin viktimës informacion*

lidhur me hapat që do të ndiqen për çështjen (neni 6/5 i Udhëzimit të Përgjithshëm 2018). Prandaj është i nevojshëm koordinimi midis tyre. Sipas udhëzimit, nismën për koordinim e ndërmerr oficeri ose prokurori. Kjo është e logjikshme, përse Udhëzimet e PP-së përcaktojnë oficerin e Policisë Gjyqësore si organin e brendshëm që merr kontaktin e parë me viktimën. Megjithatë, është e nevojshme që udhëzimi të veçojë ndonjë aspekt të mbështetjes së viktimave, që për shkak të emergjencave ofrohen drejtpërdrejt dhe menjëherë prej koordinatorit.

5. Koordinimi institucional

5.1. Koordinimi institucional i brendshëm.

Sikurse e trajtuam më sipër, koordinimi institucional brenda organit të prokurorisë është një nga themelet për realizimin e të drejtave të mbështetjes për viktimat. Aktet ligjore/nënligjore kanë përcaktuar detyrat për secilin prej organeve, si dhe detyrat e koordinuara brenda organit të Prokurorisë. Si më sipër, punonjësit e policisë gjyqësore, koordinatorët për viktimat, personeli i strukturave të prokurorisë bashkëveprojnë për të asistuar ose referuar viktimën me shërbime mbështetëse. Të gjitha këto veprimtari ushtrohen nën rolin drejtues dhe monitorues të Prokurorit.

Udhëzimi i përgjithshëm (2018) ka sanksionuar shprehimisht detyrimin për zbatimin e tij *“...nga të gjithë personat që vijnë në kontakt me viktimat dhe dëshmitarët, përfshirë edhe ata që kryejnë veprimtari që ndikon mbi viktimat dhe dëshmitarët, pavarësisht titullit, pozicionit, gradës apo përshkrimit të punës* (neni 3/2).” Në kontekst, kjo do të thotë se për përmbushjen e të drejtave të viktimave angazhohen jo vetëm organet e brendshme të sipërcituara (Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe koordinatori), të cilat kanë detyra thelbësore për mbështetjen e tyre, por edhe punonjësit e tjerë. Këta të fundit, edhe pse janë ngarkuar me detyra të tjera në institucion, në rast të nevojave, angazhohen edhe për përmbushjen e të drejtave të viktimave. Roli drejtues ushtrohet

gjithmonë nga prokurori.

Të gjitha organet e brendshme të prokurorisë mbajnë në vëmendje disa udhëzime në lidhje me të drejtat e mbështetjes dhe shërbimet ndaj viktimës (neni 21 i Udhëzimit, 2018):

- a) *të jenë të ndërgjegjshëm për arsyen e parashikimit të kësaj të drejte dhe nevojën që kanë viktimat për këto lloj asistencash; Për këtë është e nevojshme të kryhet një vlerësim paraprak i nevojave të viktimave të krimit.*

- c) *t'i japin koordinatorit të caktuar për çështjen konkrete të gjithë informacionin e nevojshëm që lejon të përcaktohen shërbimet më të përshtatshme për viktimën...; Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore kontaktojnë viktimat dhe pasi kryejnë një vlerësim paraprak e informojnë koordinatorin vendor në lidhje me nevojat e viktimës.*
- ç) *të referojnë viktimën tek shërbimet e përshtatshme, nëse koordinatori mungon apo nuk është e mundur të pritët prania e koordinatorit. Referimi i viktimës pranë shërbimeve sipas nevojave të saj kryhet nga koordinatori i viktimave. Në rastet kur koordinatori mungon atëherë referimi kryhet nga oficeri i policisë gjyqësore ose vetë Prokurori.*
- d) *të kenë kujdes në ndërmarrjen e veprimeve procedurale që mund të ndërhyjnë në përfitimin e shërbimeve nga ana e viktimës.*

Këto kujtesa për veprimtarinë e institucioneve të brendshme të prokurorisë, janë garanci për respektimin e të drejtave të viktimave, si dhe për ofrimin e shërbimeve mbështetëse cilësore. Nga zbatimi i tyre varet funksionimi i mbështetjes së viktimës. Ky funksion fillon nga përcaktimi i nevojave dhe llojit të asistencës të viktimës që nevojitet e deri në referimin e viktimave në institucionet jashtë prokurorisë nga koordinatori i viktimave, në rastet kur vetë organet e brendshme të

prokurorisë nuk i ofrojnë këto shërbime.

5.2. Koordinimi institucional i jashtëm.

Të drejtat e mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave, kërkojnë koordinim institucional jo vetëm të brendshëm, por edhe të jashtëm. Prandaj, paraqiten me mjaft rëndësi rregullimet për koordinimin e prokurorisë me institucionet e tjera mbështetëse të viktimave, jashtë prokurorisë, të cilat mund të jenë autoritete shtetërore, agjenci publike ose private si dhe organizata joqeveritare. Në këtë aspekt, ka disa kërkesa kryesore për rregullimin e koordinimit, si:

- Legjitimimi i bashkëpunimit përmes akteve nënligjore dhe/ose marrëveshjeve;
- Përcaktimi i roleve përkatëse, veçanërisht rolit drejtues të prokurorit;
- Përcaktimi i kufirit të përgjegjësisë së prokurorit për të drejtat e mbështetjes, në raport me përgjegjësinë e organeve të tjera mbështetëse;
- Përcaktimi i procedurës së koordinimit;
- Përcaktimi i procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis institucioneve.

Ka një përshkallëzim të detyrave të sanksionuara nga Udhëzimi. Shkalla e parë përfshin punonjësit e brendshëm, kurse shkalla e dytë përfshin punonjësit e jashtëm që thirren me detyra nga prokurori, në kuadër të shërbimit ndaj drejtësisë. Përpos detyrimeve ligjore që kanë subjektet për të bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë, në udhëzimin e përgjithshëm (2018), është vendosur detyrimi për përmbushjen e detyrave në lidhje me të drejtat e viktimës. Në radhë të parë, ky udhëzim përfshin organet e brendshme të prokurorisë dhe subjekte të tjera që thirren pranë saj. Në radhë të parë, detyrimi për përmbushjen e të drejtave të viktimës do të kryhet “...nga të gjithë personat që vijnë në kontakt me viktimat dhe dëshmitarët, përfshirë edhe ata që kryejnë

veprimtari që ndikon mbi viktimat dhe dëshmitarët, pavarësisht titullit, pozicionit, gradës apo përshkrimit të punës.” (neni 3/2).

Së dyti, udhëzimi shtrihet edhe ndaj personave të tjerë nga jashtë prokurorisë që thirren prej saj në shërbim të funksioneve që ajo: “... këta persona jo vetëm duhet të zbatojnë detyrat e përcaktuara në këtë udhëzim, por edhe duhet të inkurajojnë çdo person të jashtëm që caktohet të ushtrojë aktivitet në emër të prokurorisë (p.sh: ekspert, përkthyes, etj.) që të mbajë parasysh të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe detyrimet ndaj tyre, si dhe të zbatojë këtë udhëzim.” (neni 3/2).

Së treti, Udhëzimi shkon edhe më tej duke përfshirë agjenci të tjera shtetërore jashtë prokurorisë. Udhëzimi thekson se ai vetë “...mund të shërbejë si model edhe për agjenci të tjera shtetërore, veçanërisht ato që kryejnë funksione të zbatimit të ligjit apo ato që kanë polici gjyqësore në përbërjen e tyre.” (neni 3/2).

Sikurse shihet nga konteksti, ky parashikim i drejtuesit të institucionit të Prokurorisë i shtrirë edhe jashtë prokurorisë ofron një model bashkëpunimi. Ai mbështetet plotësisht në standardet ndërkombëtare për të drejtat e viktimave, si dhe në standardet ligjore në vend, të cilat kërkojnë bashkëpunim me institucionet e drejtësisë dhe koordinim për mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Pra, mund të flasim për një model të koordinimit midis institucioneve, i cili është i hapur, sipas nevojave të viktimave.

Standardet e Direktivës 2012/29 si dhe ligjet e brendshme, përcaktojnë detyra për institucione të ndryshme nga të cilat kërkohet bashkëpunimi për ushtrimin e detyrave. Një shembull i tillë është detyra për bashkëpunimin me mekanizmin vendor të referimit për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, i rregulluar me VKM.⁴⁵ Sidoqoftë, edhe në mungesë të aktit të shkruar, në çdo rast, ekziston një detyrim për bashkëpunimin institucional midis institucioneve.

45 Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

Për gjithë sa kemi trajtuar më sipër, konkludojmë se përgjegjësia e organit procedues sa u përket të drejtave të mbështetjes së viktimave, është njoftimi i shërbimeve, informimi në lidhje me to, këshillimi, referimi i viktimave dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera për mbështetjen e nevojshme. Prandaj, një përcaktim më i hollësishëm se cilat nga shërbimet mund të jepen drejtpërdrejt nga organi i procedimit penal dhe cilat prej tyre duhet të referohen nga ky organ tek autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse, do të lehtësonte koordinimin dhe do të rriste performancën e mbështetjes së viktimave. Praktikisht, është e nevojshme edhe hartimi i rregullave procedurale për referimin e shërbimeve. Për këtë nevojitet një tabelë transparente apo një hartë e ofrimit të shërbimeve të brendshme të Prokurorisë. Gjithashtu, Prokuroria duhet të pajiset nga qeveria (ministritë përgjegjëse) me hartën e shërbimeve që ofrohen nga agjencitë ose organizatat e licencuara në të gjithë vendin. Aktualisht, nga monitorimi konstatuam se, organet e brendshme të prokurorisë nuk e disponojnë një hartë shërbimesh në të gjithë vendin, për mbështetjen e viktimave.

Për viktimat e dhunës në familje, një rol të rëndësishëm luan koordinimi i masave të sanksionuara në udhëzimet e sipërtreguara të Prokurorit të Përgjithshëm, me masat që janë parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 327, datë 2.6.2021, *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”*. Në zbatim të këtij të fundit mund të realizohet bashkëpunimi i organit procedues me autoritetet dhe organizatat për ndihmën ndaj viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Zbatimi i ligjit për ndihmën ligjore të garantuar nga Shteti, ka bërë të mundur regjistrimin e të gjitha subjekteve dhe organizatave që ofrojnë shërbime ligjore falas në këtë fushë. Praktikisht, ka nevojë të koordinohet me institucionet përgjegjëse, në mënyrë që kjo listë t’i bëhet e njohur Prokurorisë sa herë që përditësohet. Prokurori, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët e viktimave duhet të kenë akses për informacion dhe

bashkëpunim me këto organizata. Një mundësi tjetër është edhe komunikimi me koordinatorin vendor kundër dhunës në familje, si dhe me të gjitha institucionet që janë anëtare të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor pranë pushtetit vendor. Ka raste kur shërbimet e nevojshme janë shumë specifike dhe të paparashikuara për shkak të natyrës së ndryshme të veprave penale. Sidoqoftë, në çdo rast, kryhet një vlerësim i nevojave të viktimës për të parë se cilat janë dëmtimet që ka pësuar ose mund të pësojë ajo si pasojë e veprës penale dhe, mbi bazën e këtij vlerësimi ofrohen dhe referohen shërbimet mbështetëse.

Prokuroria ka detyrë të mbështesë të gjitha kategoritë e viktimave dhe jo vetëm ato të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Prandaj, bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të specializuara, krijon mbështetje për viktimat dhe një rritje të performancës së kësaj mbështetjeje. P.sh., së paku në rastet e viktimave të dhunës në familje, viktimat mund të ketë marrë mbështetjen e parë nga organet e tjera të parashikuara në ligj si, policia e shtetit, koordinatorët vendorë, anëtarët e grupeve teknike vendore, organizatat jofitimprurëse, ose ndonjë subjekt tjetër. Por këto praktika duhet të koordinohen në mënyrë që institucioni i prokurorisë të pajiset paraprakisht me të gjithë dokumentacionin e mëparshëm për mbështetjen e viktimës. Është e drejtë/detyrë e

Prokurorit që të monitorojë mbështetjen për ta garantuar atë, si dhe për të referuar shërbime të tjera të munguara ose shtesë.

III. NDARJA E PËRGJEGJËSIVE INSTITUCIONALE NË KOHË.

1. Periudha e përgjegjësisë institucionale për të drejtat e viktimave.

Sa i përket koordinimit institucional, shtrohet edhe çështja e përcaktimit të periudhës përgjatë të cilës institucioni duhet të veprojë me qëllim përmbushjen e të drejtave. Standardet ndërkombëtare përcaktojnë se këto të drejta viktimat i gëzojnë gjatë gjithë procesit hetimor e gjyqësor e madje, edhe pas përfundimit të tyre. Kjo sanksionohet edhe në Direktivën 2012/29 të Bashkimit Evropian. Nenet 8 dhe 9 të saj kanë qëllim të sigurojnë që viktimat të kenë akses në shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara të mbështetjes, në përputhje me nevojat e tyre: “... *para, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurës penale.*”⁴⁶

Edhe aktet e brendshme mbajnë në vëmendje këtë standard. Në Udhëzimin e Përgjithshëm (2018) sanksionohet detyrimi për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të viktimës gjatë gjithë procesit. “*Gjatë gjithë procesit, Prokurori dhe oficeri i Policisë gjyqësore kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës*” (neni 6/4). Megjithatë, më tej i njëjti udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm thekson se: “*Autoriteti përgjegjës për garantimin e të drejtave të viktimave gjatë fazës së*

46 Shih: “REPORT FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL on the implementation of Directive 2012/29/EU...” cituar.

hetimeve paraprake është prokuroria.” (neni 7/1).⁴⁷ Në bazë të legjislacionit kjo e fundit, përfshin kohën nga regjistrimi i çështjes nën hetim deri në dërgimin e çështjes për gjykim. Prandaj lind pyetja se cili do të jetë institucioni që do të mbështesë viktimën pas përfundimit të hetimeve paraprake? Natyrisht që gjykata do të jetë organi përgjegjës. Por është e paqartë se si mund ta ushtrojë ajo këtë rol, veç rolit mbikëqyrës që ushtron ndaj veprimeve të prokurorit. Ende pa filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata është përgjegjëse të verifikojë e të konfirmojë nëse janë përmbushur të drejtat për mbështetjen e viktimës. Por, roli drejtues i saj nuk mund të realizohet pa mbështetjen e prokurorit, i cili vijon veprimet e tij në mbështetje të viktimës edhe përgjatë gjykimit. Kjo pranohet edhe nga udhëzimi i PP-së, kur udhëzon Prokurorin se duhet t’i përcjellë gjykatës informacionin lidhur me vështirësitë që i shkaktohen viktimës nga shtyrja e seancave gjyqësore (neni 18/1).

Çështja më e mprehtë shtrohet në lidhje me procedurat e mbështetjes dhe mbrojtjes pas përfundimit të procesit gjyqësor. Direktiva “2012/29/EU” e BE-së thekson se, shërbimet do të veprojnë në interes të viktimave edhe për një kohë të përshtatshme pas procedurës penale. Në Shqipëri, duket e paqartë se si do të procedohet në këtë rast. Copëzimi në kohë i përgjegjësive institucionale ka sjellë vështirësi në identifikimin e institucionit përgjegjës për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave pas përfundimit të procesit gjyqësor. Sidoqoftë, deri tani është ngritur çështja e sigurimit të njoftimit të viktimës në lidhje me lirin e autorit të veprës penale nga institucionet e vuajtjes së dënimit. Në vijim paraqitet një analizë e shkurtër e situatës ligjore në lidhje me këtë periudhë.

2. E drejta e viktimës që “të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij”.

Kjo e drejtë është afirmuar në Kodin e Procedurës Penale (neni

⁴⁷ Udhëzimi Përgjithshëm nr. 05, datë 26.10.2018, Për “GARANTIMIN E ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE TË VEPRAVE PENALE”, cituar.

58/e), për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Disa nga kushtet për zbatimin e kësaj të drejte, Kodi i vendos në nenin 279/a: “E drejta e viktimës për informim”.⁴⁸ Informimi i viktimës në lidhje me lirimin e përkohshëm ose largimin e autorit të veprës penale, ka filluar të rregullohet ligjërisht vetëm vitet e fundit. Ndërkohë, organizata të shoqërisë civile qysh dy dekada më parë, kanë ngritur shqetësimin për mosaksesin e viktimës ndaj këtij njoftimi.⁴⁹ Janë paraqitur raste përpara institucioneve se viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk njoftohen për gjendjen e shfrytëzuesit, jo vetëm për arrestimin e tij, por edhe për lirimin e përkohshëm, apo arratisjen e tij nga institucionet e dënimit.⁵⁰

Pas Ratifikimit dhe hyrjes në fuqi të Konventës së Stambollit, më 2012,⁵¹ u shtrua çështja se, cili do të jetë organi përgjegjës për kryerjen e këtij njoftimi, si dhe çështja për parashikimin e procedurave për realizimin e njoftimit në mënyrë që ai të ndodhë përpara se autori i veprës penale të jetë liruar. Fillimisht, kishte opinione të ndryshme, pasi disa juristë e shikonin një njoftim të tillë si mundësi për shkëljen e të

48 Neni 279/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon si vijon: 1. Për shkaqe të ligjshme, viktimë, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihen dhe të marrin kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit. 156/2. Prokurori mund të refuzojë kërkesën kur: a) interesi i ruajtjes së fshehtësisë së hetimit tejkalon interesin e viktimës; b) interesi i të pandehurit tejkalon interesin e viktimës; c) viktimë nuk është pyetur ende si dëshmitar. 2. Viktimë, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion në lidhje me vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit, përveçse kur njoftimi për këto fakte mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e të pandehurit.

49 Shih: SHADOW RAPORT ON THE IMPLEMENTATION OF THE COUNCIL OF EUROPE CONVENTION ON PREVENTING AND COMBATING VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE, cituar, fq. 32-35

50 Po aty.

51 Ligj nr. 104/2012 datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Fletore zyrtare nr.151, 23 Nëntor 2012, available at: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2012/151/c46d185d-6a7f-408f-977b-5f316889f361;q=Fletore%20zyrtare%20nr.151,%2023%20Nentor%202012>

drejtave të të pandehurit, ose si shkelje të sekretit hetimor. Kjo situatë lidhet edhe me faktin se pozita juridike e viktimës në procesin penal ishte thujse inekzistente. Konceptimi institucional fokusohej vetëm në garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor për të pandehurin. Megjithatë, situata ligjore është duke ndryshuar vitet e fundit, edhe pse përmirësimet ligjore janë ende të pamjaftueshme.

Në Ligjin nr. 79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*,⁵² parashikohet: *“Kur personi i dënuar lirohet, sipas parashikimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c”⁵³ të këtij neni, procedura e liritimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal, ndërsa në rastet e tjera lirimi bëhet me urdhër ekzekutimi të prokurorit. Në këto raste njoftohet dhe bashkërendohet puna me Policinë e Shtetit, që, sipas rastit, merr masa për njoftimin dhe sigurimin e jetës dhe shëndetit të viktimës së veprës penale”*.

Në ligjin nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*,⁵⁴ është parashikuar: *“Gjykata që ka dhënë vendimin, prokurori që ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe Policia e Shtetit njoftohen menjëherë për lirimin e të dënuarit dhe në raste të veçanta edhe paraprakisht. Për shtetasit e huaj njoftohet ministria përgjegjëse për punët e jashtme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.”*

Ligjet e mësipërme parashikojnë detyrimin për informim të institucioneve në mënyrë të ndërsjellë, por nuk ka parashikime as për organin përgjegjës, as për procedurat për informimin e viktimave. Nga konteksti i ligjit, mund të themi se ai ngarkon policinë e shtetit të kujdeset për informimin e viktimave. Për këtë, fillimisht, u hartua një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (nr 2194

52 Ligj nr. 79/2020 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, neni 30, paragraf. 3

53 Neni 30 paragrafi 1 parashikon se: Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur: a) përfundon kryerjen e dënimit; b) i falet dënimi i mbetur; c) amnistohet vepra penale apo dënimi i mbetur; ç) lirohet me vendim gjykate.

54 Ligj nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, neni 79, paragraf. 6

prot., datë 05.03.2019 për DPB dhe nr.897/3 prot., datë 04.03.2019 për DPPSH), por nuk u bë publike dhe mbeti e pazbatuar. Aktualisht, evidentohen disa probleme në zbatimin e këtij legjislacioni: *së pari*, njoftimi i viktimës nuk kryhet automatikisht nga institucioni; *së dyti*, nuk ka procedura dhe afate për kthimin e përgjigjes.

Në praktikë, avokatët kanë ngritur shqetësimin se për këtë informacion shpesh detyrohen të paraqesin kërkesë, për të cilën marrin përgjigje me vonesë nga organet kompetente.⁵⁵ Prandaj, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme ligjore. Nga ana tjetër, duhet të rregullohet në mënyrë të posaçme se si do të realizohet njoftimi i viktimës kur autori i veprës penale lirohet përpara përfundimit të afatit të dënimit. Informimi i viktimës për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij është një e drejtë që përmbushet automatikisht prej organit përgjegjës dhe ky i fundit, nuk të presë ndonjë kërkesë prej viktimës ose avokatit/përfaqësuesit të saj.

2.1. Analiza e rastit D.Ë.

Më 1 Mars të vitit 2023, në Tiranë, i porsaliruari nga burgu D. Ë, vrau brenda një dite 3 gra dhe plagosi tre të tjera, vetëm pse ishin gra, dy prej të cilave kishin bashkëjetuar me të. Ai ishte dënuar për dhunë në familje dhe u lirua nga burgu me vendim gjyqate, më herët se afati i dënimit. Por, asnjë nga ish-bashkëshortet nuk ishte vënë në dijeni për lirin e tij.

Pas kësaj ngjarjeje, u hartua Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve *“Për raportimin lidhur me të dhënat për persona që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit si autorë të krimeve seksuale dhe raportimin për lirin për të burgosurit e tjerë që lirohen”*.⁵⁶ Ky

55 SHADOW RAPORT ON THE IMPLEMENTATION OF THE COUNCIL OF EUROPE CONVENTION ON PREVENTING AND COMBATING VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE, cituar.

56 Urdhri Nr.559, datë 23.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve *“Për raportimin lidhur me të dhënat për persona që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit si autorë të krimeve seksuale dhe raportimin për lirin për të burgosurit e tjerë që lirohen”*.

urdhëron Institucionet e Ekzekutimit të Vuajtjes së Dënimit (IEVP) të informojnë në mënyrë të hollësishme strukturat e Policisë së Shtetit lidhur me profilin kriminal, shkallën e rrezikshmërisë për përsëritje të krimit, vazhdimin e veprimtarisë kriminale të shtetasve që lirohen nga burgu, apo për konflikte potenciale që këta shtetas kanë krijuar brenda IEVP-së, gjendjen e tyre familjare, etj. Urdhri rregullon bashkëpunimin midis policisë së Shtetit dhe IEVP-së, për informimin e kësaj të fundit dhe madje, për informimin e strukturave vendore të policisë që mbulojnë vendbanimin e të burgosurit. Por, ai nuk përmban asnjë dispozitë që rregullon njoftimin e viktimave ose të familjarëve të tyre.

Sa më sipër, ka nevojë për një plan veprimi e bashkëpunimi për të gjitha institucionet që kanë detyra nga ligji në këtë aspekt, me qëllim që në praktikë të funksionojë efektivisht kjo procedurë parandaluese, mjaft e rëndësishme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të viktimave.

IV. VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE I RISKUT PËR VIKTIMËN

1. Identifikimi i viktimës

1.1. Organet përgjegjëse për identifikimin e viktimës.

Sipas udhëzimeve të PP-së (2018 & 2020), identifikimi i viktimës, nënkupton identifikimin e emrit dhe adresën e viktimës. Në aktin e referimit të veprës penale, punonjësi i policisë gjyqësore bën identifikimin e viktimave të mundshme, për aq sa është e mundur në rrethanat e çështjes konkrete. Ai shënon në akt çdo informacion që mund të shërbejë për identifikimin e viktimave. Përgjegjësia për identifikimin e viktimës i përket prokurorit gjatë gjithë procedimit penal. Prokurori ka detyrim të identifikojë viktimën menjëherë pas konstatimit të ekzistencës së një veprë penale.

1.2. Burimet për identifikimin e viktimës/ave.

Për identifikimin e viktimave mund të përdoren edhe metodat klasike hetimore, edhe teknologjitë e reja. Të dhënat për viktimën mund të gjenden në prova që i janë sekuestruar të pandehurit. Por, në pamundësi të tyre, prokurori ndërmerr veprime aktive për identifikimin e saj. P.sh., prokurori përcjell për publikim njoftime në gazeta apo në faqe interneti, për t'u kërkuar viktimave që të kontaktojnë me prokurorinë ose policinë. Publikon numra telefoni (me ose pa pagesë), në të cilët viktimat mund të identifikohen dhe të marrin informacion për asistencën e disponueshme. Prokurori dhe institucionet e brendshme të Prokurorisë

mund të kontaktojnë me spitale, shkolla, organizata joqeveritare, për të siguruar informacionin identifikues dhe kontakte të viktimës/viktimave, etj. (nenet 137 dhe 138 të KPP-së). Pra, bashkëpunimi me institucione nga jashtë prokurorisë është shumë i nevojshëm.

Për viktimat e dhunës në familje ose për viktimat në moshë të mitur, identifikimi mund të lehtësohet edhe nga koordinatori vendor dhe/ose nga institucionet anëtare të ETN-së, ose ato të grupeve teknike për mbrojtjen e fëmijëve.⁵⁷ Gjithashtu, një ndihmesë në këtë drejtim mund të japin organizatat jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë. Këto të fundit kanë pasur një rol aktiv për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës ndaj grave dhe viktimave fëmijë.⁵⁸

1.3. Statusi i viktimës.

Statusi i jepet viktimës në procedimin penal duke i dhënë asaj letërën që përmban të drejtat e viktimës. Zakonisht, ky është edhe momenti i regjistrimit të procedimit. Viktima janë edhe familjarët e viktimës, kur ajo është ndarë nga jeta.

Për t'u kualifikuar si viktimë duhet të përcaktohet se dëmi i pretenduar është pasojë direkt e veprës penale, për të cilën kryhet hetimi. Sipas Udhëzimit të PP 2018, dëmi mund të jetë *fizik, emocional* ose *pasuror*. Dëmi fizik përcaktohet nga ekspertiza mjekësore, ndërsa dëmi pasuror evidentohet nga përlllogaritja e humbjeve ekonomike që ka pësuar viktima.

Dëmi emocional ka disa veçori specifike. Zakonisht ai vjen si pasojë e dëmeve fizike dhe ekonomike. Por, mund të ndodhë që ai të pretendohet nga viktima edhe pse nuk ka ardhur dëm fizik ose ekonomik. Në këto raste, Prokurori i Përgjithshëm udhëzon që ai të prezumohet në krimet e dhunshme, pavarësisht nëse ka pasur apo jo,

57 Shih: Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës".

58 Po aty.

dëm fizik ose ekonomik. Konkretisht: *Në rastet e krimeve të dhunshme, kur nuk pretendohet dëm fizik ose pasuror dhe kur viktimat ka qenë e pranishme gjatë kryerjes së aktit të dhunshëm ose, edhe nëse nuk ka qenë e pranishme, ka mësuar për akte të dhunshme të kryer ose tentuar kundër saj, prezumohet se ajo (viktima) ka pësuar dëm emocional.*” (neni 38/2 i Udhëzimit të PP 2018). Në të gjitha rastet e tjera, dëmi emocional nuk prezumohet në mungesë të dëmit fizik ose pasuror, por ekzistenca e tij përcaktohet në mënyrë faktike dhe objektive.

Sa më sipër, analizojmë se si legjislacioni ynë është përafruar me standardet e Direktivës 2012/29 të BE-së, e cila e ka përkufizuar viktimën “... një person fizik që ka vuajtur dëm, përfshirë dëmin fizik, mendor ose emocional ose humbje ekonomike që janë shkaktuar drejtpërdrejt nga vepra e krimit.” Sikurse konstatojmë, në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm (2018) mungon komponenti i **dëmit mendor**. Në fakt, ai është një term përgjithësues që përfshin patologjitë e shëndetit mendor për shkak të krimit që ka ndodhur dhe nuk mund të anashkalohet. Madje, dëmi emocional mund të shndërrohet në të ardhmen një patologji e shëndetit mendor. Prandaj, dëmi i shëndetit mendor ka rëndësi në identifikimin e viktimës dhe duhet të parashikohet në një nga aktet tona të brendshme. Sidoqoftë, kjo mungesë nuk mund të ndikojë praktikën institucionale ose jurisprudencën gjyqësore. Këto të fundit, mund të zbatojnë drejtpërdrejt Direktivën e BE-së dhe konventat e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Ky është një nga rastet e zbatimit të nenit 3 të udhëzimit të përgjithshëm të PP (2018).

2. Vlerësimi individual dhe përcaktimi i nevojave për viktimën.

Pasi ka kryer identifikimin e viktimës dhe një vlerësim të dëmit të pësuar, prokuroria kryen edhe një vlerësim paraprak të nevojave që ka viktimat për shërbimet mbështetëse dhe për mbrojtjen e saj. Në bazë të direktivës 2012/29 të BE-së, procedurat ligjore sigurojnë që viktimat të marrin një vlerësim në kohë dhe individual, për të identifikuar nevojat specifike për mbrojtjen e tyre dhe për të përcaktuar nëse dhe

në çfarë mase do të përfitonin nga masat e veçanta gjatë procesit penal, (p.sh., mënjanimin e viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, ndalimin e frikësimit dhe hakmarrjes, etj.) Në veçanti, ky vlerësim, mban parasysht: *karakteristikat personale të viktimës; llojin ose natyrën e krimit si dhe rrethanat e tij*. Një vëmendje e veçantë u kushtohet viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të natyrës së rëndë të krimit, viktimave që kanë pësuar një krim të kryer me një paragjykim ose motiv diskriminues, etj. Sikurse kemi cituar, në bazë të Direktivës, të tilla konsiderohen viktimat e terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore, dhunës në një marrëdhënie të ngushtë, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose krimit të urrejtjes, si dhe viktimat me aftësi të kufizuara (art. 22).

Përpos detyrave që parashikohen nga udhëzimi (2018) i PP-së për vlerësimin individual për përcaktimin e nevojave për mbrojtje, ka nevojë të zhvillojmë një model të hollësishëm të raportit të vlerësimit, të parashikuar në anekset e udhëzimeve. Kjo do të lehtësonte procedurat dhe punën e personave përgjegjës, do të kursente kohë, si dhe do të ndihmonte për përmirësimin dhe unifikimin e kriterëve të vlerësimit individual dhe përcaktimit të nevojave për mbështetje.

Për viktimat e dhunës në familje, në bazë të akteve nënligjore, kryhet vlerësimi i riskut nga organet e policisë së Shtetit. Ka një model raporti për vlerësimin e riskut, i cili ndihmon edhe në vlerësimin e nevojave për mbështetje. Në model janë përcaktuar pyetje në lidhje me faktorët e riskut për viktimën.⁵⁹ Natyrisht, modeli nuk është plotësisht ezaurues dhe pyetje të tjera mund të vendosen në lidhje me nevojat specifike të viktimës për mbështetje dhe mbrojtje.⁶⁰ Kështu, p.sh., për

59 Udhëzimi i përbashkët Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”. e gjindshme në Fletore Zyrtare nr. 204, Vitit 2018

60 Anastasi, Aurela, URDHRI PËR MASAT PARAPRAKE TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME (December 31, 2021). KOMENTAR I LIGJIT PER MASA NDAJ DHUNES NE MARREDHENIET FAMILJARE, Ending Violence against Women, Tiranë, 2021, p.146-159, Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=4304764>

një viktimë me aftësi të kufizuara parashtrohen pyetje që lidhen me nevojat specifike për mbështetjen shëndetësore të saj, si dhe faktorë të tjerë të riskut për viktimën, që kërkojnë shërbime.⁶¹ Kurse, në vlerësimin e riskut për hartimin e Planit të sigurisë për viktimën shtrohen pyetjet: *“Viktima do të qëndrojë në shtëpi apo duhet të largohet menjëherë? (faktorë të riskut për viktimën) Cilat janë problemet shëndetësore të viktimës? (faktorë të riskut për viktimën) Në varësi të problemeve shëndetësore do të planifikohen edhe ndërhyrjet.”*⁶²

Në të gjitha rastet kur ky vlerësim paraprak është kryer nga institucione të tjera, është e udhës që të verifikohet dhe përmirësohet nga prokuroria, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e saj më pozitive. Identifikimi i nevojave të viktimës pas sjell veprime aktive për këshillimin dhe referimin e viktimës pranë shërbimeve. Natyrisht, prokuroria ofron vetë disa shërbime, të cilat i ka organizuar pranë saj. Si e tillë mund të jetë mbështetja emocionale dhe ajo psikologjike, këshillimi ligjor, këshillimi për shërbimet mbështetëse, etj. Sidoqoftë, *“...për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare, sipas rastit.”* (neni 11/a). Mund të ketë edhe bashkëpunime të tjera, p.sh., ato spitalore. Qendra “LILIUM” aktualisht, është e vetmja qendër kombëtare e specializuar për mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale.⁶³ Por ka edhe qendra dhe agjenci të tjera të specializuara në vend, që ofrojnë shërbime. Prandaj, rikonsiderohet e domosdoshme një hartë dokumentare për të njohur agjencitë dhe organizatat që ofrojnë shërbime në të gjithë vendin, si kombëtare, edhe rajonale. Bashkëpunimi me to buron automatikisht nga ligji dhe nuk ka asnjë nevojë për marrëveshje apo akte të tjera shtesë. Madje, Prokurori

61 PROTOKOLL MBI PLANIFIKIMIN E SIGURISË PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NGA KOMUNITETI ROM DHE NGA KOMUNITETI LGBTI, Tiranë, 2020, i gjindshëm në: [Protokoll_mbi_planifikimin_sigurise_viktimat_dhune.pdf \(adrf.al\)](#)

62 Po aty, fq. 10.

63 SHADOW RAPORT ON THE IMPLEMENTATION OF THE COUNCIL OF EUROPE CONVENTION ON PREVENTING AND COMBATING VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE, cituar, fq. 12.

i Përgjithshëm mund të detajojë kërkesa dhe procedura të hollësishme që shërbejnë si model dhe zbatohen drejtpërdrejt nga organizatat dhe agjencitë në këtë fushë. Ka një detyrim të përgjithshëm që subjektet të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë.

3. Vlerësimi i Riskut dhe mbrojtja/mbështetja e viktimës.

3.1. Vlerësimi i riskut të dhunës në familje.

Ka një lidhje të ngushtë të vlerësimit të riskut me të drejtat e viktimës për t'u mbështetur, sidomos kur është fjala për identifikimin e nevojave për shërbime me qëllim mbrojtjen e jetës, mbrojtjen nga frikësimet dhe kërcënimet e mundshme, nga riviktimizimi, etj. Legjislacioni shqiptar ka disa parashikime të pjesshme për vlerësimin e riskut. Ai është sanksionuar në mënyrë të veçantë për viktimat e dhunës në familje.⁶⁴ Kjo, në sajë të përafrimit të legjislacionit shqiptar me Konventën e Stambollit (Neni 51), e cila parashikon detyrimin e shteteve për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Konventa e Stambollit detyron palët që të marrin masat e nevojshme legislative ose të tjera, për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur, të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme, për të siguruar mbështetje dhe

64 Përpos amendamenteve ligjore të ligjit kundër dhunës në familje, në Qershor të vitit 2021 është miratuar VKM Nr. 327, datë 2.6.2021. Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut rregullohet nga burimet e së drejtës që vijnë:

Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar (art.13/1).

Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”. e gjindshme në Fletore Zyrtare nr. 204, Vitit 2018

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

siguri të koordinuar. Sipas saj, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, vlerësimi i rrezikut të marrë parasysh faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit. Ajo “...përcakton detyrimin për të garantuar se të gjitha autoritetet përkatëse, pa u kufizuar vetëm te policia, vlerësojnë dhe hartojnë në mënyrë efikase një plan për të menaxhuar rreziqet e sigurisë, që një viktimë e veçantë has në situatat rast pas rasti, në bazë të procedurës së standardizuar dhe në bashkëpunim dhe koordinim me njëra-tjetrën”.⁶⁵

Koordinimi institucional përgjatë gjithë procesit kërkon ndarjen e detyrave institucionale dhe përcaktimin e procedurave të qarta për bashkëpunimin midis tyre, gjatë gjithë procesit penal. Një moment relevant paraqitet në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.⁶⁶ Ky ligj kërkon kryerjen e vlerësimit të rrezikut dhe ngarkon për këtë policinë e shtetit. Kur nga kryerja e vlerësimit rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës/ave dhe për ndalimin e dhunës, duke lëshuar Urdhrin për masat paraprake mbrojtëse (UMPMM) (neni 13/1).

Për procedurat dhe kërkesat e vlerësimit të riskut nga policia e shtetit, janë hartuar disa akte nënligjore. Aktualisht, janë të miratuara dhe zbatohen dy udhëzime, njeri prej të cilëve për procedurat e vlerësimit të riskut⁶⁷ dhe tjetri për lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).⁶⁸

65 Memorandum shpjegues, Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, CAHVIO, paragrafi 257.

66 Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar

67 Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866, datë 20.12.2018, cituar.

68 Shtetet anëtare sigurojnë që viktimat të marrin një vlerësim në kohë dhe individual, në përputhje me procedurat kombëtare, për të identifikuar nevojat specifike të mbrojtjes dhe për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase do të përfitonin nga masat e veçanta gjatë procesit penal, siç parashikohet në nenet 23 dhe 24, për shkak të

3.2. Detyrimi institucional për vlerësimin e riskut të dhunës në familje.

Në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (neni 13/1, para.1), vlerësimi i riskut konsiderohet si një proces i detyrueshëm dhe jo fakultativ. Ai shihet një hap shumë i rëndësishëm ku bazohen masat mbrojtëse dhe mbështetëse për viktimën. Edhe udhëzimi i përbashkët i dy ministrave (nr. 866, datë 20.12.2018), i miratuar në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, e rregullon vlerësimin e riskut si një proces të detyrueshëm ku autoriteti përgjegjës është policia e Shtetit. Megjithatë, vërejmë se në praktikat e policisë së shtetit ende nuk kryhet vlerësimi i riskut në çdo rast.

Nga një monitorim i kryer për të evidentuar përvojat e policisë së Shtetit në qarqet Durrës, Tiranë e Shkodër, për periudhën 2019-2020, u gjet se në qarkun Shkodër nuk kryhej procesi i vlerësimit të riskut, kurse në dy rrethet e tjera kryhej në raste të seleksionuara⁶⁹. Monitorimi tregoi se kishte sektorë që nuk e shikonin vlerësimin e riskut si një veprimtari të detyrueshme. Por, mjaft prej punonjësve të policisë, në qarkun Durrës e Tiranë, theksuan se vlerësimi i riskut ka ndikuar pozitivisht në ndërhyrjen sa më të shpejtë për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës në familje. Më parë policia merrte denoncimin për dhunë në familje, bënte kërkesën për UMM/UM dhe priste deri në caktimin e masave nga gjykata. Gjatë kësaj periudhe (48 ore për UMM dhe 15

cenueshmërisë së tyre të veçantë ndaj viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, ndaj frikësimit dhe hakmarrjes.

2. Vlerësimi individual, në veçanti, merr parasysh:

karakteristikat personale të viktimës; llojin ose natyrën e krimit; dhe rrethanat e krimit.

3. Në kuadër të vlerësimit individual, vëmendje e veçantë do t’u kushtohet viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të peshës së krimit; viktimat që kanë pësuar një krim të kryer me një paragjykim ose motiv diskriminues, i cili mund të lidhet veçanërisht me karakteristikat e tyre personale; viktimat, marrëdhënia e të cilave dhe varësia nga shkelësi i bën ato veçanërisht të cenueshme. Në këtë drejtim, viktimat e terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore, dhunës në një marrëdhënie të ngushtë, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose krimit të urrejtjes, si dhe viktimat me aftësi të kufizuara duhet të merren parasysh siç duhet.

69 Shih: ibidem

ditë për UM, policia nuk e kishte të qartë se çfarë të bënte me viktimën dhe dhunuesin⁷⁰, duke qëndruar në pozita pritjeje. Vlerësimi i riskut, ku përfshihen edhe nevojat e viktimës, ka shërbyer për një menaxhim më efikas të këtyre nevojave.⁷¹

VKM Nr. 327 e ka konsideruar vlerësimin e riskut si pjesë e Planit të Përbashkët të Ndërhyrjes që hartohet nga koordinatori vendor dhe ekipet teknike ndërdisiplinore pranë Mekanizmit vendor të referimit. Edhe pjesëmarrja e koordinatorit vendor ose një përfaqësuesi tjetër, është e detyrueshme për të kryer detyrat përkatëse. Fakti që vlerësimi i riskut mund të vijojë të kryhet nga policia e shtetit edhe kur koordinatori vendor nuk paraqitet, nuk do të thotë aspak pjesëmarrje fakultative e organit vendor. Ajo është parashikuar nga ligji si një mekanizëm zhblllokues në raste të veçanta, me qëllim që procedura të kryhet, pavarësisht nga mungesa e përfaqësuesit të bashkisë. Kjo e bën të detyrueshme pjesëmarrjen në vlerësimin e riskut që kryhet nga Policia e Shtetit edhe për Koordinatorin vendor të dhunës në familje (personalisht, ose një punonjës social i njësisë vendore).

3.3. Vlerësimi i riskut në procesin penal.

Është shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit penal dërgimi i vlerësimit të riskut që kryhet nga organi i policisë së shtetit dhe koordinatori vendor në rastet e dhunës në familje, për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Urdhrat e mbrojtjes janë vendime administrative (UMPMM i policisë së shtetit) dhe civile (UMM/UM nga gjykata civile). Por është mjaft e rëndësishme që vlerësimi i riskut të dërgohet dhe të shërbejë edhe në procesin penal. Kjo kërkesë mund të arrihet

70 Për problemet e vlerësimit të riskut shih: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, "REPORT ON MONITORING THE IMPLEMENTATION OF LAW NO.47/2018 "ON SOME ADDITIONS AND AMENDMENTS TO LAW NO. 9669, 18.12.2006, 'ON MEASURES AGAINST VIOLENCE IN FAMILY RELATIONS', AMENDED" Monitoring Period: January 2019-December 2020: https://www.qag-al.org/ang/publication/report_law_monitoring.pdf, p. 9-21

71 Shih: KOMENTAR I LIGJIT PER MASA NDAJ DHUNES NE MARREDHENIET FAMILJARE, Ending Violence against Women, Tiranë, 2021, Neni 13/1, SSRN: <https://ssrn.com/abstract=4304764>

përmes përmirësimit të praktikave të bashkëpunimit midis policisë së shtetit dhe prokurorisë. Ky bashkëpunim, mbështetet në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, neni 24, i cili sanksionon tekstualisht: “Në çdo rast, punonjësi i policisë, ku paraqitet për mbrojtje viktimë, e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale”. Këtë proces punonjësi i policisë e kryen pasi ka vlerësuar dhe menaxhuar riskun ai vetë paraprakisht, duke i vendosur në dosjen përkatëse të gjitha dokumentet e prodhuara nga procesi administrativo-civil. Së bashku me dokumentet e tjera të dosjes së kallëzimit, referohet edhe raporti për vlerësimin e riskut.

Kjo është bërë e qartë edhe në Udhëzimin e Përgjithshëm për Prokurorit të Përgjithshëm (2020). Në bazë të tij, “Hetimi duhet të jetë i plotë për të kërkuar, mbledhur, rishikuar dhe vlerësuar të gjithë provat e nevojshme si: foto, akte ekspertimi, histori mjekësore, telefonata në urgjencë, polici, etj., ndalime, arreste apo dënime të mëparshme, armë, deklaratime të personave të njohur, mësues, kolegë, fqinjë, familjarë, **vlerësimi i riskut nga policia**, etj., urdhra mbrojtje, dosjen civile, etj.” (neni 6/6) Neni 24 i ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, duhet kuptuar sikurse e parashikon Udhëzimi i Përgjithshëm 2020.

Vlerësimi i riskut që referohet nga policia e Shtetit e ndihmon prokurorinë për menaxhimin e riskut, për procesin e hetimit si dhe për mbështetjen e viktimave. Prokurori ka mjaft detyra sidomos për menaxhimin e riskut. Kështu, Udhëzimi i PP-së (2018), ka ngarkuar prokurorin që “...Në fazën e dërgimit të kërkesës për gjykimin e çështjes, prokurori duhet të sigurohet për nivelin e riskut ku gjendet viktimë, nëse është rasti për të vlerësuar dhe ngritur akuza të tjera ndaj të pandehurit, për të vlerësuar mundësinë e dëgjimit të viktimës nëpërmjet mjeteve audiovizuale, dhe/ose kërkuar e rekomanduar gjykatës masat e nevojshme mbrojtëse të saj.” (neni 6/7).

3.4. Të dhëna nga intervistimi i oficerëve të policisë gjyqësore.

Nga një intervistim i oficerëve të policisë gjyqësore pranë prokurorisë konstatohet se ende nuk është bërë një praktikë pune vlerësimi i riskut për viktimën gjatë procesit penal. Konkretisht, u intervistuan 41 oficerë të Policisë gjyqësore pranë prokurorive të rretheve të ndryshme gjyqësore. Pyetjet kishin në vëmendje referimin e dosjes nga policia e shtetit pranë prokurorisë, për rastet e dhunës në familje, në zbatim të nenit 24 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Në këtë rast, është e rëndësishme që dosja të referohet me të gjitha dokumentet që janë disponuar nga policia, sikurse kërkohet edhe nga Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm 2020, në nenin 6/6, sikurse cituam më sipër.

Nga përgjigjet mund të rendisim disa të dhëna si më poshtë:

Nr.	Pyetje	Përgjigje e pjesëmarrësve: PO	Përgjigje e pjesëmarrësve: JO	Pa përgjigje
1	A kryen OPGJ-ja një vlerësim të rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur në rastet e dhunës në familje?	22	16	3
2	A është kryer vlerësimi i riskut nga policia e shtetit në rastet e referimit të rasteve për dhunë në familje?	10	28	3
3	A plotësohet ai vlerësim më tej edhe nga OPGJ-ja?	7	31	3

4	A i shërben vlerësimi i riskut që vjen nga policia e shtetit edhe procesit penal?	37	2	2
---	---	----	---	---

Nga të dhënat që disponon tabela e mësipërme rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, Prokuroria nuk kryen vlerësimin e riskut në çështjet e dhunës në familje. Gjithashtu, ajo nuk angazhohet që ta përditësojë atë. Oficerët e policisë gjyqësore mendojnë se vlerësimi që vjen nga policia është i nevojshëm, por e përdorin më shumë atë për mbarëvajtjen e hetimeve, se sa për shërbimet ndaj viktimës. Të dhënat që vijnë raport në lidhje me mbështetjen e viktimës janë të pamjaftueshme.

Këtë qasje e evidentojmë më tepër edhe nga përgjigjet shpjeguese që japin oficerët e policisë gjyqësore. P.sh., në pyetjet e mëtejshme mbi dobinë e vlerësimit të riskut nga policia e shtetit në bazë të ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, njëri prej të intervistuarve përgjigjet: *“Duke patur prezent këtë raport vlerësimi në ditët e para edhe procesi i punës nga Prokuroria është më i plotësuar dhe bëhet një përfundim më real dhe më efikas i hetimeve.”* Kurse, një punonjës tjetër thekson: *“Vlerësimi i riskut është i nevojshëm sepse na ndihmon të krijojmë një tablo të plotë të rrethanave dhe situatave që kanë sjellë pasojën dhe na ndihmon në hetimin e çështjes.* Për të njëjtën pyetje, kolegu tjetër përgjigjet: *“...vlerësimi i riskut është domosdoshmëri për të krijuar një ide të saktë të dinamikës së ngjarjes dhe vazhdimet të hetimit.”*

Sikurse shihet nga përgjigjet, oficerët e policisë gjyqësore janë të fokusuar në çështjet e hetimit, prandaj dobinë e vlerësimit të riskut e lidhin vetëm me të. Kjo është e dobishme për procesin, porse nevojitet që vlerësimi i riskut të ketë një qasje nga viktimja me qëllim mbrojtjen dhe mbështetjen e saj. Një analizë se si kryhet vlerësimi i riskut me qasje nga viktimja do të ndihmonte punën dhe procesin e rregullt ligjor.

Në pjesën e tyre dërmuese, të intervistuarit përgjigjen për nevojën e një unifikimi të përvojës së vlerësimit të riskut, si dhe për standardizimin e praktikave. Ata mendojnë se vlerësimi i riskut do të ishte i dobishëm vetëm nëse kryhet me përgjegjshmëri dhe jo në mënyrë formale, me vlerësime të pabaza, të cilat vijnë nga pasiguria e punonjësve që kryejnë këtë vlerësim.

3.5. Çështje të menaxhimit të riskut.

Si rregull, bashkëpunimi midis autoriteteve shtetërore dhe shërbimeve për dhunën në familje e dhunën ndaj grave, arrihet përmes mekanizmit të referimit pranë organeve vendore. Në këtë grup, organet përgjegjëse janë: policia e shtetit, prokurori, gjykatat, koordinatori vendor kundër dhunës në familje dhe organet anëtare të ETN-ve pranë mekanizmave vendore të referimit. Prokuroria bashkëpunon me to.

Roli themelor i përket policisë së shtetit, i cili është organi përgjegjës për të kryer vlerësimin e riskut dhe marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e menjëhershme (UMPMM). Por, zakonisht në praktikë, policia e shtetit nuk e menaxhon këtë risk përmes UMPMM, por përmes gjykatës, duke paraqitur kërkesat për UMM ose UM. Këto të fundit, kërkojnë kohë deri në lëshimin e urdhrave gjyqësorë civilë, ndërkohë që dhuna mund të përshkallëzohet.

Përpos kësaj, ka pasur ngatërresa të menaxhimit të riskut nga vetë organet e policisë. P.sh., ka ndodhur kur për të njëjtin raportim të dhunës, policia ka kryer dy vlerësime risku përkatësisht, për burrin dhe gruan, por me kundërthënie. Në një rast tjetër, të raportuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentojmë se menaxhimi i riskut nuk rakordohet midis organeve. Kështu, në një rast në qarkun Elbasan, u kryen paralelisht, hartimi i kërkesë-padisë për UMM dhe fillimi i procedimit penal për veprën penale “Dhunë në familje”. “Për të njëjtat palë, në 2 procese të ndryshme, gjykata lëshoi UMM ku një nga masat mbrojtëse ishte “dhunuesi mos t’i afrohej viktimës në një distancë më pak se 50 m”, kurse në procesin penal, gjykata caktoi masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” për dhunuesin. Kjo masë do të ekzekutohej pikërisht

në banesën e përbashkët të çiftit, aty ku jetonte edhe viktimja e dhunës, me fëmijët.⁷²

Vëzhgimet kanë treguar se strehëzat për viktimat e dhunës në familje hartojnë dhe ndjekin një Plan Individual Sigurie për rastet që menaxhojnë. Por, ndodh që institucionet përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje nuk hartojnë dhe zbatojnë Plan Individual Sigurie për viktimat dhe fëmijët e tyre, që do të ishte shumë i nevojshëm për parandalimin e përsëritjes së dhunës apo parandalimin e femicidit.

Problemet e evidentuara dëshmojnë se menaxhimi i riskut është një çështje e rëndësishme e bashkëpunimit institucional dhe arrihet përmes koordinimit midis institucioneve.

4. Ndihma juridike falas.

4.1. Format e ndihmës juridike falas.

Ndihma ligjore falas është një nga të drejtat e pjesëmarrjes së viktimës në procesin gjyqësor. Megjithatë, kjo e drejtë shërben edhe për përmbushjen e të drejtave të mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimën.

Ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka parashikuar tre forma të ofrimit të ndihmës juridike: (a) ndihma juridike parësore,⁷³ (b) ndihma juridike dytësore,⁷⁴ (c) përjashtim nga pagimi i tarifave

72 Shadow Report..., cituar, fq. 28

73 Në kuptim të këtij ligji, **ndihmë juridike parësore** konsiderohet këshillimi, dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, përfaqësimi përpara organeve administrative ose procedurave për të kërkuar ndihmë juridike dytësore. Ndihma juridike parësore jepet edhe nëpërmjet dhënies së këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike, që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

74 Në kuptim të ligjit **ndihmë juridike dytësore** është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet penale, për të

gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore, si dhe nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit.

Në bazë të KPP-së viktimave e veprës penale ka të drejtë të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi (neni 58/ç). Për të garantuar këtë të drejtë avokatët e viktimave i referohen ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”⁷⁵, i cili hyri në fuqi më 2017, në të njëjtin vit me Kodin e Procedurës Penale. Në këtë ligj janë parashikuar dispozita të posaçme për përfaqësimin ligjor të viktimave të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe atyre të trafikimit të qenieve njerëzore. Për këto kategori, parashikohet shprehimisht ndihma ligjore drejtpërdrejt, pavarësisht nga mundësitë ekonomike të viktimave.⁷⁶

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale parashikuan rishtazi të drejtën e viktimës që *“të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;”* (neni 58/gj i KPP). Sanksionimi i saj e përqsas Kodin e Procedurës Penale me legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktivën 2012/29/EU (sipërpërmendur).

Por, ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka krijuar një vakuum. Për më tepër, ky ligj kërkon procedura të posaçme të parashikuara për përftimin e ndihmës dytësore, të cilat e rëndojnë pozitën e viktimës në procesin penal ose pas tij.

Edhe në rastet e kërimit të dëmit të ardhur nga vepra penale, e drejta për përjashtimin nga shpenzimet gjyqësore zbatohet kur padia për kërkimin e dëmit ngrihet në procesin penal. Pra, ligjërisht, nuk është e qartë se si përjashtohet viktimave nga shpenzimet gjyqësore edhe

cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Kjo ndihmë jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës sipas parashikimeve të këtij ligji.

75 Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”.

76 Po aty.

në procesin civil pas përfundimit të procesit penal. KPP-ja e ka lidhur përjashtimin e viktimës nga shpenzimet, me të gjitha të drejtat që përbëjnë statusin e viktimës së veprës penale. Prandaj, viktimat duhet të përjashtohet nga shpenzimet gjyqësore për kërkimin e dëmit, si në procesin penal ashtu edhe në atë civil nëse është rasti. Kjo e drejtë, buron edhe nga Direktiva 2012/29 e BE-së, e cila e ka bërë të qartë se viktimat duhet të kenë akses në shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara të mbështetjes, në përputhje me nevojat e tyre: ***“...para, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurës penale”***. (shih më sipër). Të drejtat për viktimën si më sipër, fillojnë që nga informacioni ligjor që i jepet asaj për shërbimet mbështetëse, deri pasi ka përfunduar procesi gjyqësor, kur garantohej njoftimi i viktimës për lirimin e autorit të veprës penale nga institucionet e vuajtjes së dënimit. Roli i këshilltarit ligjor dhe i avokatit është shumë i rëndësishëm për këtë ndihmë.

Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm (2020), ka parashikuar të drejtën për informimin e viktimave të dhunës, por jo ofrimin e procedurës për të përfituar ndihmë juridike dytësore për t’u përfaqësuar në gjykatë. Në lidhje me viktimat me bazë urrejtjeje, të cilat nuk e përfitojnë automatikisht ndihmën në bazë të ligjit, Udhëzimi thekson se, ***“Veçanërisht, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, bëjnë përpjekje që viktimës t’i plotësohen nevojat e para jetike për siguri, ndihmë mjekësore, ushqim, veshmbathje e strehim dhe e informojnë viktimën për të drejtën për ndihmë juridike falas dhe për procesin e përfitimit të kësaj ndihme.”*** (neni 8/2).

4.2. Viktimat e krimit si subjekt përfitues të ndihmës.⁷⁷

Subjektet që përfitojnë ndihmë juridike mund të jenë *përfitues të ndihmës juridike për shkak të të ardhurave dhe pasurive të pamjaftueshme*⁷⁸ ose si kategori të veçanta⁷⁹. Pra, përfituesit ndahen

77 Shih: “Trafikimi i qenieve njerëzore”, Prezenca e OSBE në Shqipëri, Tiranë, 2021, i gjindshëm në [512644.pdf \(osce.org\)](https://www.osce.org/files/document/512644.pdf), fq. 216-222.

78 Ligj nr. 111/2017, neni 12

79 Ligj nr. 111/2017, neni 11

në kategori të përgjithshme (neni 10) dhe kategori të veçanta (neni 11). Viktimat e dhunës në familje, dhunës seksuale dhe atyre të trafikimit të qenieve njerëzore si kategori të veçanta, përfitojnë këtë ndihmë në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Ky sanksionim është i lidhur edhe me KPP-në, i cili ka parashikuar si kategori të veçanta viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (nenin 58/b). Pyetja që shtrohet është se, çfarë i dallon viktimat si kategori e veçantë, të parashikuara nga neni 11 i ligjit për ndihmën juridike, nga përfituesit si kategori e përgjithshme. Për subjektet e parashikuara nga neni 10, ligji shprehet se, *“...e përfitojnë ndihmën juridike nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj”* (neni 10/2). Nga një interpretim i dy neneve të ligjit, 10 dhe 11, arrijmë në konkluzionin se subjektet e posaçme, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit, e përfitojnë ndihmën, pa iu nënshtruar kriterëve ekonomike të parashikuara nga ligji. Ky interpretim është mbështetur edhe nga studiues të tjerë. Kështu, në raportin e monitorimit të Reformës në Drejtësi, është shprehur e njëjta pikëpamje, kur theksohet: *“Ligji nr. 111/2017 zgjeron rrethin e subjekteve të cilët përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti, duke parashikuar si përfitues disa kategori të veçanta (pavarësisht kriterit ekonomik) si viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; ...”*⁸⁰. Për më tej, mbetet të zbatohet nga gjykatat.

Në praktikë janë vënë re raste ku gjykatat nuk e kanë kuptuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 11 të ligjit. Ato bëjnë interpretime të ndryshme të cilat kanë nevojë për unifikim. Kështu p.sh., në një rast me objekt “zgjidhje martese” të gjykuar nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, kjo e fundit ka arsyetuar se, *“Gjykata pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, në mbështetje të ligjit nr. 111/2017...vlerëson se nuk jemi në kushtet kur pala paditëse duhet të përjashtohet tërësisht nga shpenzimet për ekspert, për shkak se ky ligj parashikon përjashtimin e*

80 Shih: Klesta Hysi, Monitorimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi” II, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës FDUT, Tiranë, 2020, fq.6, i gjindshëm në: <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2020/06/Monitorimi-i-Zbatimit-te-Reformes-ne-Drejtësi-2....pdf>

palës paditëse së dhunuar nga shpenzimet gjyqësore/dhe atë me ekspert në rastin e gjykimeve me objekt lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe jo në çështjen me objekt zgjidhje martese”⁸¹. Në fakt, është e paqartë se ku është bazuar gjykata për të bërë këtë interpretim, ndërkohë që ligji parashikon ndihmën falas për viktimat e dhunës në familje dhe jo për personat me urdhër mbrojtjeje. Interpretime të tilla mund të krijojnë sfida për zbatimin e këtij ligji edhe për viktimat e veprës penale. Më së paku, për përfaqësimin ligjor të viktimave të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe atyre të trafikimit të qenieve njerëzore, organet kompetente duhet të zbatojnë një procedurë automatike. Për përjashtimin e këtyre subjekteve nga shpenzimet gjyqësore dhe ofrimin e ndihmës ligjore falas, nuk është rasti për zhvillimin e seancave gjyqësore të gjata. Për më tepër, gjykata nuk mund të ndjekë të njëjtën procedurë provuese sikurse me subjektet e tjera që për shkak të pafuqisë ekonomike kërkojnë ndihmë ligjore falas. Ajo duhet të lëshojë automatikisht një vendim, ipso jure. Por, nga monitorimi i vendimeve gjyqësore shohim mjaft kohë të humbur për shkak të ndjekjes së procedurave të gjata për përfitim të përfaqësimit ligjor falas nga viktimat e këtyre kategorive. Për më tepër, procedura e ankimit kundër vendimeve gjyqësore që ofrojnë këtë ndihmë, nga Drejtoria përkatëse e Ndhmës Juridike, duket krejt e pavend. Këtu është fjala për detyrime pozitive të shtetit për pjesëmarrjen e viktimave të krimit, prandaj mendojmë se qoftë vendimi i njërit prej gjykatave për ofrimin e ndihmës dytësore është i mjaftueshëm dhe nuk ka arsye të ankohet.

Ripërsërisim se, ligji për ndihmën juridike ka parashikuar si kategori të veçanta që përfitojnë ndihmë juridike dytësore vetëm *viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore*. Ndërkohë, që për viktimat e kategorive të tjera të krimeve ligji hesht. Duket sikur duhet të ndjekin të gjitha kriteret dhe procedurat e parashikuara nga ligji për përfituesit e ndihmës juridike. Kjo do të binte në kundërshtim me Direktivën 2012 të BE-së.

81 Po aty, fq. 19.

V. KONKLuzion

Studimi arrin në përfundim në se legjislacioni shqiptar përmbshtetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit është përmirësuar vijimisht, në përafrim me standardet e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe me aktet e tjera ndërkombëtare. Por, është e domosdoshme që të kuptohet roli i prokurorisë si autoriteti përgjegjës dhe roli drejtues i prokurorit, jo vetëm për çështjet hetimore, por edhe për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit. Një vend të rëndësishëm zënë edhe institucione të tjera, agjenci shërbimesh si dhe organizatat jofitimprurëse. Prandaj, koordinimi institucional i brendshëm dhe i jashtëm, si dhe bashkëpunimi midis tyre, janë faktorë bazë që viktima të përfitojë të gjitha shërbimet mbështetëse dhe masat mbrojtëse në kuadër të respektimit të të drejtave në procesin penal. Analiza shtrihet edhe në veprimtarinë e institucioneve përpara se procesi penal të ketë filluar, si dhe pasi procesi penal ka përfunduar. Vëmendja për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave edhe në këto periudha është shumë e rëndësishme, jo vetëm nga pikëpamja sociale, por edhe për parandalimin e veprave të tjera penale dhe të riviktimizimit të tyre. Një analizë e parimeve dhe institucioneve për të drejtat e viktimave, të vlerësimit të nevojave, të vlerësimit të riskut, të shërbimeve mbështetëse, të planit të veprimit dhe të bashkëpunimit institucional, ka ndihmuar për të nxjerrë në pah detyrat institucionale dhe të koordinimit institucional. Studimi e konsideron bashkëpunimin si një detyrim për institucionet, pavarësisht nga çështjet e varësisë institucionale, bazuar në detyrimin e përgjithshëm dhe prioritetin për të mbështetur drejtësinë.

Në mjaft raste, punimi ka arritur në konkluzione për përmirësimin e legjislacionit të brendshëm nga organet ligjvënëse, si dhe ato ligjzbatuese që nxjerrin akte. Por, një vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të praktikave të organeve të drejtësisë dhe jurisprudencës gjyqësore, nëpërmjet interpretimit dhe zbatimit të normave në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Bibliografia

Akte ndërkombëtare

1. The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985); i gjindshëm në: URL: <http://www.unhchr.ch>

2. Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 25 tetor 2012 “*Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA*”, e gjindshme në:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32012L0029#:~:text=Right%20to%20access,a%20competent%20authority>

Council of Europe Convention on Action Against Trafficking in Human Beings, ratified by Law 9642, dated 20.11.2006. E gjindshme në: [EUR-Lex - 32012L0029 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32012L0029#:~:text=Right%20to%20access,a%20competent%20authority)

“Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, 2011. E gjindshme në: <https://rm.coe.int/168046246b>

Vendime gjyqësore

3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64 datë 03.06.2022.

Y dhe të Tjerët v. Bullgarisë (2022): [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-216360%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-216360%22]})

Levchuk kundër Ukrainës 2020: <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-203931>

Buturugă kundër Rumanisë, 2020: [CASE OF BUTURUGĂ v. ROMANIA.pdf](#)

J.L. kundër Italisë 2021: [https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:\[%22003-7031048-9489384%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:[%22003-7031048-9489384%22]})

E.G. kundër Republikës së Moldavisë (2021): [https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:\[%22003-6993360-9422878%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:[%22003-6993360-9422878%22]})

Tunikova dhe të tjerët kundër Ruisë (2021): <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-213869>

Tërshana kundër Shqipërisë (2020): [TËRSHANA v. ALBANIA \(coe.int\)](#)

Akte ligjore e nënligjore

4. Kushtetuta e RSH (1998)

5. Ligj nr. 35/2017, KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

6. Ligj Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 05, datë 26.10.2018, Për “GARANTIMIN E ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE TË VEPRAVE PENALE”, e gjindshëm në: [udhezim_dhe_deklarata_1418.pdf \(pp.gov.al\)](#)

Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 17, datë 23.12.2020, “Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje”, e gjindshme në [Udhëzime të Prokurorit të Përgjithshëm \(pp.gov.al\)](#)

Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve

përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

Ligj nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Ligj nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Urdhri Nr.559, datë 23.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “*Për raportimin lidhur me të dhënat për persona që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit si autorë të krimeve seksuale dhe raportimin për lirimin për të burgosurit e tjerë që lirohen*”.

Udhëzimi i përbashkët Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866, datë 20.12.2018 “*Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje*”. e gjindshme në Fletore Zyrtare nr. 204, Viti 2018.

Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar (art.13/1).

Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866, datë 20.12.2018 “*Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje*”. e gjindshme në Fletore Zyrtare nr. 204, Vitit 2018.

Studime e raporte

Olasolo W. Kiss A., “*The role of victims in criminal proceedings before the International Criminal Court*”, në Revue internationale de droit pénal 2010/1-2 (Vol. 81)

Rudina Jasini, *Pjesëmarrja e viktimave si palë civile në proceset penale ndërkombëtare*, në “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë”, Anastasi A., Sinani Sh., (ed.) ASHSH, Tiranë, 2023, fq. 290-345

Aurela Anastasi, *Mekanizmat për dëshmipërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rëndësia e forcimit të tyre, në “Barazia dhe drejtësia gjinore”, ASHSH, Tiranë, 2021.*

Beqiri R., *A victim - oriented justice dispute in the context of the judicial system reform in Albania,*

11 June 2018, 2nd Law & Political Science Conference, Prague.

Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë, ISPL, Tiranë, 2019.

Omari L, Anastasi A, “E drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2017.

Anastasi A., *Për një klasifikim të të drejtave të viktimave gjatë procesit penal në qasje me procesin e rregullt ligjor në “Çështje të teorisë dhe praktikës mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal”, Onufri, Tiranë, 2019.*

Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 2006.

“Trafikimi i qenieve njerëzore”, Prezenca e OSBE në Shqipëri, Tiranë, 2021, i gjindshëm në [512644.pdf \(osce.org\)](https://www.osce.org/files/document/512644.pdf)

Klesta Hysi, Monitorimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi” II, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës FDUT, Tiranë, 2020, fq.6, i gjindshëm në:

<https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2020/06/Monitorimi-i-Zbatimit-te-Reformes-ne-Drejttesi-2....pdf>

UPR Shadow Report, Center for Legal Civic Initiatives & Network of Monitoring against Gender based Violence, (2014-2018), i gjindshëm në: [raporti_upr.pdf \(qag-al.org\)](https://www.qag-al.org/raporti_upr.pdf)

“Ndihma juridike e garantuar nga shteti” Raport monitorimi, QNL, Tiranë 2022, fq. 15, e gjindshme në:

[raport_ndihma_juridike .pdf \(qag-al.org\)](https://www.qag-al.org/raport_ndihma_juridike.pdf)

“REPORT FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL on the implementation of

Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA,” i gjindshëm në: [EUR-Lex - 52020DC0188 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

SHADOW RAPORT ON THE IMPLEMENTATION OF THE COUNCIL OF EUROPE CONVENTION ON PREVENTING AND COMBATING VIOLENCE AGAINST WOMEN AND DOMESTIC VIOLENCE (ISTANBUL CONVENTION), Monitoring Network Against Gender Based Violence, 2023, i gjindshëm në: <https://rm.coe.int/shadow-report-of-the-monitoring-network-against-gender-based-violence-/1680ac6fca>

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri, OSBE, Tiranë, 2019.

KOMENTAR I LIGJIT PER MASA NDAJ DHUNES NE MARREDHENIET FAMILJARE, Ending Violence against Women, Tiranë, 2021, SSRN: <https://ssrn.com/abstract=4304764>

PROTOKOLL MBI PLANIFIKIMIN E SIGURISË PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NGA KOMUNITETI ROM DHE NGA KOMUNITETI LGBTI, Tiranë, 2020, i gjindshëm në: [Protokoll_mbi_planifikimin_sigurise_viktimat_dhune.pdf \(adrf.al\)](#)

Memorandum shpjegues, Konventa e Kwshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, CAHVIO.

“REPORT ON MONITORING THE IMPLEMENTATION OF LAW NO.47/2018 “ON SOME ADDITIONS AND AMENDMENTS TO LAW NO. 9669, 18.12.2006, ‘ON MEASURES AGAINST VIOLENCE IN FAMILY RELATIONS’, AMENDED” Monitoring Period: January 2019-December 2020, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare: https://www.qag-al.org/ang/publication/report_law_monitoring.pdf

Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

**ASPEKTE ADMINISTRATIVE
TË ROLIT TË ROLIT
TË INSTITUCIONEVE
LIGJZBATUESE NË GARANTIMIN
E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Studim rasti: Policia e Shtetit

PËRMBAJTJA

1 HYRJA	5
2 Metodologji	8
3 Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut	9
4 Standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për institucionet e zbatimit të ligjit	12
5 Raste të trajtuara nga Avokati i Popullit	19
6 Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut: veprimtaria administrative	29
7 Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut dhe Raportet e BE dhe të tjera	43
8 Konkluzione	53
9 Bibliografi	55

1. Hyrje

Shteti, si institucion, legjitimohet për ndjekjen e qëllimeve të komunitetit. Një ndër përgjegjësitë e shtetit është të ruajë ligjin dhe rendin, paqen dhe sigurinë brenda territorit të tij. Këto synojnë t'i sigurojnë komunitetit një mirëqenie dhe siguri sa më të madhe për të përmirësuar kushtet e jetesës. Të drejtat e njeriut dhe garantimi i tyre, po aq janë në përgjegjësinë e shtetit. Një ndër aktet kryesore ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara, thekson se *'njohja e dinjitetit të njeriut dhe njohja e të drejtave të njeriut si të drejta të barabarta e të patjetërsueshme përbën themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes në botë'*.¹ Detyrimet e shtetit përfshijnë detyrimin për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, për të siguruar dhe përmbushur ato si dhe detyrimin për të mos diskriminuar. Për këtë arsye, Kushtetutat, si aktet themelore të shteteve njohin dhe garantojnë të drejtat themelore të njeriut. Kushtetuta shqiptare garanton të drejtat dhe liritë themelore si *'të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme'* dhe thekson se ato qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Po ashtu, ajo urdhëron organet e pushtetit publik pa asnjë dallim, që në përmbushje të detyrave të tyre, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.²

Institucionet e pushtetit publik, siç Kushtetuta edhe pasqyron, janë nga më të ndryshmet. Ato krijohen natyrshëm në referim të

1 Hyrja, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Shih për më shumë Sinani M., Dhamo M., Hysi V., Kamani P., Methasani E., dhe Harasani Zh., *Komentari i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut*, botim i UNESCOs, 2008.

2 Neni 15. Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Fletore Zyrtare nr. 28/1998.

funksioneve të shtetit dhe fushave të ndryshme të përgjegjësi. Edhe pse pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë,³ shteti ushtron funksione të ndryshme të cilat mundësojnë realizimin e qëllimeve të komunitetit. Funksioni politik mundëson zgjedhjen e qasjes/ve për të realizuar qëllime të caktuara mes shumë qasjeve të mundshme. Me të përcaktuar qasjen politike për qëllimet, funksioni ligjvënës ndërton mbi të dhe vendos qëllimet në nivelin e ligjeve, ndërsa ai administrativ vë në zbatim qëllimet e vendosura në ligje, dhe së fundi, funksioni gjyqësor zgjidh konfliktet e shfaqura me rastin e vënies në zbatim të ligjeve. Këto funksione, të dallueshme nga njëri-tjetri, përshfaqen edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë⁴ nën parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.⁵

Kushtetuta ofron disa tipologji të institucioneve të administratës publike, ndërsa të tjera krijohen me ligj. Lidhur me institucionet e parashikuara në të, Kushtetuta parashikon detyrimin e rregullimit me ligj të tyre.⁶ Ajo garanton parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve si një ndër parimet themelore të saj (neni 7 i Kushtetutës), duke parashikuar edhe institucionet themelore që ushtrojnë pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kushtetuta e RSH-së rregullon veçse në vija të përgjithshme aspektet organizative dhe funksionale institucionale. Ndër institucionet e parashikuara në të përfshihen institucione që garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, dhe institucione të tjera të secilës prej degëve të pushteteve, përfshirë edhe atë të qeverisjes vendore, sikurse edhe institucione të pavarura. Sido që të jenë zgjedhjet e organizimit të shtetit apo administratës publike, ato duhet të sigurojnë më së pari zbatimin e ligjit, dhe së dyti

3 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007.

4 Neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Shih Kushtetutën në: <https://qbz.gov.al/share/JiLN1sTiQu6JD0BWHggXjA>

5 Prof. Dr. Xhezair Zaganjori Prof. Dr. Aurela Anastasi Dr. Eralda (Methasani) Çani “Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, F 30

6 Shih neni 6 i Kushtetutës.

që zbatimi i ligjit të kryhet në një mënyrë që respekton detyrimet e shtetit sipas të drejtave të njeriut, përfshirë madje edhe detyrimet që burojnë nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut.⁷ Kjo do të thotë që legjislacioni vendas dhe praktikat e miratuara nga institucionet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e zbatueshme të të drejtave të njeriut.

Në tërësinë e strukturave të shtetit janë të përfshira edhe institucionet që njihen si ‘ligjzbatuese’. Të tilla njihen institucione publike qeveritare,⁸ apo të administratës shtetërore në kuptimin e legjislacionit vendas,⁹ përgjegjëse për zbatimin e ligjit, brenda një juridiksioni të caktuar. Tipar i tyre është përdorimi i forcës si një element i dallueshëm i ushtrimit të veprimtarisë apo i tagrave që gëzojnë për ekzekutimin e veprimeve të tyre administrative. Ndër institucionet apo agjencitë e zbatimit të ligjit, më i zakonshmi është Policia,¹⁰ edhe pse ekzistojnë edhe të tjera të ndryshme përfshirë ato që ngarkohen me trajtimin e shkeljeve specifike ligjore, dhe që organizohen dhe mbikëqyren nga autoritete të caktuara. Zakonisht të tilla institucione kanë kompetenca të ndryshme ligjore të cilat i lejojnë të kryejnë detyrat e tyre, të tilla si fuqia e ndalimit dhe përdorimi i forcës. Shteti ka në përbërjen e vet struktura apo njësi institucionale nga më të ndryshmet, që i përkasin secilit prej pushteteve, të cilat pa dallim kanë detyrimin e respektimit

7 Anastasi dhe E. (Methasani) Çani, E Drejta Kushtetuese dhe Administrative: cikël leksionesh për studentët e Fakultetit Ekonomik, Shtëpia Botuese ‘Marin Barleti’, Tiranë 2008

8 Shënim: edhe togfjalëshi ‘agjenci ligjzbatuese’ ka gjetur qytetari në vendin tonë për t’iu referuar të tilla institucioneve. Gjithsesi, gjendja juridike e një institucioni përcaktohet në kuadrin e ligjit. Termi ‘agjenci’ në referim të legjislacionit vendas ka një kuptim të përcaktuar. Ai i referohet personave juridikë që njihen si ‘agjenci autonome’, të cilat krijohen dhe mbyllen me ligj, gëzojnë personalitet juridik, publik, në marrëdhëniet me të tretët në realizimin e funksioneve të caktuara me ligj. Agjencia autonome kryen funksione administrative të përcaktuara, kryerja e të cilave plotëson disa kritere të përcaktuara në ligj. Shih për më shumë ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

9 Shih ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

10 Neni 34 i ligjit nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”.

dhe garantimit të të drejtave të njeriut, por strukturat e ngritura në administratën publike që ushtrojnë funksionet administrative janë ato që ndeshen në përditshmëri me këtë detyrim. Veçanërisht në institucionet ligjzbatuese, respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut përshfaqet me rëndësi parësore.

2. Metodologji

Ky punim kërkimor u bazua në një metodologji të krijuar për të analizuar gjendjen e zbatimit të ligjit dhe garantimit të të drejtave të njeriut në veprimtarinë administrative të institucioneve ligjzbatuese dhe konkretisht të Policisë së Shtetit. Metodologjia është e strukturuar për të siguruar një kuptim sa më të drejtë të shumësisë së çështjeve të karakterit administrativ me të cilat përballlet Policia e Shtetit, për të informuar drejtimin e veprimtarisë së këtij institucioni ligjzbatues drejt respektimit të ligjit dhe ofrimit të shërbimit publik të drejtë dhe të pritshëm.

Analiza, deduzioni, studimi i rastit, përdorimi i të dhënave administrative dhe statistikore janë në themel të këtij punimi. Analiza e dokumentit është përdorur me qëllim që të prezantohet sa më gjerësisht e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut që rregullon veprimtarinë e organeve ligjzbatuese policore në lidhje me të drejtat e njeriut. Janë analizuar edhe disa prej akteve ligjore apo nënligjore të së drejtës së brendshme të cilat rregullojnë veprimtarinë institucionale.

U realizua një takim pranë institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim qartësimin e disa të dhënave nga ato për tre vitet e fundit të veprimtarisë rekomanduese të institucionit për Policinë e Shtetit. Ky takim u realizua pas punës kërkimore për rekomandimet të cilat gjenden në faqe e internetit të këtij institucioni. Metoda e studimit të rastit përmes identifikimit të rasteve të trajtuara nga Avokati i Popullit u përdor gjithashtu. Janë studiuar raste konkrete të Rekomandimeve të cilat u përzgjedhën ndër tre vitet e fundit të veprimtarisë së institucionit dhe që kanë pasur një jehonë të madhe publike për shkak të natyrës së

të drejtës së shkelur, si për shembull e drejta për jetën, trajtimi njerëzor dhe jodegradues, liria e lëvizjes, si dhe liria e tubimit.

Janë hulumtuar të dhëna nga veprimtaria konkrete e Policisë së Shtetit për adresimin e disa prej aspekteve të veprimtarisë që lidhen me të drejtat e njeriut. Ato prezantohen si ilustruese të punës administrative të kryer për realizimin e qëllimit dhe misionit të institucionit. Punimi u bazua edhe në të dhëna konkrete nga veprimtaria e Policisë së Shtetit, të cilat u identifikuan nga burime të ndryshme publike dhe raportime të vetë institucionit.

Për këtë punim kërkimor janë analizuar edhe raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si dhe raportet e disa prej organizatave të njohura në botë dhe në vend për monitorimin e të drejtave të njeriut.

Metodologjia e përdorur ka kufizimet e veta. Ajo bazohet në përzgjedhjen. Nuk trajtohet çdo aspekt që ka ndërlidhje me të drejtat e njeriut apo liritë themelore, qoftë në kuadrin e standardeve ndërkombëtare të renditura në punim, apo atë të veprimtarisë së hulumtuar. Ajo është përzgjedhëze dhe ilustruese, duke pasqyruar kryesisht të dhëna të tre viteve të fundit. Janë përzgjedhur shembuj ilustrues që trajtojnë aspekte të veçanta të të drejtave të njeriut të cilat përshfaqen më shpesh në raportet e organizatave vendase, të huaja si dhe Avokatit të Popullit, institucionit kushtetues që mbrojnë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike në Republikën e Shqipërisë. Duke përballur tërësinë e rezultateve të pritshme, si dhe gjetjet apo qëndrimet për veprimtarinë e realizuar, punimi prezanton detyrat dhe sfidat me të cilat përballen organet ligjzbatuese siç është Policia e Shtetit për respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut, lirive themelore, sigurisë publike dhe përmbushjen e pritshmërive publike.

3. Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut

Në legjislacionin shqiptar, Policia e Shtetit është krijuar me misionin që të garantojë një mjedis të sigurt për komunitetin nëpërmjet

policimit me standardet më të larta të performancës, krijimit të një kulture bashkëkohore manaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar. Policia e Shtetit deklaroi se vetëm zhvillimi i brendshëm dhe i jashtëm në rritje i saj mundëson realizimin e këtij misioni. Ajo thekson se ky zhvillim synon *‘përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit duke u orientuar nga nevojat dhe kërkesat e tij, përmirësimin e performancës policore nëpërmjet arritjes së standardeve bashkëkohore dhe përdorimit të teknologjive dhe formave më të përparuara’*.¹¹ Mjedisi sa më i sigurt për shoqërinë shqiptare është synimi strategjik aftagjatë i Policisë së Shtetit. E krijuar që me Qeverinë e Vlorës në vitin 1912,¹² Policia e Shtetit ka pësuar zhvillime historike të ndryshme, duke u organizuar dhe funksionuar tashmë si një institucion ligjzbatues që synon garantimin e sigurisë publike, duke pasur në themel të saj garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Policia e Shtetit organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”,¹³ si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Rregullore e policisë së shtetit” e ndryshuar. Neni 4 i ligjit për Policinë e Shtetit thekson se misioni i Policisë së Shtetit është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, parandalimi dhe lufta ndaj kriminalitetit, garantimi i zbatimit të ligjit, mbrojtja e jetës dhe pronës, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.¹⁴ Ka disa funksione që lidhen ngushtë me të drejtat e njeriut, bazuar në ligjin për Policinë e Shtetit dhe normat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Këto funksione përfshijnë, ndër të tjera edhe:

11 Shih për më shumë: <https://asp.gov.al/misioni/>

12 Qeveria e shtetit shqiptar të pavarur të shpallur më 28 Nëntor 1912 krijoi forcat e rendit më 13 janar 1913. Funksionimi i policisë shqiptare filloi në vitin 1913, me hyrjen në fuqi të Rregullores së Qeverisë së Vlorës “Mbi formimin e Milicisë Shqiptare”.

13 Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/ligji/2024/07/26/82> (ose: <https://qbz.gov.al/share/KYNWcXcpSB-VuhwG2R8tcQ>)

14 Shih neni 4, ligji nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”.

- Mbrojtja e jetës dhe integritetit fizik: Policia ka detyrimin të mbrojtë jetën dhe integritetin fizik të qytetarëve, duke ndërhyrë në situata ku ka rrezik për jetën, sigurinë dhe shëndetin e njerëzve;
- Sigurimi i lirive themelore: Policia është përgjegjëse për mbrojtjen e lirive të garantuara nga Kushtetuta, si liria e shprehjes, tubimeve dhe liria e lëvizjes, duke respektuar të drejtat e individëve gjatë ushtrimit të funksioneve të saj;
- Parandalimi i torturës dhe trajtimeve çnjerëzore: Policia është e ndaluar të përdorë torturë, trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues gjatë kryerjes së detyrave të saj. Kjo përfshin të drejtat e personave të ndaluar ose arrestuar;
- E drejta për privatësi: Ndërhyrja e policisë duhet të jetë e kufizuar në mënyrën që të respektojë të drejtën për privatësi dhe jetën personale të individëve, në përputhje me ligjin;
- Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim: Policia ka detyrimin të trajtojë çdo qytetar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, fesë, bindjeve politike, statusit shoqëror, apo çdo shkak tjetër;
- Garancia e një procesi të rregullt ligjor: Gjatë shoqërimit, arrestimit apo ndalimit të personit, Policia duhet t'i garantojë atij të drejtat sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, përfshirë të drejtën e personave për të marrë informacione për arsyet e ndalimit dhe të kenë qasje në avokat dhe proces të rregullt gjyqësor.

Këto funksione dhe detyrime janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe traktatet e tjera të ratifikuara nga Shqipëria.

4. Standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për institucionet e zbatimit të ligjit

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut është i detyrueshëm për të gjitha shtetet dhe agjentët e tyre, duke përfshirë zyrtarët e zbatimit të ligjit. Të drejtat e njeriut janë një çështje legjitime në të drejtën ndërkombëtare dhe shqyrtimin ndërkombëtar. Punonjësit e zbatimit të ligjit janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Zyra e Kombeve të Bashkuara, Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2004

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e përfshirë në traktate të ratifikuara nga vendi ynë, është e detyrueshme për të gjitha shtetet dhe agjentët e tyre, përfshirë zyrtarët e zbatimit të ligjit. Të drejtat e njeriut janë konsideruar si një çështje legjitime për të drejtën ndërkombëtare dhe shqyrtimin ndërkombëtar dhe si rrjedhojë, punonjësit e zbatimit të ligjit janë të detyruar të njohin dhe të zbatojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁵ Funksionet dhe detyrimet e Policisë si një institucion i zbatimit të ligjit duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të tjerave të ratifikuara nga Shqipëria.¹⁶

Ndër aktet ndërkombëtare të cilat përcaktojnë të drejtat e njeriut, edhe për orgnat ligjzbatuese, përfshihen akte si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,¹⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,¹⁸ Karta e Kombeve të Bashkuara¹⁹

15 Karta e Kombeve të Bashkuara, preambula, neni 1 dhe neni 55(c).

16 Shih neni 116, 121, 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

17 DUDNJ, në: <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

18 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Asambleja e Përgjithshme, Rezolutë 2200 A (XXI), datë 16 dhjetor 1966, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>

19 <https://www.un.org/en/about-us/un-charter/full-text>

- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor,²⁰ Konventa për Parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit,²¹ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW),²² Konventa për të Drejtat e Fëmijës,²³ Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese,²⁴ Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve²⁵
- Deklarata për Mbrojtjen e të gjithë personave nga tortura, dënimi apo trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues,²⁶ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor,²⁷ Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin

20 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 21 dhjetor 1965, Rezoluta 2106 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (XX) <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-convention-elimination-all-forms-racial>

21 Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 260 A (III) e 9 dhjetorit 1948, në: https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf

22 <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/04/Konventa-mbi-eliminimin-e-Diskriminimit-ndaj-Grave.pdf>

23 Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 20 Nëntor 1989, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>

24 Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, 10 dhjetor 1984, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 39/4, në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>

25 Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve, Rezoluta 2198 (XXI), Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në: <https://www.unhcr.org/media/convention-and-protocol-relating-status-refugees>

26 Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga të Dhënuarit ndaj Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit të Tjerë Mizor, Çnjerëzor ose Degradues, 09 Dhjetor 1975, Rezoluta 3452 e Asamblesë së Përgjithshme (XXX), në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-protection-all-persons-being-subjected-torture-and>

27 Rezolutat e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme 1904 (XVIII). Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,

e të Burgosurve,²⁸ Kodi i Sjelljes së Kombeve të Bashkuara për zyrtarët e zbatimit të ligjit,²⁹ Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit,³⁰ Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Çfarëdo Forme Paraburgimi ose Burgimi,³¹ Rregullat Standarde Minimale për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit,³² Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë,³³ Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të gjykimeve të shkurtuara,³⁴ Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për

në: [https://www.oas.org/dil/1963%20United%20Nations%20Declaration%20on%20the%20Elimination%20of%20All%20Forms%20of%20Racial%20Discrimination,%20proclaimed%20by%20the%20General%20Assembly%20of%20the%20United%20Nations%20on%20November%2020,%201963,%20resolution%201904%20\(XVIII\).pdf](https://www.oas.org/dil/1963%20United%20Nations%20Declaration%20on%20the%20Elimination%20of%20All%20Forms%20of%20Racial%20Discrimination,%20proclaimed%20by%20the%20General%20Assembly%20of%20the%20United%20Nations%20on%20November%2020,%201963,%20resolution%201904%20(XVIII).pdf)

- 28 Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e Burgosurve (Rregullat Nelson Mandela), 1 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 70/175, 17 dhjetor 2015, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf
- 29 Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, 17 dhjetor 1979, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/code-conduct-law-enforcement-officials>
- 30 Parimet themelore mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, 7 shtator 1990, Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, Havana, Kubë, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/basic-principles-use-force-and-firearms-law-enforcement>
- 31 Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Çdo Formë Paraburgimi ose Burgimi, 09 Dhjetor 1988, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 43/173, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/body-principles-protection-all-persons-under-any-form-detention>
- 32 Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit), 29 nëntor 1985, Asambleja e Përgjithshme A/RES/40/33, në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/united-nations-standard-minimum-rules-administration-juvenile>
- 33 Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë, 18 dhjetor 1992, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 47/133, në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-protection-all-persons-enforced-disappearance>,
- 34 Parimet mbi parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore,

Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit,³⁵ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria,³⁶ Deklarata mbi të Drejtat e Njeriut të Individëve që nuk janë Shtetas të Vendit në të cilin ata jetojnë,³⁷ Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të detyrës,³⁸ etj.

Ndër standardet ndërkombëtare përfshihet detyrimi parësor që punonjësit e zbatimit të ligjit të respektojnë dhe t'i binden ligjit në çdo kohë dhe të përmbushin në çdo kohë detyrën që u ngarkohet me ligj, duke i shërbyer komunitetit dhe duke mbrojtur të gjithë personat nga aktet e paligjshme, në përputhje me shkallën e lartë të përgjegjësisë që kërkon profesioni i tyre.³⁹ Kodi i Sjelljes së Kombeve të Bashkuara për zyrtarët e zbatimit të ligjit, i miratuar në 1979, përcakton një sërë detyrimesh për zyrtarët e zbatimit të ligjit. Ata, kërkohet të respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe të ruajnë dhe mbështesin të drejtat e njeriut të të gjithë personave,⁴⁰ si dhe të raportojnë shkeljet e ligjeve apo akteve dhe

arbitrare dhe të shkurtuara, 24 maj 1989, Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 1989/65, në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/principles-effective-prevention-and-investigation-extra-legal>,

35 Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të pushtetit, 29 nëntor 1985, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse>

36 Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria, 14 dhjetor 1990, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/113, në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/united-nations-rules-protection-juveniles-deprived-their-liberty>

37 Deklarata mbi të Drejtat e Njeriut të Individëve që nuk janë shtetas të vendit në të cilin jetojnë, Rezolutën 40/144 të Asamblesë së Përgjithshme të 13 dhjetorit 1985, në: https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.26_Declaration%20on%20the%20Human%20Rights%20of%20Individuals%20who%20are%20not%20nationals.pdf

38 Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të detyrës, në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse>,

39 Neni 2, Kodi i Sjelljes i Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit.

40 Po aty, neni 2.

të parimeve që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut.⁴¹ Veprimet e policisë duhet të respektojnë parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe humanizmit. Në një vend demokratik, ligji është kufizimi i ushtrimit të veprimtarisë institucionale, e cila do t'i nënshtrohet vetëm rregullimeve ligjore dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj, sikurse do të respektojë kufizimet e të drejtave dhe lirive të të parashikuara. Vetëm kjo, siç përcaktohet në DUDNJ, garanton sigurimin e njohjes respektimit të nevojshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe garanton që çdo kufizim është i qëllimtë, i mirëmenduar dhe në respektim të kërkesave të drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

Barazia para ligjit dhe e drejta, pa diskriminim, për mbrojtjen e barabartë të ligjit është një ndër parimet themelore të të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Një sërë aktesh ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga tortura, dënimi apo trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa ndërkombëtare për shtypjen dhe ndëshkimin e krimit të aparteidit, Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit, Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve dhe Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, etj., e përfshijnë këtë parim dhe të drejtë në themel të tyre. Ndër parimet që institucionet ligjzbatuese kërkohet të respektojnë është, pra, edhe ai i mosdiskriminimit në zbatimin e ligjit.⁴² Referuar këtij parimi, punonjësve të zbatimit të ligjit i kërkohet të përmbushin në çdo kohë detyrën që u ngarkohet me ligj duke i shërbyer komunitetit dhe duke mbrojtur të gjithë personat, pa dallim, nga aktet e paligjshme, pa

41 Neni 8, Kodi i Sjelljes i Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit. dhe parimet 6, 11(f), 22, 24 dhe 25 të Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit.

42 Neni 2, Kodi i Sjelljes i Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit. Shih më lart.

dallim, dhe pa trajtim të diferencuar. Shprehimisht parashikohet që ‘në mbrojtjen dhe shërbimin e komunitetit, policia nuk duhet të diskriminojë në mënyrë të paligjshme në bazë të racës, gjinisë, fesë, gjuhës, ngjyrës, opinionit politik, origjinës kombëtare, pronës, lindjes ose statusit tjetër’, edhe pse parashikohet mundësia e trajtimit të ndryshëm për shkaqe të përligjura, të arsyeshme dhe objektive.⁴³ Mosdiskriminimi shtrihet si parim shprehimisht edhe në proceset e rekrutimit, ngritjes në detyrë, apo emërimit në detyra të caktuara në polici, si institucion ligjzbatues.⁴⁴

Veprimet administrative të policisë, si të çdo institucioni ligjzbatues, përfshirë këtu hetimet, intervistimi i dëshmitarëve, viktimave dhe të dyshuarve, kontrollet personale, kontrollet e automjeteve dhe lokaleve, apo raste të përgjimit të korrespondencës apo komunikimeve, standardet ndërkombëtare kërkojnë disa garanci minimale për të drejtat e njeriut, si garantimi i të drejtës për siguri të personit,⁴⁵ e drejta e një gjykimi të drejtë,⁴⁶ prezumimi i pafajësisë,⁴⁷ apo mos ndërhyrja arbitrare në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e individëve.⁴⁸ garantimi i mos pasjes së sulmeve të paligjshme ndaj nderit ose reputacionit të individëve, mosushttrimi i presioneve, fizike apo mendore, mbi të dyshuarit, dëshmitarët ose viktimat në përpjekje për të marrë informacion,⁴⁹ ndalimi absolut i

43 Neni 1 dhe 2, Kodi i Sjelljes i Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit.

44 Lidhur me këtë standard shih më shumë nenet 2(d)-(f), 3, 5(a), dhe 7(b) të Konventës së OKBsë CEDAW, nenet 2(1)(e), 2(2) të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, si dhe Kodin e Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit të OKBsë.

45 Neni 9(1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

46 Shih neni 29(2), DUDNJ apo neni 9, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

47 Neni 14(2), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

48 Neni 9(2), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Parimi 10, i Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën çdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi.

49 Neni 13(3), Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë, si dhe Parimi 15, Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të shkurtuara, apo neni 2, Kodi i Sjelljes.

torturës dhe trajtimeve të tjera çnjerëzore ose degraduese,⁵⁰ trajtimi i viktimave dhe dëshmitarëve me dhembshuri dhe konsideratë,⁵¹ trajtimi i informacionit të ndjeshëm me konfidencialitet dhe kujdes,⁵² apo edhe mos detyrimi i personave që të rrëfejnë ose të dëshmojnë kundër vetvetes⁵³.

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që veprimtaritë hetimore të institucioneve ligjzbatuese të kryhen vetëm në mënyrë të ligjshme dhe për një arsye legjitime. Veprimtaritë hetimore arbitrare apo tejet ndërhyrëse nuk lejohen.⁵⁴ Hetimet e këtyre institucioneve kërkojnë të jenë kompetente, të plota, të shpejta dhe të paanshme.⁵⁵ Procesi hetimor kërkojnë të zhvillohet në mënyrë që të mund të identifikohen viktimat, mbledhen provat që mundësojnë zbulimin e ngjarjeve, shkakut të tyre, mënyrës së kryerjes, vendndodhjes, kohës së tyre, të identifikohen dëshmitarë të mundshëm të ngjarjeve, me qëllimin fundor të identifikimit dhe kapjes së autorëve, duke ruajtur skenat e krimit dhe të provave të identifikuar.⁵⁶

Standardet ndërkombëtare kërkojnë nga institucionet e zbatimit të ligjit të kundërshtojnë dhe luftojnë me rigozitet çdo akt korrupsioni,⁵⁷ të cilin Kodi i Sjelljes së Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, si çdo abuzim tjetër, e konsideron akt të papajtueshëm me profesionin e tyre. Kodi vë në vëmendje forcën e shembullit, duke

50 Neni 5, DUDNJ; neni 7, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; neni 2, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, neni 5, Kodi i Sjelljes.

51 Parimi 4, Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe Parimi 15, Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të shkurtuara.

52 Neni 4, Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit.

53 Neni 11(1), DUDNJ; Neni 14(3)(g), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Parimi 21(1), Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën çdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi.

54 Shih neni 12, DUDNJ, neni 17(1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Parimet 9, 10 dhe 11, Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të shkurtuara.

55 Parimi 9, Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të shkurtuara.

56 Po aty.

57 Neni 7, Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit.

theksuar se ‘...qeveritë nuk mund të presin të zbatohet ligji nga qytetarët e tyre, nëse nuk munden ose nuk do ta zbatojnë ligjin agjencitë e tyre dhe brenda agjencive të tyre’. Në këtë aspekt kërkohet që institucionet ligjzbatuese të zbatojnë edhe rregulla lidhur me dhuratat, premtimet ose stimujt qofshin të kërkuar ose pranuar. Siç shihet, këto rregulla kanë të bëjnë me etikën e veprimtarisë në institucione të tilla, që ngërthen një sërë elementësh, dhe jo vetëm detyrimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, veprimtaria etike dhe jo korruptive ka një lidhje të ngushtë me të drejtat e njeriut. Qasjet jo etike dhe korruptive janë thelbësore për t’i hapur rrugë akteve apo veprimeve që paraprijnë shkelje të të drejtave të njeriut.⁵⁸

Së fundi, standardet e të drejtave të njeriut për zbatimin e ligjit parashikojnë një sërë rregullash për përdorimin e forcës, përgjegjësinë për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit, mbrojtja e të miturve, të drejtat e njeriut të grave, refugjatëve, personave pa shtetësi, viktimave, policimin në komunitet, shkeljet e të drejtave të njeriut nga policia, si dhe të drejtat e njeriut në rastet e protestave civile, gjendjes së jashtëzakonshme, apo konfliktit të armatosur.⁵⁹

5. Raste të trajtuara nga Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), është i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji,⁶⁰ për të mbrojtur ‘të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që

58 Andersen M.K., *Why Corruption Matters in Human Rights*, Journal of Human Rights Practice, Vëllimi 10, Nr. 1, shkurt 2018, fq. 179–190, <https://doi.org/10.1093/jhuman/huy004>


59 Për një trajtim të plotë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga organet ligjzbatuese në lidhje me këto çështje apo situatë, shih: Komisioner i Lartë për të Drejtat e Njeriut, Qendra për të drejtat e njeriut, *Standardet e të drejtave të njeriut për zbatimin e ligjit. Libër xhepi mbi të drejtat e njeriut për policinë*, Gjenevë.

60 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar [ligji për Avokatin e Popullit], në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/legislation>

veprojnë për llogari të saj’.⁶¹ Si është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në ankesat, kërkesat apo njoftimet për një shkelje drejtave të individëve, apo edhe kryesisht, Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të ushtrojnë një hetim të thelluar administrativ, përfshirë edhe në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit) apo në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.⁶²

Një nga mjetet kryesore të njohura nga Kushtetuta⁶³ dhe ligji për Avokatin e Popullit në dispozicion të këtij të fundit është paraqitja e rekomandimeve ‘për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive’⁶⁴.

Avokati i Popullit ka hetuar, si rezultat i kërkesave apo edhe ex officio, raste të ndryshme të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njerit nga ana e Policisë së Shtetit duke miratuar edhe Rekomandime për këto raste. Për periudhën 2022 – 2024 (01.01.2024 - 31.07.2024) janë miratuar në total 162 Rekomandime për Policinë e Shtetit, përfshirë këtu Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtoritë Vendore apo komisaritet, nga të cilat 67 ose 41.36% në vitin 2022, 70 ose 43.21% në vitin 2023 dhe 25 ose 15.43% në 7 mujorin e parë të vitit 2024. Shih Grafik nr 1.



Grafik nr. 1: Rekomandimet e AP për strukturat e Policisë së Shtetit për vitet 2022-2023- dhe 7 muaj, viti 2024


61 Neni 60 i Kushtetutës dhe neni 2 ‘Detyrat e Avokatit të Popullit’ i ligjit për Avokatin e Popullit.

62 Neni 19/1, ligji “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

63 Neni 63, pika 3, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.


64 Neni 21, pika b, ligji “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Të ndara sipas seksioneve përkatëse të Avokatit të Popullit, pjesa më e madhe e rekomandimeve është miratuar nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues, përkatësisht 78.40%, Seksioni për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor (Seksioni i Veçantë) me 17.90%, ndërkohë që Seksionet e tjera kanë nxjerrë një numër më të vogël rekomandimesh, përkatësisht, Seksioni i Përgjithshëm 4, ose 2.47%, Seksioni i Fëmijëve, 1, ose 0.62% dhe Seksioni i Administratës 1, ose 0.62%. Shih Grafik nr. 2.



Grafik nr. 2: Rekomandimet e AP për Policinë e Shtetit në total, 2022-2023-7 muaj 2024.

Të ndara në vite, numri i rekomandimeve sipas Seksioneve/njësive administrative të AP paraqitet si në Grafikon nr. 3



Grafik nr. 3: Rekomandime sipas Seksioneve/njësive administrative të AP në vitet 2022, 2023, 2024

Tërësia e rasteve pasqyron natyrën e shkeljeve nga ana e Policisë. Vihet re se Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues është struktura që ka trajtuar dhe miratuar numrin më të lartë të rekomandimeve, tregues ky i cenimit të të drejtës për të mos u torturuar, trajtuar ose dënuar në mënyrë të egër, çnjerëzore ose poshtëruese në kundërshtim me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi. Rekomandime të tilla janë të llojit sistemik dhe pasqyrojnë problematika që lidhen për shembull me dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtoritë Vendore të Policisë, gjendjen e ambienteve të posaçme të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të kufizuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit, zbatimin me korrektësi të kriterëve ligjore të shoqërimit të shtetasve në ambjentet e organeve të Policisë së Shtetit, trajtimin e problemeve të keqtrajtimit, kushtet infrastrukturore dhe trajtimin e protestuesve të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar në Policinë e Shtetit apo gjatë protestave qytetare, gjendjen e Qendrës Provizore të Pritjes së migrantëve të parregullt, zbatimin korrekt të procedurave standarde ndaj migrantëve të parregullt, kushtet dhe trajtimin e të huajve të parregullt akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt, apo edhe për instalimin e sistemit të kamerave të sigurisë dhe aparatit të regjistrimit video-audio, në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtori Vendore të Policisë apo komisaritet e policisë. Numri i këtyre rasteve është më i larti, që do të thotë se ka një përsëritje më të shpeshtë dhe si rrjedhojë më shqetësuesi për t'u trajtuar. Nga ana tjetër, numri i rasteve të shqyrtuara nga Seksioni i Veçantë dhe që kanë të bëjnë me Policinë është më i ulët por përsëri një numër i konsiderueshëm. Rekomandime të tilla trajtojnë raste individuale. Për sa i takon shkeljeve të gjetura nga Avokati i Popullit në kuadër të punës së Seksionit të Veçantë, ato kanë të bëjnë me shkeljeve përgjatë procedurave administrative disiplinore në Policinë e Shtetit, urdhërimit të kontrollit të banesave, shkelje të kryera nga punonjësit e policisë rrugore në rastin e konstatimit dhe gjykimit të kundërvajtjes administrative, herë pas here të lidhura me njoftimin e kundërvajtësve të shkeljeve administrative të konstatuara në mungesë të drejtuesve

të mjeteve, mos zbatimin e detyrimeve ligjore për dokumentimin e veprimit të shoqërimit të shtetaseve, apo edhe shkelje që lidhen me refuzimin e daljes nga Republika e Shqipërisë ndaj shtetasve.

Edhe pse më të rralla, gjatë periudhës së studiuar, Rekomandimet nga Seksioni i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit kanë trajtuar raste të shkeljeve që lidhen me probleme shqetësuese shoqërore, si për shembull cenimi i garantimit të jetesës së qetë e të pacenuar nga zhurmat apo edhe pastrimi dhe eliminimi i mbetjeve të shkaktuara nga aktivitetet e paligjshme apo vendgrumbullimi i mbetjeve. Ndotjet akustike në vend sikurse papastërtitë në ambjentet e përbashkëta janë shqetësime reale që prekin shumë cilësinë e jetës që qytetarëve.

Në vijim pasqyrohen tre raste të shqyrtuara nga Avokati i Popullit dhe për të cilat janë miratuar Rekomandime, si ilustrime të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga Policia e Shtetit:

Rasti nr. 1

Faktet: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me vendimin nr. 28, datë 29.03.2024, ka cakuar ndaj shtetasit A. J. masën e sigurimit personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo masë është lënë në fuqi edhe me vendimin e gjykatës për verifikimin e masës nr. 35, datë 30.03.2024.

Në datën 23.04.2024, ankuesi është paraqitur në Pikën e Kalimit Kufitar (PKK) Aeroporti Rinas me qëllim udhëtimin jashtë shtetit për të marrë pjesë në një seminar ... në datën 23-25 prill 2024. Punonjësit e policisë kufitare i kanë ndaluar daljen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sepse, sipas tyre, në sistemin TIMS rezulton se ankuesi ka një masë sigurimi personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, me shënimin se duhet të japë pëlqimin hetuesi (OPGJ) që ndjek hetimet, qoftë edhe me telefon.

Ankuesi pretendon se refuzimi i vendosur ndaj tij nga punonjësit

e policisë për të dalë jashtë shtetit është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj, sepse gjykata ka caktuar ndaj tij vetëm masën e sigurimit personal “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” dhe nuk ka caktuar ndonjë masë tjetër sigurimi sikurse është “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” apo ndonjë kufizim që për të dalë jashtë shtetit pa marrë pëlqimin e OPGJ/hetuesit të procedimit A. Z. Nga ana tjetër, punonjësit e policisë së PKK Rinas pretendojnë se procedura e kryer për refuzimin e shtetasit A. J. është në përputhje dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 641, datë 20.12.2019, i cili në pikën nr. 7, gërma “d”.

Në përfundim të hetimit administrativ, institucioni i Avokatit të Popullit gjeti shkelje të të drejtës për lëvizjen e lirë, dhe Rekomandoi sa vijon:

1. Shfuqizimin e aktit administrativ “Refuzimi daljes nga Republika e Shqipërisë”, i datës 23.04.2024, ndaj shtetasit A. J., përpiluar nga punonjësit e PKK Rinas E. A. dhe L. K. dhe lejimin e tij të dalë lirisht jashtë shtetit.
2. Fshirjen e shënimit në sistemin TIMS në lidhje me njoftimin në kufi, për personin nën hetim A. J.
3. Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive dhe ndëshkimin me masa disiplinore të punonjësve të policisë (rojave kufitare E. A. dhe L. K. dhe oficerit të policisë gjyqësore ..., efektiv i Drejtorisë për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit) që kanë kryer cënimin e të drejtës kushtetuese të shtetasit A. J. për të dalë lirisht jashtë shtetit.
4. Përgjithësimin në strukturat qendrore e vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit të shkeljeve të konstatuara ... me qëllim mos përsëritjen e tyre në të ardhmen dhe interpretimin e zbatimin me korrektesë të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 641, datë 20.12.2019 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”.⁶⁵

65 Rekomandim Nr. Doculive 202400653/5 datë 15.07.2024. Statusi: Pranuar dhe

Rasti nr 2:

Faktet: Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, rastin e bërë publik në disa media audiovizive dhe të shkruara në datën 07.12.2022 e në vijim, mbi pamjet filmike dhe fotot e dhunuesit të S. B. në datën 06.12.2022, shtetasit G. Sh. në ambientet e Spitalit të Traumës Tiranë. Ky shtetas shfaqet me pranga në duar, i enjtur dhe i shtrirë në një krevat në ambientet e spitalit ku po merr trajtim mjekësor pas dëmtimeve të pësura datën e incidentit.

Nga media është transmetuar edhe momenti kur shtetasi G. Sh. nënshkruan një dokument të përpiluar nga punonjësit e Policisë së Shtetit të cilët janë të pranishëm. Edhe në momentin e nënshkrimit të këtij dokumenti, shtetasi G. Sh. është me pranga në dorën e djathtë me të cilën firmos dokumentin e dhënë atij nga punonjësit e policisë. Këto pamje filmike dhe fotografike provojnë faktin e pakundërshtueshëm se i arrestuari G. Sh. mbahet i lidhur me pranga në mënyrë të vazhdueshme në Spitalin e Traumës ku ndodhet duke marrë ndihmë mjekësore dhe me shumë mundësi i lidhur në krevatin në të cilin ndodhet i shtrirë.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, institucioni i Avokatit të Popullit gjeti shkelje të të drejtës për garantimin e trajtimit njerëzor dhe jo degradues, dhe Rekomandoi sa vijon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e trajtimit njerëzor dhe jo degradues të shtetasit të arrestuar G. Sh., duke i hequr prangat dhe mos mbajtjen e tij të lidhur gjatë trajtimit mjekësor në Spitalin e Traumës, Tiranë.
2. Analizimin e thellë e me objektivitet të këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për njohjen e punonjësve të

Policisë së Shtetit me Procedurën standarde me titull: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07. 2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore e qëndrore të Policisë së Shtetit me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen raste të tilla të shkeljes së të drejtave themelore të shtetasve nga ana e punonjësve të këtij organi. Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihem në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.⁶⁶

Rasti nr. 3:

Faktet: Në datën 8 dhjetor 2020 u raportua për një ngjarje të rëndë të ndodhur në qytetin e Tiranës. Shtetasi K. R. u qëllua me armë zjarri nga një punonjës i Policisë së Shtetit dhe për pasojë gjeti vdekjen. Punonjësi i policisë, i dyshuar si autor i veprës penale është arrestuar nga organi i Prokurorisë. ... Në ditët që pasuan ngjarjen u mbajtën disa protesta, në qytete të ndryshme të vendit, ku pjesëmarrës ishin kryesisht të rinj, mes tyre edhe persona jo madhorë, nën moshën 18 vjeç. Në Tiranë, protestat ishin të shpërndara në disa zona të qytetit, në të cilat janë shënuar edhe raste ku disa pjesëmarrës kanë kryer veprime të dhunshme ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, duke i goditur ata me sende të forta, duke dëmtuar disa godina të institucioneve shtetërore dhe objekte publike. ... Policia e Shtetit ka ndërhyrë për të shpërndarë protestat duke përdorur forcën fizike, gaz lotsjellës dhe ujë me presion. Gjatë protestave apo fill pas tyre janë shoqëruar në Komisariatet e

66 Rekomandim Nr. Doculive 202201482/2 datë 16.12.2022. Statusi: Pranuar dhe zbatuar plotësisht.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20drejtuar%20DPP%20Shtetit%20dhe%20DVP%20Tirane%20per%20G.Sh.pdf>

Policisë Tiranë një numër jo i vogël protestuesish. Institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka monitoruar protestat nëpërmjet pamjeve të shfaqura në media dhe grupeve të punonjësve që ndodheshin në terren. Gjithashtu, pas përfundimit të protestave, janë kryer vizita dhe inspektime në ambientet e strukturave të Policisë Vendore, Tiranë. Në median audiovizive dhe atë elektronike është raportuar për disa raste kur punonjës të Policisë së Shtetit kanë përdorur forcë të pajustificuar ndaj disa shtetasve.

Episodi 1. Punonjës të Policisë së Shtetit, me veshje dhe mjete mbrojtëse (helmetë dhe mburojë plastike), shpërndajnë disa qytetarë që ndodhen në rrugën ndërmjet Kryeministrit dhe Kuvendit duke u bërë thirrje të largohen. Qytetarët janë të pakët në numër dhe situata paraqitet e qetë. Dy djem, qëndrojnë në vend mbi trotuar dhe u drejtohen punonjësve të policisë me fjalët “do ikim”. Një punonjës policie i shtyn me duar për t’i larguar. Djali i veshur me të zeza, vendos një rën dorë në krahun e punonjësit të policisë, në dukje për mos t’u shtyrë. Punonjësi i largon dorën dhe djali e kap nga veshja. Në këtë çast, punonjësi në fjalë e godet djalin dy herë me shkop gome në fytyrë dhe një koleg i tij i hedh sprajt me bombul po në fytyrë. Me shkop gome goditet tre herë edhe shoku i djalit me të zeza që përpiqet ta mbrojë duke vendosur krahun para shkopit të gomës. Djali me të zeza tenton të godasë me grusht punonjësin, por nuk arrin ta realizojë. Ai rrethohet fillimisht nga katër punonjës, dy prej të cilëve e kufizojnë fizikisht. Djali goditet me shkop gome pas koke dhe spërkatet me sprajt megjithëse nuk kryen veprime kundra punonjësve dhe përpiqet të mbrohet. Me sprajt spërkatet edhe shoku i tij, i cili duket se u bën thirrje i shqetësuar punonjësve. Djali i veshur me të zeza shoqërohet nga dy punonjës në drejtim të një automjeti të policisë. Vërehet se ai është i gjakosur pas kokës.

Episodi 2. Disa punonjës të policisë të veshur civilë kanë ndaluar tre djem duke i mbajtur nga krahët dhe po lëvizin në drejtim të rrugicës që kalon pas godinës së Bashkisë Tiranë, në afërsi të Sahatit. Dallohet qartë se djemtë e ndaluar nuk bëjnë rezistencë dhe ndjekin ritmin e lëvizjes së punonjësve të veshur civilë, të cilët i qëndrojnë në krah dhe

i ndjekin nga pas. Një nga punonjësit godet me grusht në stomak një nga djemtë, në lëvizje e sipër, megjithëse ai nuk kryen asnjë veprim që përbën rrezik. ...

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre rasteve, institucioni i Avokatit të Popullit gjeti shkelje të të drejtës për lëvizjen e lirë, dhe Rekomandoi sa vijon:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për analizimin e thellë e të gjithanshëm, me objektivitet dhe profesionalizëm të veprimeve të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020, pas vrasjes së të ndjerit K. R. nga një punonjës i Policisë së Shtetit.
2. Fillimin e ecurisë disiplinore, identifikimin e punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore ndaj qytetarëve protestues, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe dhënien e masave disiplinore ndaj tyre.
3. Marrjen e masave nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave për kryerjen e veprimeve të nevojshme brenda afateve të arsyeshme për hetimin e shkeljeve ligjore të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020.
4. Marrjen e masave të nevojshme organizative nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve, për mënyrën dhe masën e përdorimit të forcës, si dhe për sjelljen me etikë dhe korrektesë me qytetarët.
5. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të përdorimit të paarsyeshëm të forcës dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, ndaj shtetasve gjatë zhvillimit të tubimeve si dhe gjatë kapjes e shoqërimit të tyre në ambientet e strukturave

të policisë.⁶⁷

Të dhënat e hulumtuara dhe pasqyruara në këtë punim nga veprimtaria e Avokatit të Popullit pasqyrojnë problematika të ndryshme, sa sistemike aq edhe të veçanta. Të dy llojet e problematikave janë me rëndësi të konsiderueshme dhe vënë në pah nevojën për masa gjithëpërfshirëse vijuese me qëllim garantimin e të drejtave themelore të njeriut në veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

6. Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut: veprimtaria administrative.

Veprimtaria administrative e Policisë së Shtetit pasqyron një sërë masash dhe veprimesh që synojnë garantimin de facto të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në janar 2024, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka ndarë komunikim zyrtar me të gjithë strukutat e Policisë së Shtetit për përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe aktet ligjore të vendit, për të respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë e personave”.⁶⁸ Në të njëjtën qasje, janë miratuar Letër Porosi për njohjen dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian kundër Torturës, për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit si dhe për respektimin dhe garantimin në praktikë të së drejtës për trajtim mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar në vitet 2022 dhe 2023.⁶⁹

67 Rekomandim Nr. Doculive. 202100088/2. Shih në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20parimit%20ligjor%20t%C3%AB%20proporcionalitetit%20kur%20p%C3%ABrdoret%20forc%C3%AB%20fizike%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20kontrolluar%20sjelljen%20e%20protestuesve.pdf>.

68 Tërheqje vëmendje nr. 567, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, datë 16.01.2024 “Për përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe aktet ligjore të vendit, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë e personave”

69 Letër porosi nr. 7701, datë 12.10.2022 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për respektimin dhe garantimin në praktikë të së drejtës për trajtim mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar”.

- Masa administrative që forcojnë etikën dhe integritetin

Policia e Shtetit ka miratuar disa akte të brendshme të cilat synojnë të forcojnë etikën dhe integritetin në institucion. Në vitin 2023 u miratua ‘Manuali i etikës policore, për përdorim nga punonjësit e Policisë së Shtetit’, i cili synon të shërbejë “...për të menaxhuar situatat etike, duke ndihmuar punonjësit të mendojnë, veprojnë dhe marrin vendimet e duhura gjatë kohës së punës dhe jashtë saj”.⁷⁰ Ky manual vjen pas një manuali të vitit 2016 të hartuar me mbështetjen e shoqërisë civile.⁷¹ Të dy manualët i kanë thelbësore të drejtat e njeriut dhe zbatimin e tyre në punën e përditshme të Policisë së Shtetit.

Një mjet tjetër i brendshëm administrativ është edhe Plan i Integritetit i Policisë së Shtetit i miratuar në vitin 2020 si rrjedhojë e nevojës për të vendosur një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion.⁷² Edhe Agjencia e Mbikqyrjes Policore (AMP) ka miratuar një Plan Integriteti, 2022-2024, si një përpjekje për të rritur integritetin institucional.⁷³ Megjithatë, ndërsa Plan i Integritetit të Policisë së Shtetit apo raportet e monitorimit të tij nuk janë të aksesueshëm në Programin e Transparencës, plani i integritetit të AMPsë vërehet se ka përfshirë rekomandime dhe sugjerime dhe jo masa konkrete. Mjete të tilla kërkohet të kenë masa konkrete veprimi, përndryshe nëse janë deklarative ato nuk ndihmojnë në përmbushjen e qëllimit për të cilin miratohen.

- Procedura standarde veprimi

Policia e Shtetit ka miratuar procedura standarde veprimi të cilat

70 Shih në: <https://asp.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Manuali-i-Etikes-Policore.pdf>

71 Shih në: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/04/Manuali-i-Etikes-dhe-Integriteti-Policor.pdf>

72 <https://asp.gov.al/lancimi-i-planit-te-integritetit/>. Planet e integritetit ishin pjesë e masave të Strategjisë kundër korrupsionit 2015-2020 miratuar me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.247 datë 20.03.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”

73 Shih Planin e AMPsë, në: <https://www.amp.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/PLANI-I-INTEGRITETIT-2022-2024.pdf>.

ndihmojnë në qartësimin e procedurave që ndiqen nga ky institucion dhe punonjësit e saj. Të tilla janë miratuar edhe për standardet që duhen respektuar në ambientet e mbajtjes dhe trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar, të drejtat e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të policisë për të trajtuar dhe respektuar/garantuar të drejtat ligjore të tyre.⁷⁴

- Përmirësimi i infrastrukturës në komisaritet e Policisë

Për të parandaluar rastet e keqtrajtimit që mund të shkaktohen nga punonjës të policisë gjyqësore apo dhe punonjës të policisë, ndaj personave të arrestuar/ndaluar, në ambientet e komisariateve të policisë janë instaluar sistemet e monitorimit me kamera të cilat janë vendosur tek hyrjet për në komisaritet, ambientet e brendshme të komisaritetit, ambientet e dhomave të shoqërimit.

- Masa dhe veprimtari administrative që parandalojnë dhe luftojnë diskriminimin

Respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare, përfshirë të komunitetit Rom, Egjiptian dhe LGBTIsë janë adresuar përmes një Letër-Porositë të ndarë të gjithë strukturave vendore të Policisë së Shtetit përmes së cilës është kërkuar marrja e masave për repektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve diskriminuese që cenojnë dinjitetin e tyre.⁷⁵

- Trafikimi i personave

Procedurat Standarde të Veprimit qartësojnë rregullat për hetimet proaktive si dhe për rritjen e identifikimit të hershëm të viktimave të

74 Urdhri nr. 1720, datë 20.11.2023, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Procedurë Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, e rishikuar.

75 Letër-Porosi e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 5126/2, datë 15.08.2019 “Për repektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve diskriminuese që cenojnë dinjitetin e tyre”.

trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Strukturat për Hetimin e Trafiqueve të Paligjshme bazohen në këto procedura për identifikimin e rasteve të referuara, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Policia e Shtetit ka ndjekur edhe praktika të mira të aktiviteteve ndërgjegjësuere si Java Antitrafik, me sloganin “Trafikimi i personave është krim. Bashkohu edhe ti për ta ndalur atë”, apo edhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të si Inspektoriati i punës, në vitin 2021, për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës. Angazhimi i Policisë së Shtetit për çështjet e trafikimit pasqyrohet edhe në të dhëna për veprat penale të trafikimit në 2020-2023, si vijon:

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2020, strukturat e Policisë së Shtetit:

- kanë evidentuar gjithsej 112 vepra penale në gjithë vendin prej të cilave 26 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a, 110/b dhe 110/c i Kodit Penal, 5 vepra penale për “Trafikim i të miturve” parashikuar nga neni 128/b dhe 128/b-22 i Kodit Penal; 81 vepra penale për “Prostitucioni” parashikuar nga neni 114,115 dhe 114/2 i Kodit Penal,
- Strukturat për Hetimin Trafiqueve kanë realizuar 81 referime pro aktive, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, të cilat janë për veprat penale: “Trafikim i të miturve” “Trafikimi i Personave të rritur” “Shfrytëzim prostitucioni”, “Mbajtje e ambienteve për prostitucion”,
- janë kryer dhe finalizuar 9 Operacione Policore Kombëtare për veprën penale “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Trafikim personash” parashikuar nga nenet 114 dhe 110/a i K.Penal,
- është kryer 1 Operacion ndërkombëtar “ArmStrong 7”, i zhvilluar në datat 16-20 Nëntor 2020, në bashkëpunim me

Strukturat Doganore, vendet e BE-së, dhe të Ballkanit Jug Perëndimor.

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2021:

- janë evidentuar gjithsej 72 vepra penale në gjithë vendin prej të cilave, 14 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a, 110/b dhe 110/c i Kodit Penal, 10 vepra penale për “Trafikim i të miturve” parashikuar nga neni 128/b dhe 128/b-22 i Kodit Penal; dhe 48 vepra penale për “Prostitucioni” parashikuar nga neni 114,115 dhe 114/2 i Kodit Penal,
- nga Strukturat për Hetimin Trafikeve janë bërë 45 referime pro aktive, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, të cilat janë për veprat penale: “Trafikim i të miturve” “Trafikimi i personave të rritur” “Shfrytëzim prostitucioni”, “Mbajtje e ambienteve për prostitucion”,
- janë kryer dhe finalizuar 8 Operacione Policore Kombëtare për veprën penale nga të cilat 7 “Shfrytëzim prostitucioni” dhe 1 “Trafikim personash” parashikuar nga nenet 114 dhe 110/a i K. Penal,
- janë kryer 2 Operacione Policore Ndërkombëtare DANUB-6 datë 02.09.2021 dhe “JAD/ EMPACT” data 05.11.2021.

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2022:

- janë evidentuar gjithsej 148 vepra penale në gjithë vendin,
- nga Strukturat për Hetimin Trafikeve janë bërë 81 referime pro aktive, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore për veprat penale: “Trafikim i të miturve” “Trafikimi i personave të rritur” “Shfrytëzim

prostitucioni”, “Mbajtje e ambienteve për prostitucion”,

- janë kryer dhe finalizuar 9 Operacione Policore Kombëtare për veprën penale “Shfrytëzim prostitucioni” parashikuar nga neni 114 i K. Penal,
- është kryer 1 operacion ndërkombëtar, Danub 7 datë 24.06.2022 deri 04.07.2022 me synim kontrabandën e emigrantëve, trafikimin e qenieve njerëzore dhe mashtrimi i dokumenteve shoqërues.

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2023:

- janë evidentuar gjithsej 158 vepra penale në gjithë vendin,
- nga Strukturat për Hetimin Trafikeve janë bërë 132 referime pro aktive, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore për veprat penale: “Trafikim i të miturve” “Trafikimi i personave të rritur” “Shfrytëzim prostitucioni”, “Mbajtje e ambienteve për prostitucion”,
- janë kryer dhe finalizuar 13 Operacione Policore Kombëtare nga të cilat 11 për veprën penale “Shfrytëzim prostitucioni” parashikuar nga neni 114 i K.Penal dhe 2 për veprën penale të “Trafikimi i personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a I K.Penal,
- janë kryer 3 Operacione Policore Ndërkombetare për trafikim të qenieve njerëzore, SEE JAD data 13-18.11.2023, JAD Global Chain data 08-14.05.2023 dhe Labour Exploitation data 10-17.06.2023.

- Bashkëpunimi administrativ si qasje efikase

Policia e shtetit ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi si një instrument i butë administrative me qëllim identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Të tilla renditen

“Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik, Drejtorit të Përgjithshëm të ISHPSH dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës”, 2014. Po ashtu, Marrëveshja e Bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, 2012.⁷⁶ Fokusi kryesor i saj është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe ndërton disa standarde të pranueshme nga të gjithë për mënyrën sesi zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe, më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Përveç viktimave të trafikimit, kjo marrëveshje merr në mbrojtje edhe viktimat e mundshme të trafikimit, duke synuar kështu ushtrimin e një mbrojtjeje parandaluese për ata persona që mund të jenë viktimat të mundshme trafikimi. Ky është instrumenti më i rëndësishëm për sa i përket identifikimit, referimit dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit nuk është vetëm me institucionet apo partnerë të tjerë Brenda vendit, por edhe rajonal e më gjerë. Përfaqësues të Sektorit Për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme kanë marrë pjesë në takime me vendet e rajonit për mënyrat e bashkëpunimit më efikas ndërshtetëror në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave/viktimave të mundshme

76 Mekanizmi Kombëtar i Referimit ka në përbërje të tij, 13 institucione dhe struktura shtetërore dhe jo shtetërore, si: Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Prokuroria e Përgjithshme, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizata Ndërkombëtare “World Vision”, Organizata Jo-Fitimprurëse “Arsis” dhe 4 qendrat pritëse dhe riintegruuese: Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Organizatat jofitimprurëse “Të ndryshëm e të barabartë”, “Vatra” dhe “Tjetër Vizion”, Organizatën “Terre des Hommes” dhe “Mary Ward Loreto Foundation”. Secila nga institucionet firmëtare, ka angazhime specifike me qëllim identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe për të siguruar që ato marrin të gjithë mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme. Marrëveshja përcakton qartësisht detyrat e secilës palë nënshkruese.

të trafikimit.⁷⁷ Policia e Shtetit shkëmben informacionin policor me oficerët e kontaktit të atashuar në Shqipëri EUROPOL dhe INTERPOL për identifikimin e personave të dyshuar si të implikuar në veprimtarinë kriminale të trafikimit të personave dhe veprave të tjera penale të lidhura me to si dhe për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit në vendet e destinacionit.⁷⁸

- Dhuna në familje

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës” parashikojnë se Policia e Shtetit është ndër strukturat përgjegjëse për parandalimin dhe marrjen e masave për rastet e dhunës në familje. Procedurat standarde bazë vendosin rregullime të orientuara edhe për Policinë e Shtetit drejt bashkërendimit të punës me autoritetet e tjera përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

Me qëllim për të siguruar përgjigje të shpejtë e të koordinuar për të gjitha rastet e dhunës në familje, trajtimin profesional të rasteve, mbrojtjen e viktimave dhe marrjen e masave ligjore ndaj dhunuesve, ka miratuar një Plan–Veprimi nr. 1773/1 Prot., datë 28.02.2019, “Për masat që duhet të merren nga strukturat e policisë së shtetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, për vitin 2019” si dhe Plani i Veprimit nr. 2112, datë 18.03.2020, “Për masat që duhet të

77 Për ilustrim, shih Raportin vjetor 2022 të Qendrës Vatra për informacion më shumë për trajnimet e ofuruara nga ajo, fq. 49-52, në: <https://qendravatra.org.al/wp-content/uploads/2024/04/raporti-shqip-2022.pdf>

78 Kryesisht informacioni shkëmbehet me Gjermaninë, Francën, Belgjikën, Mbretërinë e Bashkuar, Kosovën, Maqedoninë etj.

merren nga strukturat e Policisë së Shtetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, për vitin 2020”. Masa të tjera administrative të këtij institucioni përfshijnë:

- Letër-Porosi e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 2281 Prot., datë 18.03.2019, “Për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e strukturave të Policisë së Shtetit në mekanizmat e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore në nivel vendor, si dhe përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiave për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje”,
- Letër-Porosi e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 3920/1 Prot., datë 13.05.2019 “Për masat që do të merren dhe dokumentacionin që do të plotësohet në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga udhëzimet e përbashkëta të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018, “Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje” dhe nr. 912, datë 27.12.2018 “Për miratimin e modelit dhe procedurave për Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”, Procedura Standarde të Veprimit “Për trajtimin e viktimave të krimeve seksuale / hetimin e krimeve seksuale”, e cila është miratuar me Urdhër (të DPPSH) nr. 762, datë 18.06.2019,
- Tërheqje vëmendje nr. 8001/1 datë 20.11.2019, “Për trajtimin korrekt të rasteve të dhunës në familje kur viktimat kërkojnë urdhër mbrojtje dhe nuk janë banorë të territorit që mbulon struktura policore”,
- Përgatitur dhe dërguar të gjithë strukturave vendore të policisë, Letër Porosi nr. 2192, datë 25.03.2020 “Për vlerësimin maksimal dhe shtim të vëmendjes ndaj rasteve të dhunës në familje, gjatë kohës së kufizimit të lëvizjeve dhe zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së Covid 19”,
- Letër Porosi nr. 7589/1, datë 07.12.2020 për “Njohjen dhe

zbatimin me korrektësi të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, të ndryshuar, si dhe për masat për marrjen në mbrojtje dhe referimit të viktimave të dhunës në familje dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të dhunës”,

- Janë hartuar dhe dërguar për zbatim Letër–Porosi nr. 6394, datë 16.9.2021 dhe nr. 6952, datë 04.08.2023 “Për marrjen e masave urgjente për trajtimin me përgjegjësi të rasteve të dhunës dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda në familje”.

Një ndër nismat e marra nga Policia e Shtetit është Policimi në komunitet nëpërmjet edukimit të të rinjve. Institucioni ka përfshirë në strukturë një pozicion të veçantë të specialistit/NSPK për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë në të gjitha drejtoritë dhe komisaritet e policisë, në funksion të parandalimit të përfshirjes në veprimtari kriminale të të rinjve dhe rritjes së standardeve të sigurisë në institucionet arsimore dhe në komunitet. Përshkrimi i punës së këtyre specialistëve përfshin planifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit në shkolla dhe me të rinjtë, zhvillimin e temave mësimore me nxënësit dhe studentët, bashkëpunojnë me organizata rinore, mësues, pedagogë, psikologë, oficerët e sigurisë së shkollave, për të identifikuar, trajtuar dhe zgjidhur së bashku problemet e bulizmit, krimit, dhunës në familje, shkeljeve të ligjit. Policia e Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit zbaton një program të posaçëm, “Siguria e të Rinjve”, në shkollat publike dhe jopublike, në kuadër të të cilit janë diskutuar tema të ndryshme që lidhen me edukimin me rregullat e qarkullimit rrugor, efektet negative të përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës, parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, trajtimin e çështjeve të tjera të sigurisë, etj.

Ndërgjegjësimi publik është pjesë e angazhimit administrativ të institucioneve. Policia e Shtetit po ashtu është e angazhuar në kuadër të fushatës së përvitshme “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjimore” (25 nëntor – 10 dhjetor). Gjatë periudhës 2019-2021, në

bashkëpunim dhe me mbështetjen e Programit për Forcimin e Policimit në Komunitet, SCAP, në kuadër të fushatës së përvitshme “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” (25 nëntor – 10 dhjetor), janë realizuar aktivitete ndërgjegjësimi në drejtoritë vendore të policisë Elbasan, Kukës, Korçë, Vlorë, Lezhë, Fier, Komisariatit e Policisë Pogradec etj. Madje, në kuadër të zhvillimeve teknologjike, Policia e Shtetit ka hartuar dhe përdorur për të tilla veprimtari edhe materiale informuese, si dhe rrjetet sociale të saj. Kjo qasje është pasqyrim dhe i parimit të dhënies së ndihmës aktive, sipas nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se organet publik siguron që subjektet të cilave u japin shërbime të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur dhe kështu i informon ato mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.⁷⁹

- Njësi e posaçme administrative për shqyrtimin e ankesave ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit

Në Policinë e Shtetit është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Standardeve Profesionale e cila ka për detyrë të trajtojë kërkesë/ankesat ndaj punonjësve të policisë që bëhen nga komuniteti dhe personat e privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit për shkelje të të drejtave, ushtrim dhune e keqtrajtime të tjera; kryerjen e procesit hetimor administrativ/disiplinor, nxjerrjen e përgjegjësive dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë përgjegjës deri në përjashtim nga Policia e Shtetit.

Në varësi të Ministrisë së Brendshme është Agjencia e Mbikqyrjes Policore, e cila shqyrton dhe verifikon ankesat e subjekteve të ndryshme dhe heton veprat penale të kryera nga punonjësit e policisë së shtetit.

- Forcimi i kapaciteteve

79 Shih ligj nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, në https://qbz.gov.al/share/hf_80XwMShulCFHXAtt4_g

Drejtoria e Planifikimit dhe të Trajnimit Policor në Policinë e Shtetit harton Programin e “Trajnimit të Detyrueshëm në Shërbim”, për punonjësit e Policisë së Shtetit të gradës Inspektor deri në Drejtues të Parë.

Trajnimet e punonjësve të policisë në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje janë në vazhdimësi. Temat mbi dhunën në familje dhe me bazë gjinore janë të planifikuara/parashikuara në Programin e “Trajnimit të Detyrueshëm në Shërbim”, për punonjësit e Policisë së Shtetit, të gradës Inspektor deri në Drejtues të Parë, që hartohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, me urdhër të DPPSH. Trajnimet e punonjësve të policisë në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje janë në vazhdimësi. Trajnimet zhvillohen nga Akademia e Sigurisë, vetë strukturat e policisë për Dhunën në Familje (sektori), por edhe me mbështetjen e organizatave të tjera vendase dhe të huaja që veprojnë në këtë fushë. Për të tilla tema Policia e Shtetit ka bashkëpunuar dhe me organizata kombëtare si Aleanca Gjinore për Zhvillim, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, ashtu dhe me institucione dhe organizata ndërkombëtare, ku ndër të tjera përmendim; Këshillin e Evropës, Ambasadën Amerikane - Zyra Rajonale, Ambasada Holandeze, UNDP, OSCE, SIDA etj.

Disa të dhënat nga 2020-2023 për trajnimet për çështje të dhunës në familje janë:

- Gjatë vitit 2020 me mbështetjen e Programit suedez të Policimit në Komunitet, u organizua trajnimi për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore, në adresimin e dhunës në familje, ku u trajnuan rreth 70 punonjës policie të DVP Elbasan, “Ngritja e mekanizmave të koordinuar për referimin e rasteve të dhunës në familje”, në Has, Kukës, Malësi e Madhe dhe Bulqizë. Pjesëmarrës ishin punonjës policie dhe përfaqësues të institucioneve vendore (Zyra e Punës, Prokuroria, Koordinator i dhunës pranë bashkisë). Gjatë vitit 2021, në bashkëpunim me projektin suedez të Policimit në Komunitet SCAP, është

zhvilluar trajnimi me temë “Dhuna në familje, ndryshimet ligjore për dhunën në familje”, në DVP Durrës, Gjirokastrë dhe Berat, ku u trajnuan 130 punonjës policie (SPZ dhe OPGJ). Po ashtu, është zhvilluar trajnimi mbi “Procedurat standarde të punës dhe hetimi i krimeve seksuale”, ku u trajnuan 20 specialistë të hetimit të krimeve,

- Gjatë vitit 2022 në bashkëpunim me projektin suedez të Policimit në Komunitet SCAP, është zhvilluar trajnimi me temë “Dhuna në familje” në DVP Vlorë, Korçë, Dibër dhe Komisariatet e Policisë Sarandë, ku u trajnuan 140 punonjës policie (SPZ dhe OPGJ). Po ashtu, u realizuan trajnimi i SPZ, në Akademinë e Sigurisë, “Për trajtimin e rasteve të dhunës”, cikli i trajnimeve në bashkëpunim me organizatën AWEN (Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri), në komisaritet e Policisë Pukë, Kavajë dhe Mallakastër, trajnimi “Mbi dhunën në familje me bazë gjinore”, organizuar nga Ambasada e SHBA, në ILEA, Budapest, si dhe seminari “Qendra me një ndalesë”, shërbime për përgjigjen e menjëhershme ndaj fëmijëve viktimë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës”.
- Gjatë vitit 2023 u realizua trajnimi me temë për “Parandalimi dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje” organizuar nga SEESAC. Nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, zhvilluar trajnimi “Dhuna me baze gjinore dhe dhuna në familje”, në DVP Gjirokastrë, Dibër, Berat, Kukës, Shkodër, Tiranë, Elbasan, Korçë, Fier ku janë trajnuar 164 punonjës policie.

Për ilustrim të angazhimeve të tilla, mund të përmenden edhe trajnimet gjatë periudhës kohore, 2019-2023 për fenomenin e trafikimit: janë realizuar edhe 17 trajnime me tematika të ndryshme lidhur me fenomenin e trafikimit si për njohjen me kuadrin ligjor, kuptimin e fenomenit, për format e shfaqjes, pasojat dhe mekanizmat e veprimit për hetimin e rasteve të trafikimit, si dhe për aspekte të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit, në bashkëpunim me shoqërinë

civile.⁸⁰ Me Urdhrin nr 74 datë 21.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nga ana e OSBEsë, është zhvilluar trajnimi për 8 punonjës policie nga strukturat vendore për kufirin dhe migracionin me temë “Aspektet gjinore të identifikimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në kufi”.


- Hartimi dhe raportimi i të dhënave statistikore

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. 1531 datë 24.10.2014, “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit” grumbullon, administron dhe përpunon të dhëna statistikore për veprat penale, autorët dhe viktimat (të dëmtuarit) parashikon përpilimin e të dhënave nga Policia e Shtetit. Të dhënat për autorët dhe viktimat janë të ndara sipas veprave penale, përkatësisë gjinore, moshës, vendbanimit, lidhja e autorit me viktimën.

- Linja telefonike 27/7 - 129 dhe 127

Funksionimi 24/7 i linjës telefonike 129 dhe 112 pa pagesë dhe adresa policiaeshtetit@asp.gov.al ku mund të telefonojë çdokush që ka për të denoncuar një veprim të paligjshëm, përfshirë rastet e dhunës ndaj grave apo në familje. Reagimi i menjëhershëm i policisë në këto raste ka sjellë forcimin e besimit të qytetarët dhe si rezultat rritje të numrit të telefonatave në numrin 129. Nga viti 2020 deri në 2023 janë regjistruar 7760 telefonata vetëm për dhunën në familje. Shih Grafikun nr. 4 për denoncimet në Policiën e Shtetit për dhunën në familje.

80 Trajnimet u zhvilluan me mbështetjen e Njesisë Antitrafik si dhe në bashkëpunim me organizatën jo fitim-prurëse “Të ndryshëm dhe të barabartë”.



Grafik nr 4: Telefonata të regjistruara nga Policia e Shtetit për denoncime të një veprim të paligjshëm, përfshirë rastet e dhunës ndaj grave apo në familje, 2020-2023

Vihet re se numri i denoncimeve gjatë vitit 2021, vitit të pandemisë Covid-19 është 10% më i lartë se në vitin 2020, 24% më i lartë se në vitin 2022 dhe 25% më i lartë se në vitin 2023. Dhuna në familje është rritur më shumë gjatë vitit kur qëndrimi në shtëpi ishte i detyrueshëm, dhe si rrjedhojë angazhimi i Policisë së Shtetit për këtë çështje të të drejtave të njeriut i shtuar.

7. Policia e Shtetit dhe të drejtat e njeriut dhe Raportet e BE dhe të tjera

Procesi i Integrimit Komisioni Evropian (KE) monitoron çdo vit progresin dhe nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në BE. Ai ka pasur në vëmendje edhe veprimtarinë e Policisë së Shtetit si një organ ligjzbatues, duke trajtuar sa aspekte që lidhen me organizimin e saj, si numri i punonjësve të policisë, vetingu në Policinë e shtetit, korrupsioni në të, kapacitet e burimeve njerëzore, etj., aq edhe aspekte të funksionimit të saj që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut, si liria e tubimit, etj.

Shqipëria ka nisur prej disa vitesh zbatimin e reformës në drejtësi, e cila përfaqëson një sistem gjithëpërfshirës masash që synojnë

reformimin rrënjësor të sistemit të gjithë së drejtës në vend. Të drejtat themelore monitorohen përmes të ashtuquajturit Kapitulli 23 i Raportit të Komisionit Evropian, sikurse funksionimi i administratës publike është në vëmendje të këtij monitorimi. Raportet vjetore për vendin tonë në vijimësi kanë pasur vëmendjen edhe ndaj veprimtarisë së Policisë së Shtetit. Në përgjithësi ato vënë në pah probleme në mjediset e ndalimit, keqtrajtime nga ana e punonjësve të këtij institucioni, por edhe korrupsionin si i përhapur edhe në këtë sektor.⁸¹ Çështjet si ndikimi politik, korrupsioni dhe menaxhimi i dobët, si dhe mungesa e stafit, infrastruktura e dobët, përfshirë sistemet elektronike,⁸² dhe mungesa e kujdesit shëndetësor dhe sigurisë, Raportet i vlerësojnë si çështje të përsëritura.⁸³ Raporti i Shqipërisë 2023⁸⁴ identifikoi po ashtu si shqetësues korrupsionin brenda policisë dhe se nevojitet urgjentisht një veprim i synuar, duke rishikuar edhe proceset e kontrolleve të brendshme dhe mekanizmat e inspektimit në administratën publike, të cilat Raporti i 2023 i cilëson se ‘..mbeten të dobëta dhe joefektive’.⁸⁵

Raportimi në Raportin 2020 i ankesave në një portal online qeveritar, gjithsej 1 083 ankesa lidhur me korrupsionin në Polici, është një shifër e konsiderueshme, ndërkohë që Raporti gjeti që këto ankesa kanë rezultuar në masa administrative por jo procedime penale.⁸⁶

- Burimet njerëzore

81 Raporti i Shqipërisë 2022, Komisioni Evropian, Bruksel, 12.10.2022 SWD(2022) 332, fq. 24, në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

82 Raporti 2022, fq. 29


83 Raporti, 2023, fq. 26.

84 Raporti i Shqipërisë 2023, Komisioni Evropian, Bruksel, 8.11.2023 SWD(2023) 690 final, në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en

85 Po aty, fq. 26.

86 Raporti i Shqipërisë 2021, Komisioni Evropian, Strasbourg, 19.10.2021 SWD(2021) 289 final, fq. 25, në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en

- Raporti i Shqipërisë 2023⁸⁷ vë në vëmendje se Policia e Shtetit Shqiptar ka gjithsej 11932 oficerë, ekuivalente me 260 oficerë për 100000 banorë, krahasuar me një mesatare të BE-së prej 335.3 për 100 000 banorë. Në vitin 2020 ishin 11802 punonjës, ekuivalente me 260 oficerë për 100000 banorë, krahasuar me një mesatare të BE-së prej 326 (Eurostat, 2017).⁸⁸ Shih Grafikun nr. 5.



Grafik nr. 5: Numri i oficerëve në Policinë e Shtetit Shqiptar e krahasuar me mesataren e BE-së për 100 000 banorë

Vendi ynë ka ende rreth 30% pozicione pune në Policinë e Shtetit Shqiptar për të shtuar për të arritur këtë mesatare të BE-së. Burimet njerëzore janë një aspekt me rëndësi për mbarrëvajtjen e veprimtarisë institucionale.


Funksionet e organeve ligjzbatuese, Policia e Shtetit e përfshirë, nuk mund të realizohet pa burimet e nevojshme. Mungesa e tyre cenon edhe respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut në kuadrin e ushtrimit funksional të tyre. Raporti i Shqipërisë 2023 thekson se Ministria e Brendshme miratoi reformën organizative dhe strukturore të Policisë së Shtetit Shqiptar në nivel qendror dhe vendor në prill 2023 dhe filloi zbatimin e saj në maj 2023. Po ashtu, Raporti vë në pah se Shqipëria duhet t'u sigurojë institucioneve përkatëse burime njerëzore të përshtatshme, duke përfshirë ekspertizën e jashtme, dhe akses në bazat e të dhënave përkatëse dhe sistemet e inteligjencës kriminale për

⁸⁷ Raporti i Shqipërisë 2023,

⁸⁸ Report, 2021, fq. 37.

të garantuar efikasitet në luftën kundër krimit të organizuar.⁸⁹

Një nga proceset me rëndësi i lidhur me burimet njerëzore që synoi të rikthente besimin e publikut tek organet ligjzbatuese të shtetit, ishte ai i vetingut të zyrtarëve të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (KSHBSH)⁹⁰. Raporti i BE-së i Shqipërisë 2022 vuri në dukje se të dhënat tregojnë se nga 300 zyrtarë të lartë, gjatë vitit 2021 u verifikuan 22%, 2% u shkarkuan, dhe po 2% dhanë dorëheqjen në total, ndërsa në 2020, u verifikuan 15%, 2% u shkarkuan, dhe po 2% dhanë dorëheqjen në total.⁹¹



Grafik nr. 6: Të dhëna nga procesi i vettingut për Policinë e Shtetit, Gardën dhe KSHBSH, 2021-2020

Shifrat pasqyrojnë një pamje që tregon se procesi ka pasur kufizimet e veta. Ndërkohë, shoqëria civile ka kritikuar se procesi nuk përshtati zgjidhjet më të drejta përgjatë zbatimit të tij.⁹²

⁸⁹ Po aty, fq. 42.

⁹⁰ Ligj nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme”, Fletorja Zyrtare nr. 39, në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/39/e052fc58-ab5d-4f90-ae18-9cfcc907f678>

⁹¹ Raporti i Shqipërisë 2022, dhe Raporti i Shqipërisë 2021, fq. 24, në

⁹² IDM, *Raport i monitorimit të procesit të vetingut në polici*, 2021, në: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/RAPORT-I-MONITORIMIT-TE-PROCESIT-TE-VETINGUT-NE-POLICI-1-1.pdf>

Një tjetër aspekt i referuar në raportimet e BE-së për Shqipërinë është ai i plotësimit të Qendrës për Parandalimin e Kriminalitetit të Miturve me burime njerëzore. Raporti vlerësoi se me stafin tashmë plotësisht në funksion, qendra duhet të përparojë në realizimin e mandatit të saj dhe të tregojë impaktin që ka në situatën e fëmijëve në konflikt ose në kontakt me ligjin.⁹³ Në të njëjtin këndvështrim, mungesa e përkthyesve të kualifikuar në qendrat e pritjes së përkohshme, gjatë dhe pas ekzaminimit paraprak, kërkohet të trajtohet dhe të inkurajohet punësimi i përkthyesve femra për të rritur raportimin për dhunën dhe për rastet e mundshme të trafikimit.⁹⁴

Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të Policisë së Shtetit trajtohet gjithashtu në Raportet e BE-së. Identifikohen nevojat për forcimin e kapaciteteve të Oficerëve të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, sepçifikisht për të:

- identifikuar refugjatët dhe migrantët me nevoja specifike;
- mundësuar realizimin e saktë të procedurat e azilit;
- garantuar mbrojtjen e nevojshme për fëmijët dhe antitrafikimin duhet gjithashtu të përmirësohet;
- ekzaminim të përshtatshëm paraprak të refugjatëve dhe emigrantëve;
- vlerësimin e kërkesave individuale, veçanërisht informacionin për vendin e origjinës dhe rastet që përfshijnë njerëz të cënueshëm.

Në Raportet e saj, BEja thekson nevojën që procese të tilla të jenë në përputhje me acquis të BE-së dhe të drejtat themelore.⁹⁵ Raportet qartësisht ndërlidhin burimet njerëzore me mirëfunksionimin institucional. Proceset që synojnë të adresojnë burimet njerëzore në organet ligjzbatuese duhet të jenë të mirëmenduara dhe të qendrueshme

93 Raport 2022, fq. 34 – 35

94 Raport 2022, fq. 48

95 Raport 2022, fq. 47.

me qëllim që të sjellin rezultatet e dëshiruara për organet ligjzbatuese që respektojnë dhe garantojnë të drejtat e njeriut në kuadrin e ushtrimit funksional të tyre.

- Çështje të të drejtave të njeriut

Për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, Raporti i 2023 vë në pah se nuk është raportuar asnjë keqtrajtim sistematik nga policia, por referon Avokatin e Popullit i cili nënvizon nevojën për përmirësimin e standardeve minimale për ambiente policore. Po ashtu, referohet se MKPT trajtoi 45 raste (31 ankesa dhe 14 raste me iniciativë), nga të cilat 25 ankesa kishin të bënin me burgjet dhe trajtimin e të burgosurve dhe 6 ishin kundër policisë së shtetit për dyshime për përdorim të dhunës dhe shoqërim të padrejtë. 90 rekomandimet e MKPT-së u shoqëruan me 779 nën-rekomandime, nga të cilat vetëm 41% janë zbatuar, 9% janë zbatuar pjesërisht, 45% nuk janë zbatuar dhe 5% janë ende pa përgjigje. Sistemi i burgjeve dhe qendrave të paraburgimit mbeten një çështje serioze shqetësuese.⁹⁶

Raporti 2022 vuri në vëmendje rastet e dhunës së dyshuar ndaj gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës. Në korrik 2021, policia arrestoi dy gazetarë që po filmonin një operacion në vazhdim kundër lëndëve narkotike, ndërsa në nëntor 2021, një gazetar investigativ dhe një kameraman thuajse u shtynë në një luginë nga një oficer policie teksa po i afroreshin vendit të vrasjes së një rasti për të cilin po raportonin. Në janar 2022, nëntë gazetarë dhe ekipe mediatike u prekën nga reagimi i policisë ndaj një proteste në Tiranë, ndërkohë që policia argumentoi se veprimet nuk kishin në shënjestër median. Në të njëjtin muaj, një kameraman u detyrua arbitrarisht nga policia bashkiake të largohej nga një protestë lokale që po mbulonte.⁹⁷ Gjithashtu, Raporti 2021 përfshiu rastin e sekuestrimit të serverëve, kompjuterëve dhe telefonave të gazetarëve të Lapsi.al. i cili kishte zbuluar një bazë të dhënash që përmbante informacionin personal të më shumë se 910000 votuesve në

96 Raporti 2023, fq. 30.

97 Po aty.

rajonin zgjedhor të Tiranës.⁹⁸ Në dhjetor 2020, policia ushtroi forcë të tepruar të pajustificuar dhe arrestoi dy gazetarë që po mbulonin protestat që shpërthyen në Tiranë pas vdekjes së një 25-vjeçari të qëlluar nga policia duke zbatuar një shtetrrëhim të lidhur me COVID.⁹⁹

Liria e tubimit dhe e organizimit si e garantuar me Kushtetutë, ka gjetur po ashtu vëmendje në raportet e BE-së. Ndërhyrjet e vlerësuara si joproporcionale të forcave të policisë në mars 2022 gjatë protestave civile kundër rritjes së çmimit të karburanteve dhe ushqimeve si nga orgnaizata të shoqërisë civile edhe nga Avokati i Popullit, gjetën vend në Raportin e vitit 2023. Ndalimi dhe arrestimi i protestuesve u kritikua nga organizatat e të drejtave të njeriut, të cilat praktika të tilla i argumentuan si në kundërshtim me ligjin shqiptar dhe praktikat ndërkombëtare.¹⁰⁰

Për fëmijët në konflikt me ligjin, Raporti 2023 vë në pah një praktikë mjaft të mirë të Policisë së Shtetit, atë të krijimit të njësisë së intervistave miqësore për fëmijët në 12 polici, 35 departamente/stacione dhe po vijon përpjekjet për të trajnuar personelin e policisë në përdorimin e këtyre njësive dhe në kryerjen e intervistave profesionale mjeko-ligjore miqësore për fëmijët.¹⁰¹

Raportet po ashtu kanë nxjerrë në pah problematika të të drejtave të tjera procedurale, lidhur me intervistimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, të drejtën e informimit në procedimet penale, refuzimi ose mosdhënia e aksesit në dosjen e çështjes, garantimit të mjediseve të përshtatshme për konsultime konfidenciale klient-avokat, si dhe prezumimin e pafajësisë e lidhur kjo me referimet publike të autoriteteve publike.

- Raporti i Shqyrtimit ‘Screening’ – Shqipëri¹⁰²

98 Raporti 2022, fq. 30.

99 Raporti 2021, fq. 30.

100 Raporti 2022, fq. 32.

101 fq. 34 – 35

102 Raporti i Shqyrtimit ‘Screening’, 20.07.2023, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

Raporti Screening ka një rëndësi parësore për vendin. Udhërrëfyesit lidhur me të drejtat e njeriut apo mirëfunksionim e administratës publike me rastin e hapjes së negociatave me BE-në ndërtohen mbi këtë Raport.

Raporti screening ka vë në dukje se ka 16 seksione miqësore me fëmijët në komisariatet e Policisë së Shtetit.¹⁰³ Gjithashtu, përdorimi i sistemeve për këmbimin e informacionit është vënë në vëmendje si me po aq rëndësi për thellimin e hetimit dhe mbarëvajtjen e punës së organeve ligjzbatuese. Raportohet se njësitë speciale brenda Policisë kanë akses në 44 regjistra kombëtarë (Deepsee), por për shembull nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në regjistrin elektronik të abonentëve të telefonisë celulare dhe adresat IP nga ofruesit e shërbimeve të internetit.¹⁰⁴

Raporti i Shqyrtimit 'Screening' ka vënë në dukje disa aspekte të veprimtarisë së Policisë së Shtetit të cilat pasqyrojnë cenime të të drejtave të njeriut. Të tilla mund të renditen:

- Avokati i Popullit dhe Mekanizmi Parandalues Kombëtar ka shqyrtuar ankesat ndaj Policisë së Shtetit, duke vënë në pah raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë aksioneve policore gjatë protestave publike;¹⁰⁵
- përdorimi i paautorizuar i videove të vëzhgimit nga forcat e policisë në disa raste ka qenë jo në përputhje me ligjin;¹⁰⁶
- ndalimi nga Policia të jetë në përputhje me të drejtën për liri dhe siguri, duke vënë në vëmendje se ajo mund të ndalojë një të dyshuar për një periudhë jo më të gjatë se 10 orë;¹⁰⁷
- duhet të garantohen lehtësira të përshtatshme për konsultime konfidenciale klient-avokat.¹⁰⁸

103 Po aty, fq. 61

104 Po aty, fq. 72

105 Po aty, fq. 54

106 Po aty, fq. 55

107 Po aty, fq. 58

108 Po aty, fq. 66

Ndërsa Raportet e BE-së janë pasqyrim i gjendjes së vendit tonë për hir të procesit të integritimit evropian të vendit, ato janë një rezervuar mjaft i mirë për të parë të pasqyruar mënyrën si organet publike siç është Policia e Shtetit vlerësohen. Vlerësimi i pasqyruar në to reflekton kërkesën për të qenë në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke u shndërruar kështu në raporte në të cilat vetë Policia e Shtetit mund të identifikojë masa për përmirësimin e punës në drejtim të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

- Raporte të tjera

Disa organizata dhe institucione ndërkombëtare publikojnë rregullisht raporte mbi respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, përfshirë rolin e Policisë së Shtetit. Këto raporte shpesh mbulojnë temat e sjelljes së forcave të rendit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e ligjit. Pa synuar të shqyrtohen të gjitha raportet, në vijim paraqitendisa gjetje nga raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, Komiteti për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës dhe të Komiteti Shqiptar i Helsinkit si një orgnizatë jofitimprurëse vendase.

Departamenti Amerikan i Shtetit publikon çdo vit Raportin Vjetor për të Drejtat e Njeriut, përfshirë edhe Shqipërinë. Raportet e dy viteve të fundit kanë vënë në pah dhunën nga forcat e rendit, keqtrajtimet gjatë ndalimeve, përdorimin e forcës disproporcionale gjatë protestave dhe kushtet e ndalimit në komisarate dhe qendra paraburgimi mos respektimin e të drejtave të të ndaluarve si çështje që lidhen me të drejtat e njeriut dhe forcat e sigurisë.¹⁰⁹ Amnesty International, si organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, monitoron dhe raporton mbi shkeljet e të drejtave të njeriut në shumë vende, përfshirë Shqipërinë. Në raportet e saj, Amnesty ka vënë në pah sidomos rolin e policisë për

109 Shih për më shumë Departamenti i Shtetit. SHBA, *2023 Country Reports on Human Rights Practices: Albania*, [Raportet Vendore 2023 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut: Shqipëria], në: <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>, si dhe *Raportet Vendore 2024 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut: Shqipëria*, në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2024/01/528267_ALBANIA-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf

dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Kështu, gjatë tremujorit të parë të 2023, nga 1000 raste të raportuara policia ka miratuar 510 urdhra mbrojtjeje, ndërsa nga janari në shtator 2023, 12 gra u vranë nga partnerët apo familjarë të tjerë.¹¹⁰

Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) i Këshillit të Evropës në mënyrë të vijueshme ka kryer vizita në Shqipëri dhe hartuar raporte për gjendjen në qendrat e ndalimit dhe burgjet përfshirë edhe komisariatet e policisë. Në vizitën e vitit 2021 KPT-ja theksoi nevojën urgjente për gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme për akomodimin dhe trajtimin e të burgosurve të sëmure që kërkojnë një trajtim të specialitetit, duke kërkuar edhe transferimin e tyre në institucione të specializuara ose në spitale civile me qëllim që të kenë kushtet e nevojshme siç kërkohet nga legjislacioni përkatës i shëndetit mendor.¹¹¹

Ndër organizatat vendase, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është një organizatë lokale që monitoron të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe publikon raporte dhe monitorime të rregullta mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe trajtimin e qytetarëve nga policia. Përgjatë viteve 2022-2023 KSHH kreu 5 misione monitorimi në komisariatet e Policisë si rezultat i të cilave ajo vuri në dukje nevojën e problematikave sistemike në Policinë e Shtetit, si: nevoja për rekrutimin meritokratik, promovimi i karrierës së qëndrueshme, mbështetjen me trajnime vazhduese të punonjësve, kontrollet periodike mjekësore, fuqizimin e mekanizmit kërkesë-ankesë dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme psiko-sociale ndaj të arrestuarve në flagrancë, të ndaluarve apo edhe shoqëruarve.¹¹²

110 Amnesty International, *The state of the world's human rights [Gjendja e të drejtave të njeriut në botë]*, Prill 2024, në: <https://www.amnesty.org/en/location/europe-and-central-asia/western-central-and-south-eastern-europe/albania/report-albania/>

111 Raport për vizitën *ad hoc* në Shqipëri të kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) nga data 23 deri më 26 nëntor 2021. CPT/Inf (2022) 08. Shih në: <https://rm.coe.int/1680a64e5b>

112 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Raport krahasimor mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në shqipëri për vitet 2022 – 2023*, fq. 28-32, në

8. Konkluzione

Ushtrimi i veprimtarisë së Policisë si organ ligjzbatues është me rëndësi parësore për të drejtat e njeriut. Sfida për arritjen e këtij detyrimi ligjor dhe misioni që ka shpalosur vetë Policia e Shtetit janë të ndërlidhura me aspekte më së shumti të veprimtarisë administrative të Policisë së Shtetit në vendin tonë. Praktikë administrative duhet të vijë në nivelin e kuadrit rregullator vendas dhe ndërkombëtar për sigurimin dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut nga ana e punonjësve të Policisë.

Policia e Shtetit ka miratuar Planin e Integritetit për të përforcuar sistemet e menaxhimit të institucionit, por Planet tilla duhet të jenë të aksesueshëm në Programin e Transparencës, të monitorohen dhe raportohen. Mjete tilla kërkohet të kenë masa konkrete veprimi, përndryshe nëse janë deklarative ato nuk ndihmojnë në përmbushjen e qëllimit për të cilin miratohen.

Njohja dhe kuptimi i drejtë i rregullave të zbatueshme nga ana e Policisë së Shtetit është domosdoshmëri e vijueshme. Pa veprimtari që synojnë forcimin e kapaciteteve të punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatat e rasteve të cenimit të të drejtave dhe lirive do të jenë më të larta. Trajnimet dhe veprimtari të tjera të forcimit të kapaciteteve duhet të jenë të ndryshme dhe të vazhdueshme, dhe jo vetëm për aspekte të lidhura ngushtë me të drejtat e njeriut, por këto të fundit nuk duhen të lihen jashtë programeve periodike të forcimit të kapaciteteve. Institucioni duhet të miratojë një program forcimi kapacitetesh dhe të bëjë transparencën e plotë të tij dhe të realizimit të tij.

Në të njëjtën shkallë rëndësie shtimi i burimeve njerëzore, për të arritur minimalisht në mesataren e BE-së do të ishte qasja e duhur. Eksperiencat pozitive si krijimi i njësive për ndërveprimin apo lehtësimin e punës me grupe specifike si fëmijët, duhet shtrirë edhe për nevoja të tjera, si për shembull marrëdhënia klient-avokat. Të tilla

përshtatje janë pasqyrim i një formatimi të institucionit në shërbim të nevojave të qytetarëve dhe pasqyrim i mirëadministrimit. Standardet ndërkombëtare dhe ato të përcjella nga strukturat e BE-së janë rregullat e duhura drejtuese në këtë drejtim.

Policia e Shtetit duhet të vijojë praktikën e mirë që ka ndjekur për aspekte të veçanta të veprimtarisë së saj, si për shembull për çështje të trafikimit apo dhunën në familje, edhe për çështjet e tjera të të drejtave të njeriut. Hartimi i fletëpalosjeve apo broshurave për njohjen e detyrimeve, rregullave dhe qëndrimeve në interpretimin e tyre është një qasje pozitive në kuadër të ndihmës aktive administrative që Policia e Shtetit nevojitet të përfshijë në veprimtarinë administrative të saj gjerësisht. Teknologjia e informacionit ofron lehtësi të cilat duhet të vlerësohen nga ana e institucionit. Përdorimi i aplikimeve të telefonisë celulare kërkon një vëmendje më të madhe nga ana e Policisë së Shtetit. Ajo ka përshtatur të tilla si ‘Komisariati digjital’, por ky aplikimi ka nevojë të mirëmbahet dhe të nxitet përdorimi i tij nga publiku. Përdorimi i sistemeve dhe aksesit i drejtpërdrejtë në to është një lehtësim dhe garanci për një hetim më profesional nga ana e Policisë së Shtetit. Sisteme të tilla, ndërkohë që vihen në vëmendje, janë të rëndësishme, por ato duhet të ngrihen në respektim të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të dhënat personale.

Ky studim tregon se zbatimi praktik nga Policia e Shtetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut vazhdon të jetë një sfidë. Garantimi dhe respektim i të drejtave të njeriut nga ana e Policisë së Shtetit nuk është një objektivi i ngurtë i palëvizshëm. Ky detyrim nënkupton një angazhim serioz të përditshëm të këtij organi ligjzbatues. Zbatimi i rregullave dhe mbikëqyrja efektive mbeten të nevojshme për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet.

9. Bibliografi

Botime

- Andersen M.K., Why Corruption Matters in Human Rights, Journal of Human Rights Practice, Vëllimi 10, Nr. 1, shkurt 2018
- Anastasi A. dhe E. (Methasani) Çani, E Drejta Kushtetuese dhe Administrative: cikël leksionesh për studentët e Fakultetit Ekonomik, Shtëpia Botuese ‘Marin Barleti’, Tiranë 2008
- Sinani M., Dharmo M., Hysi V., Kamani P., Methasani E., dhe Harasani Zh., Komentar i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, botim i UNESCOs, 2008
- Komisioner i Lartë për të Drejtat e Njeriut, Qendra për të drejtat e njeriut, Standardet e të drejtave të njeriut për zbatimin e ligjit. Libër xhepi mbi të drejtat e njeriut për policinë, Gjenevë.
- Manuali i etikës policore për përdorim nga punonjësit e Policisë së Shtetit, 2023
- Policia e Shtetit, Plani i Integritetit, 2020
- Agjencia e Mbikqyrjes Policore, Plan Integriteti, 2022-2024
- Zaganjori Xh., Anastasi A, (Methasani) Çani E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint, 2011

Raporte

- Amnesty International, The state of the world’s human rights [Gjendja e të drejtave të njeriut në botë], Prill 2024
- Raporti i Shqipërisë 2023, Komisioni Evropian, Bruksel, 8.11.2023 SWD(2023) 690
- Raporti i Shqipërisë 2022, Komisioni Evropian, Bruksel, 12.10.2022 SWD(2022) 332

- Raporti i Shqipërisë 2021, Komisioni Evropian, Strasbourg, 19.10.2021 SWD(2021) 289
- Raporti i Shqyrtimit 'Screening', Shqipëria, 20.07.2023, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, Komisioni Evropian
- Raport për vizitën ad hoc në Shqipëri të kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) nga data 23 deri më 26 nëntor 2021. CPT/Inf (2022)08
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport krahasimor mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitet 2022 – 2023
- Departamenti i Shtetit. SHBA, 2023 Country Reports on Human Rights Practices: Albania, [Raportet Vendore mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut: Shqipëria]
- Departamenti i Shtetit. SHBA, 2024 Country Reports on Human Rights Practices: Albania, [Raportet Vendore mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut: Shqipëria]
- Qendra Vatra, Raporti vjetor 2022
- IDM, Raport i monitorimit të procesit të vetingut në polici, 2021

Akte ligjore e nënligjore

- Ligj nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligj nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- Ligj nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”
- Ligj nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të

punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme”

- Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar
- Rekomandim Nr. Doculive 202400653/5 datë 15.07.2024, Avokati i Popullit
- Rekomandim Nr. Doculive 202201482/2 datë 16.12.2022, Avokati i Popullit
- Rekomandim Nr. Doculive. 202100088/2, Avokati i Popullit
- Tërheqje vëmendje nr. 567, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, datë 16.01.2024 “Për përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe aktet ligjore të vendit, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë e personave”
- Letërporosi nr. 7701, datë 12.10.2022 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për respektimin dhe garantimin në praktikë të së drejtës për trajtim mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar”
- Urdhri nr. 1720, datë 20.11.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për miratimin e Procedurës Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, e rishikuar
- Letër-Porosi e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti nr. 5126/2, datë 15.08.2019 “Për repektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve diskriminuese që çenojnë dinjitetin e tyre”

Akt ndërkombëtare

- Karta e Kombeve të Bashkuara
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezolutë 2200 A (XXI), datë 16 dhjetor 1966
- Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, 17 dhjetor 1979, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169
- Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën çdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi
- Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me force,
- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të detyrës
- Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të përmbledhura
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese
- Parimet për parandalimin dhe hetimin efektiv të ekzekutimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të shkurtuara
- Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën çdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi

Adresa internet

<https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

- <https://www.un.org/en/about-us/un-charter/full-text>

<https://qbz.gov.al/share/JiLN1sTiQu6JD0BWHggXjA>

<https://asp.gov.al/misioni/>

<http://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/07/26/82>

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
code-conduct-law-enforcement-officials](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/code-conduct-law-enforcement-officials)

[https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/
UDHR_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
body-principles-protection-all-persons-under-any-form-
detention](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/body-principles-protection-all-persons-under-any-form-detention)

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
declaration-protection-all-persons-enforced-disappearance](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-protection-all-persons-enforced-disappearance)

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-
degrading](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading)

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse)

[https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/
principles-effective-prevention-and-investigation-extra-legal](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/principles-effective-prevention-and-investigation-extra-legal)

- <https://doi.org/10.1093/jhuman/huy004>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/legislation>

[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/
Rekomandimi%20drejtuar%20DPP%20Shtetit%20dhe%20
DVP%20Tirane%20per%20G.Sh.pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20drejtuar%20DPP%20Shtetit%20dhe%20DVP%20Tirane%20per%20G.Sh.pdf)

[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/
media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20
parimit%20ligjor%20t%C3%AB%20proporcionalitetit%20
kur%20p%C3%ABrdoret%20forc%C3%AB%20fizike%20
p%C3%ABr%20t%C3%AB%20kontrolluar%20sjelljen%20](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20parimit%20ligjor%20t%C3%AB%20proporcionalitetit%20kur%20p%C3%ABrdoret%20forc%C3%AB%20fizike%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20kontrolluar%20sjelljen%20)

e%20protestuesve.pdf

<https://asp.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Manuali-i-Etikës-Policore.pdf>

<https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/04/Manuali-i-Etikës-dhe-Integriteti-Policor.pdf>

<https://asp.gov.al/lancimi-i-planit-te-integritetit/>

<https://www.amp.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/PLANI-I-INTEGRITETIT-2022-2024.pdf>

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

IDM, Raport i monitorimit të procesit të vetingut në polici, 2021

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

<https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

<https://rm.coe.int/1680a64e5b>

https://www.state.gov/wp-content/uploads/2024/01/528267_ALBANIA-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf

<https://www.amnesty.org/en/location/europe-and-central-asia/western-central-and-south-eastern-europe/albania/report-albania/>

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/12/Raporti-i-te-Drejtave-te-Njeriut_-Versioni-Shqip.pdf

[60](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/RAPORT-</p></div><div data-bbox=)

- Prof.Dr. Eralda (Methasani) Çani -

I-MONITORIMIT-TE-PROCESIT-TE-VETINGUT-NE-
POLICI-1-1.pdf

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/39/e052fc58-ab5d-4f90-ae18-9cfcc907f678>

https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

isbn